

1 E mërkurë, 6 nëntor 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dhomat e Specializuara
6 të Kosovës çelin seancën.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
8 uleni.

9 Znj. Sekretare, ju lutem paraqisni lëndën.

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi, të
11 nderuar Gjykatës, kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori
12 i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
13 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]
15 Faleminderit.

16 Për procesverbal, të gjithë të akuzuarit janë të
17 pranishëm në sallën e gjyqit.

18 Tani do të vazhdojmë me dëshminë e dëshmitarit të
19 Prokurorisë, W01453.

20 Znj. Asistente, ju lutem silleni dëshmitarin në sallë.

21 [Dëshmitari vijon dëshminë]

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për
23 procesverbal, avokati i dëshmitarit, z. Hodaj, është i
24 pranishëm në sallën e gjyqit.

25 Mirëmëngjesi, Dëshmitar.

1 DËSHMITARI: Mirëmëngjesi.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjesi,
3 Avokat.

4 Z. HODAJ: [Përkthim] Mirëmëngjesi.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, ju
6 kujtoj që ju lutem përgjigjuni pyetjeve qartë, me fjali të
7 shkurtra. Nëse nuk e kuptoni pyetjen, lirisht mund t'i kërkon
8 avokatit përkatës që t'iu shpjegojë pyetjen ose që të japë
9 shpjegimet, sqarimet e nevojshme. Po ashtu, na thoni se cila
10 është baza e njohurive, fakteve dhe rrethanave për të cilat do
11 të pyeteni. Po ashtu, ju lutem flisni pranë mikrofonit, bëni
12 një pauzë prej pesë sekondash përpara se sa të përgjigjeni
13 pyetjes dhe flisni ngadalë për hir të përkthyesve. Nëse e
14 ndjeni të nevojshme të bëni pushim, na e thoni këtë gjë dhe ne
15 do bëjmë organizimet e nevojshme.

16 Ju kujtoj që jeni nën detyrimin të tregoni të vërtetën,
17 siç e keni deklaruar në betimin solemn. Po ashtu, ju kujtoj që
18 garancitë që ju janë dhënë juve të hënën nga Trupi Gjykses
19 janë ende të zbatueshme, dhe refuzimi për të dhënë dëshmi mund
20 të sanksionohet me një gjobë.

21 DËSHMITARI: SHUKRI BUJA [Vijon]

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jemi gati për
23 të filluar. Prokuroria nuk ka përfunduar akoma, kështu që
24 Prokurori do të vazhdojë me pyetjet e mbetura. Ju lutem
25 dëgjojini me kujdes pyetjet.

1 Z. Pace, fjala është për ju.

2 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

3 Pyetje nga z. Pace: [Vazhdim]

4 PY. Mirëmëngjesi, Dëshmitar.

5 Përpara se sa të përfundonim dje, ne po shihnim një
6 dokument ku u përmend një ushtar që kërkohej që të raportonte
7 në brigadë sepse ai po shfaqte sjellje të pahijshme për t'u
8 bërë ushtar. Ju thatë që nuk jeni i njohur me atë rast konkret
9 por mund të ketë ndodhur që sjellja e personit nuk ishte e
10 justifikuar për një ushtar dhe për këtë arsye ai duhej të
11 raportonte në brigadë për shkak të sjelljes së tij.

12 A mund t'i thoni Trupit Gjykues se çfarë ndodhte në një
13 rast të tillë, domethënë kur një ushtar raportonte në brigadë
14 për shkak të çështjeve që kishin të bënin me sjelljet e
15 pahijshme të tij?

16 PË. Po, zakonisht ka -- është marrë me këtë çështje Brigada,
17 ose ka e ka kufizu veprimin e tij, ose i ka marrë armën.

18 PY. Pra, kur thoni që ata e kanë kufizuar aktivitetet ose
19 veprimtaritë e tyre, a mund të na e sqaroni pak më shumë çfarë
20 doni të thoni me këtë?

21 PË. Po, zakonisht brigada dhe me komandën e zonës, ushtari që
22 ka qenë i padisiplinuar, i është marrë arma dhe është dërguar
23 për të punuar në kuzhinë.

24 PY. Çfarë lloji sjelljeje mund të çonte në masa të tilla për
25 t'u marrë? Domethënë, çfarë shkelje disiplinore mund të çonte

1 në marrjen e masave që ju përmendët?

2 PË. Po ka mund, domethënë, për shkak të ndonjë raporti jo të
3 saktë, ka mund të ndodhë për shkak të ndonjë të shtëne në
4 fshat kur s'ka pas luftime, apo ndonjë vepër të tillë, e cila
5 ka qenë shkelje e disiplinës së brendshme ushtarake.

6 PY. Ku kanë qenë, ku gjendeshin këto rregulla të brendshme
7 disiplinore ose ku pasqyroheshin rregullat e brendshme
8 disiplinore?

9 PË. Kam pas një rregullore të cilën e kemi zbatuar dhe të
10 cilën e kam marrë nga zyra e përfaqësuesit të Ushtrisë
11 Çlirimtare të Kosovës, z. Adem Demaçi.

12 PY. Kur e keni marrë këtë dokument, a ja keni dhënë atë ose
13 një kopje të saj personave të tjerë ose ndokujt tjetër brenda
14 Brigadës së -- ose zonës?

15 PË. Po, ka qenë dokument publik për komandën e Brigadës, për
16 zyrën ligjore pranë komandës së zonës. Po, që ta zbatojnë. Ka
17 qenë një rregullore e cila me sa më kujtohet, ka qenë e
18 përshtatur nga ushtria e Shqipërisë për rregullat e brendshme
19 të ushtrisë.

20 PY. A ju kujtohet se kur i keni marrë për herë të parë këto
21 rregullore për të cilat po flisni?

22 PË. Koha e saktë nuk më kujtohet, por sigurisht që ka qenë
23 pas janarit, diku.

24 PY. Për të qenë të qartë, kjo ka ndodhur në vitin 1999?

25 PË. Ose në fund të vitit 1998 në dhjetor, ose në fillim të

1 nëntë dhjetë e -- vitit 1999. Po saktë nuk e di.

2 PY. E përmendët edhe pak më herët që brigada dhe komanda e
3 zonës mund të sekuestronte armët. Tani të përqendrohemi te
4 brigada. Kush në brigadë mund të merrte masa të tilla. Ose me
5 fjalë të tjera, kush ishte i autorizuar brenda brigadës për të
6 marrë masa të tilla?

7 PË. Ka qenë komandanti i brigadës.

8 PY. Po në nivel zone, në nivel zone, kush kishte të drejtë
9 ose autorizim që mund t'i merreshin armët një ushtari të
10 caktuar? Kush e kishte këtë autoritet, Dëshmitar?

11 PË. Për aspektin rregullativ e ka përgatit shefi i zyrës
12 ligjore, ndërsa nënshkrimin dhe vendimin e ka marrë komandanti
13 i zonës.

14 PY. Kush është - kush ka qenë drejtuesi i zyrës ligjore
15 brenda zonës së Nerodimes?

16 PË. Nëse nuk gaboj, ka qenë -- tani po më kujtohet prej dje,
17 ka qenë Sami Hajrullahu.

18 PY. Në ose rreth zonës operative të Nerodimes, së Shtabit,
19 ose vendit ku ishte i bazuar zona operative e Nerodimes, a ka
20 pasur një vend ku ndaloheshin ose mbaheshin ushtarët,
21 Dëshmitar?

22 PË. Ka qenë një vend ku ka qenë në oborrin e komandës së
23 brigadës, por që nuk ka qenë vend ndalim, ka qenë një -- një
24 dhomë në të cilën kanë qëndruar dhe kanë pasur të drejtën të
25 dalin në oborr, apo të shkojnë në kuzhinë të punojnë.

1 Domethënë, kjo ka qenë rregullativa.

2 PY. Çfarë lloji sjelljeje do ta çonte një ushtar që të
3 përfundonte te kjo dhoma që përshkruat juve, ose te ky vendi
4 që ju përshkruat?

5 PË. Po, në rast se ka rreziku ushtarët e tjerë me të shtëna,
6 në një objekt, ose ka shkel ndonjë rregull tjetër disiplinore,
7 është marrë masa. Kjo ka qenë kompetencë apo e ka shqyrtu zyra
8 ligjore në bazë të asaj rregullore dhe pastaj ja ka sjellë
9 komandantit për nënshkrim.

10 PY. A ju kujtohet ndonjë rast konkret kur ka ndodhur ndonjë
11 rast i tillë, për shembull, kur një ushtar është dërguar në
12 këtë dhomë, në zonën tuaj?

13 PË. Ka pas raste por nuk më kujtohet ndonjë rast i veçantë.

14 PY. A ju kujtohet se për sa kohë mund të dërgohej një ushtar
15 në një dhomë të tillë? Domethënë, sa kohë mund të qëndronte
16 atje? Për disa ditë? Për më shumë se kaq? Për sa periudhë kohe
17 mund të qëndronte aty?

18 PË. Tani nuk më kujtohet, por ka qenë disa ditë. Mundësia,
19 nëse nuk gaboj, ka qenë deri në 20 ditë, sipas asaj
20 rregullore.

21 PY. A ju kujtohet që keni thënë më përpara që, për shembull,
22 mund të mbaheshin për 25 ditë? E keni thënë më herët këtë. Ju
23 kujtohet kjo?

24 PË. S'po më kujtohet, por ka pas mundësi deri -- nuk e di
25 saktë, por mund të jetë edhe 25 ditë. Po jo më shumë, besoj.

1 Z. PACE: [Përkthim] Tani kërkoj që të paraqitet në ekran
2 dokumenti U009-1596 deri në U009-15 -- 1662. Përbri përkthimi
3 në anglisht, që mban numrin U009-1596 deri në U009-1641-ET. Do
4 të fillojmë me faqen e parë të të dy dokumenteve.

5 PY. Dëshmitar, në të majtë shikoni një dokument në shqip,
6 ndërkohë që në të djathtë është përkthimi i këtij dokumenti në
7 anglisht. Dokumenti që keni në ekran në të majtë, që është
8 versioni në shqip, a është një dokument që ju e njihni?

9 PË. Nuk po më kujtohet si formë.

10 Z. PACE: [Përkthim] Të kalojmë në faqen që përfundon me
11 1607, në versionin në shqip dhe në anglisht.

12 PY. Dëshmitar, kjo është një faqe tjetër i të njëjtit
13 dokument që tregova pak më herët. Pamë faqen e parë të atij
14 dokumenti, ndërkohë që do të lexoj nga paragrafi 20 i këtij
15 dokumenti dhe më pas do ju bëj disa pyetje. Paragrafi 20:

16 "Masat disiplinore që jepen në UÇK.

17 "Për ushtarët e nënoficerët e shërbimit të detyrueshëm
18 aktivë, masat janë:

19 "Qortim.

20 "Vërejtje.

21 "Heqje e daljes së lirë.

22 "Vënie në shërbim jashtë radhe.

23 "Shkurtimi i lejes së zakonshme deri në 50 për qind.

24 "Ndalim disiplinor deri në 25 ditë.

25 "Shkarkim nga detyra e komandantit të skuadrës dhe heqja

1 e gradës (tetar e rreshter)."

2 Do po -- e ndaloj këtu për momentin.

3 A është informacion që ju duket i njohur ky, Dëshmitar?

4 PË. Po realisht këtë rregulloren, në qoftë se ka qenë kjo
5 rregullore, o ndoshta ta njoh zyrtare a ligjore. S'kam mujt me
6 i shqyrto të gjitha dokumentacionet, po ajo që po më bën
7 përshtypje në këtë rregullore është nën g, apo nën shkronjën
8 g, eh, shkarkimi nga detyra e komandantit të skuadrës dhe
9 heqja e gradës tetar e rreshter, e të -- e cila rregullore,
10 domethënë, s'ka mujt me u zbatu ky nen, sepse ende nuk kemi
11 pas gradime në atë kohë, s'ka pas as tetar as rreshter dhe kjo
12 po më shtyn me nënkuptu që është një rregullore që mund të
13 jetë e Shqipërisë.

14 PY. Ne e pamë ose ju e dëgjuat nën pikën c që një prej
15 opsioneve për masat disiplinore ishte dërgimi në një dhomë të
16 caktuar ose në kazerma. A është ky -- a është -- a përkon kjo
17 me atë çfarë na thatë pak më përpara, Dëshmitar?

18 PË. Po, përkon. Ndalim disiplinor që është, po quhet këtu dhe
19 përkon me këto masa.

20 PY. Po ashtu, shohim nën pikën f:

21 "Ndalim disiplinor deri në 25 ditë."

22 Juve thatë që deri në 20 ditë, megjithatë mund të
23 pajtoheni që mund të ishte deri në 25 ditë ndalimi disiplinor,
24 apo jo, Dëshmitar?

25 PË. Po, realisht nuk e di saktë se sa -- deri në sa ka shku

1 ndalimi disiplinor, por ka qenë me ditë, nuk ka qenë me muaj.

2 PY. Nën pikën d, që e lexova, kemi:

3 "Detyra të tjera."

4 Juve gjithashtu përmendët, për shembull, faktin që
5 ushtari mund të kontribuonte në kuzhinë, mund të punonte aty.

6 A mund të ishte kjo një trajtë ose një formë e masave

7 disiplinore sipas mendimit tuaj, Dëshmitar?

8 PË. Po, në momentin që ne kemi -- e kemi heq armën, apo

9 komandanti i brigadës ka heq armën, ai ka qenë ushtari i

10 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por ka qenë me uniformë, pa

11 armë, dhe pa armë. Dhe pa armë nuk e kemi dërguar në vija të

12 frontit, por për të shërbyer në Ushtrinë Çlirimtare të

13 Kosovës, ka shërbyer në kuzhinë, e cila ka qenë po ashtu në

14 nga detyrat ushtarake.

15 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga ekrani.

16 PY. Dëshmitar, a e keni dërguar ndonjëherë ndonjë civil apo
17 ushtar të arrestuar ose të ndaluar në Kleçkë?

18 PË. Unë drejtpërdrejtë nuk e di që ka pas të arrestum, po

19 fjalë ka pas, në popullatë ka pas shumë fjalë.

20 PY. Sa i takon personave që mendohej ose thuhej se ishin

21 arrestuar, ju vetë personalisht, a keni dërguar ndonjë person

22 të tillë në Kleçkë në vitin 1998 ose 1999?

23 PË. Jo, si të arrestuar asnjëherë, por gjatë vitit 1998 ne

24 kemi pas pika ku i kemi ndaluar njerëzit, në të cilat pika

25 janë legjitimuar, janë shikuar se kush janë dhe pse po hyjnë

1 në territorin të cilin e ka kontrollu Ushtria Çlirimtare e
2 Kosovës. Në rast se kemi dyshuar, është kthyer mbrapa ose
3 është përcjellë me ushtarë deri në vendin ku ka pas synimin me
4 shku, dhe kjo ka qenë për shkak të mosidentifikimit të
5 pozicioneve tona forcës ushtarake që kemi pas, e domethënë
6 këto kanë qenë disa nga masat me -- që janë ndërmarrë në atë
7 kohë.

8 PY. Ju thatë që ata mund të liroheshin ose mund të
9 dërgoheshin diku tjetër. Ku tjetër dërgoheshin ata?

10 PË. Po, ka pas raste kur është ndalu edhe vëllai im, i cili
11 ka qenë anëtari i kryesisë së LDK-së dhe në kërkesën e tij për
12 të shkuar në Negrovç, dysharët -- ushtarët kanë dyshuar, sepse
13 në Negrovç nuk kanë pas arsye. Ai e ka thanë që është -- do ta
14 takoj zëdhënësin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Jakup
15 Krasniqin. Ata kanë dyshuar sepse Negrovci nuk ka qenë ndonjë
16 pikë në të cilën ata kanë besuar se mund të jetë zëdhënësi i
17 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Dhe normalisht e kanë
18 përcjellë pastaj me ushtarë deri në Negrovç, ku më vonë e kemi
19 kuptuar se Negrovci është vendlindja e Jakup Krasniqit.

20 PY. A ju kujtohet vetë ju që, ose keni drejtuar dikë që të
21 dërgohej në Kleçkë ose të jepnit udhëzime që ky person, një X
22 person të dërgohej në Kleçkë? Ju kujtohet ta keni bërë këtë
23 gjë ju vetë, Dëshmitar?

24 PË. Udhëzimet ushtarët i kanë pasur nga komandanti i
25 njësiteve aty, dhe në rast se unë kam dhënë ndonjë udhëzim,

1 kam dhënë që ushtarët të kenë kujdes që të mos futen njerëzit
2 të cilët mund të përcjellin informacione dhe të jetë të
3 kujdesshëm se ku po shkojnë njerëzit, të cilët ata dyshojnë se
4 kanë qëllime jo të mira. Realisht, ushtarët e kanë përcjellë
5 ashtu siç ka kërkuar dikush nga qytetarët, dhe kur kanë dyshu,
6 domethënë e kanë përcjellë -- e kanë përcjellë ushtarët.

7 PY. A ju kujtohet të keni dhënë ndonjë udhëzim, të keni
8 lëshuar ndonjëherë ndonjë udhëzim për dërgimin e dikujt në
9 Kleçkë, për shembull?

10 PË. Edhe një herë se s'e dëgjova mirë.

11 PY. A ju kujtohen -- a ju kujtohet të keni dhënë një udhëzim
12 për të dërguar dikë në Kleçkë?

13 PË. Nuk po më kujtohet, por në qoftë se ka kërku me shku për
14 në Kleçkë, dhe unë kam qenë aty, domethënë, normal që e kam
15 udhëzuar ushtarët ta përcjellin deri në Kleçkë.

16 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në qoftë se më
17 lejoni, dëshiroj që t'i tregoj një deklaratë dëshmitarit, në
18 përputhje me rregullën 143(2)(b) dhe (c).

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
20 vazhdoni.

21 Z. PACE: [Përkthim] Për këtë dëshiroj që të paraqitet në
22 ekran dokumenti IT-03-66 P160-TR-ET, të shohim faqen 84,
23 rreshtat nga 19 deri në 24, që në versionin në shqip përkojnë
24 me të njëjtin dokument, me të njëjtin ERN, që përfundon me AT.
25 Faqja është 85, dhe rreshtat janë nga 20 deri në 25.

1 PY. Dëshmitar, kjo është dëshmia që keni dhënë për TPNJ-në në
2 vitin 2003. Tani dua që të përqendrohëm në tre gjëra që keni
3 thënë, dy në këtë deklaratë dhe një tjetër në deklaratën e
4 vitit 2005, dhe pastaj do të bëj pyetjen. Atëherë, mund të
5 ndiqni atë çfarë keni thënë ose mund të dëgjoni përkthimin.

6 "Dhe kur ka ndodhur ndonjë arrestim dhe kur më kanë
7 pyetur ç'ka të bëjë, thjesht kam thënë 'Nise për në Kleçkë',
8 që do të thotë, faktikisht, ne Kleçkë i kemi orientu se s'kam
9 dit diku tjetër, për shkak të asaj se s'kam qenë unë personi
10 që iu ka caktu përgjegjësia për të bërë këtë gjë."

11 Z. PACE: [Përkthim] Ndërkohë, tani do kërkoj që të
12 kalojmë te dokumenti tjetër, dhe do të shikojmë faqen 2,
13 rreshtat 6 deri në 18. Dokumenti në shqip ka të njëjtin ERN-
14 je, dhe do shohim faqen e dytë, rreshtat 8 deri në 22 të këtij
15 dokumenti.

16 PY. Atëherë, ne do shikojmë një tjetër pjesë të deklaratës
17 tuaj që i keni dhënë TPNJ-së në vitin 2003, dhe do lexoj edhe
18 këtë pjesën, përpara se sa të kalojmë te dëshmia e vitit 2005.
19 Atëherë, dialogu vazhdon si më tej:

20 "PY. Ju përmendët që në lidhje me këtë, ju do ta
21 drejtonit personin për në Kleçkë, do ta udhëzonit për në
22 Kleçkë pastaj.

23 "PË. Po.

24 "PY. A shërbente Kleçka si pikë grumbullimi gjatë këtyre
25 muajve, gjatë qershorit, korrikut, për këta njerëz që

1 arrestoheshin?

2 "PË. Nuk e dija se ku çoheshin, por thjesht unë i kam
3 orientu atje njerëzit, për shkak se njerëzit me përgjegjës
4 mendoja se janë në Kleçkë për këto çështje.

5 "PY. Thjesht për faktin se Kleçka ishte, si të thuash si
6 pikë komandues për juve?

7 "PË. Po, faktikisht unë aty merrja udhëzime nga komandant
8 Çeliku."

9 Dhe, përpara se sa t'ju bëj pyetjen e radhës, dëshiroj që
10 t'ju lexoj një tjetër pjesë. Është pjesë e dëshmisë suaj të
11 dhënë me 9 mars, të vitit 2005.

12 Z. PACE: [Përkthim] Dokumenti ka numrin e identifikimit
13 IT-03-66 T4002 deri në T4087, korrigjim i përkthimit, faqja
14 52, rreshtat 24 deri në faqen 53, rreshti 12. Ndërkohë që në
15 shqip dokumenti mban numrin e identifikimit IT-03-66 të data 9
16 mars, 2005-TR-AT, pjesa 2 e pa redaktuar, faqja 22, rreshtat
17 21 deri në 23, në fa -- në rreshtin 13.

18 PY. Sikurse e thashë, do lexojmë edhe këtë pjesën dhe pastaj
19 do ju bëj pyetje, Dëshmitar.

20 Z. PACE: [Përkthim] Nga anglishtja do fillojmë në
21 rreshtin 24 dhe pastaj do të vazhdojmë me rreshtin [Sipas
22 përkthimit] tjetër.

23 PY. "PY. Ju i keni dhënë përgjigje një pyetjeje që unë akoma
24 nuk e kam bërë, ende s'e kam bërë, por po t'i kthehem pyetjes
25 që sapo ju drejtova, kjo është pyetja që ju i dërgoni njerëzit

1 e arrestuar gjatë kësaj periudhe kohore, qershor-korrik i
2 vitit 1998, këta i dërgonit në Kleçkë. I dërgonit në Kleçkë se
3 ju mendonit që njerëzit me përgjegjësi ishin të vendosur në
4 Kleçkë. A nuk është kështu?

5 "PË. Interpretimi i fjalës arrestim këtu është i gabuar
6 sepse unë nuk mund të them se i kam arrestuar njerëzit. Unë i
7 kam ndaluar njerëzit dhe kur kam dyshuar te ta, unë normalisht
8 jam mundu që të qartësoj se për çfarë bëhet fjalë, pse ai
9 njeri ka ardhur në atë territor. Dhe normalisht, kur s'kam
10 mundur të vendos, unë i kam nisur ata për në Kleçkë, në
11 kuptimin që atje ka pasur njerëz të cilët kanë munduar t'i
12 njohin. ka pasur njerëz edhe të Shtabit të Përgjithshëm të
13 cilët kanë munduar të orientojnë këta njerëz, apo të tregojnë
14 se çfarë do të veprohet me ta, ku të shkojnë, a të lirohen, a
15 të hyjnë në territor të luftës, apo të mos lejohen. Ky ka qenë
16 kuptimi i këtij veprimi."

17 Pas këtyre pjesëve që lexova, Dëshmitar, a mund të na
18 thoni në qoftë se ajo çfarë keni thënë në dëshminë në
19 deklaratën e vitit 2003 dhe gjithashtu dhe në dëshminë e vitit
20 2005, janë informacione të sakta? Mund të na e thoni këtë?

21 PË. Informacion i saktë është interpretimi që kam bërë të
22 deklaratës time në gjykim në vitin 2005. Atë -- fjala
23 arrestim, domethënë është përdorur nga hetuesi dhe unë e kam
24 sqaruar se nuk ka pas të bëjë me arrestim, sepse unë nuk kam
25 arrestuar njerëz. Ato që i thashë më herët, ne i kemi ndaluar

1 njerëz, i kemi identifikuar. Në rast se kemi dyshuar për atë
2 njeri që ka qëllime të -- jo të mira për Ushtrinë Çlirimtare
3 të Kosovës, atëherë, domethënë, ne i kemi [E pakuptueshme] që
4 ta kthejmë prapë.

5 Në rast se ai ka insistuar që të shkojë në vend të
6 caktuar, atëherë ne e kemi nis në drejtit më Kleçkës, siç e
7 kam interpretuar, sepse aty ka pas njerëz shumë në Kleçkë, ka
8 qenë territor më i lirë edhe ka mujt me njoft ndonjë person
9 aty, ndonjë që është - ka qenë ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të
10 Kosovës apo epror, në mënyrë që të përcaktohet se a të
11 lirohet, të shkojë më tutje, ku ka kërkuar, sepse në atë kohë
12 kanë pas lëvizje shumë të mëdha në drejtim të Kleçkës për të
13 kaluar në Malishevë, ku ka qenë -- ne e kemi llogaritur si
14 territor i lirë, dhe nga Malisheva kanë ecur tutje për
15 Dukagjin. Dhe aty ka pas një lëvizje bukur të madhe, dhe ne
16 jemi munduar që të kujdesemi të mos çojmë njerëz të cilët kanë
17 pretendime të nxjerrjes apo të marrjes së informacioneve për
18 Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe forcën e saj. Kjo,
19 domethënë, ka qenë interpretimi jem në kohën gjatë gjykimit në
20 vitin 2005.

21 PY. Sikurse mund ta shihni në ekran, dhe sikurse dëgjuat
22 lidhur me atë çfarë keni thënë në vitin 2005, sa i takon
23 Kleçkës, ju keni thënë që:

24 "Ka pasur persona nga Shtabi i Përgjithshëm që mund t'i
25 orientonin këta persona dhe t'u tregonin atyre se ku do t'i

1 dërgonin ata dhe në qoftë se duhej të lejoheshin ata që të
2 futeshin në territore lufte apo jo.”

3 A është e saktë kjo, Dëshmitar?

4 PË. Po, unë kështu e kam pas përshtypjen në atë kohë, që ka
5 pas njerëz edhe të Shtabit të Përgjithshëm. Ka pas edhe
6 ushtarë të tjerë të cilët kanë mujt me e dit më mirë se sa unë
7 se çfarë të veprohet. A të lirohen, a të shkojnë tutje, apo të
8 kthehen mbrapsht.

9 PY. Në përgjigjen që dhatë pak më herët, thatë se:

10 “Nëse do të kishit dyshime për këtë person, se ky person
11 kishte qëllime të këqija ndaj UÇK-së ...”

12 Por, ç’do t’iu shtynte ju të besonit se një person do të
13 kishte qëllim të këqija ndaj UÇK-së? Ç’iu shtynte ju ta
14 besonit këtë?

15 PË. Jo, por nëse nuk e njihte askush aty, nuk pretendonte të
16 shkonte në ndonjë vend që ne të dyshonim se ai ka një qëllim
17 për të identifikuar forcën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,
18 atëherë ne normalisht që dyshonim. Ka pas shumë qytetarë që
19 nuk kanë pas dokumente identifikimi, sepse i kishte marrë
20 Serbia, apo ishin djegur dhe ne nuk mujshim me -- nuk kemi
21 mujt me i identifiku se kush është, pavarësisht se çfarë ka
22 thënë ai, dhe të -- ka pas shumë probleme në atë kohë rreth
23 identifikimit të njerëzve dhe normalisht që veprimet tona kanë
24 qenë konform asaj situate. Jemi munduar që të jemi të
25 kujdesshëm në atë periudhë dhe në territorin e lirë, që e kemi

1 quajt në atë kohë, domethënë, ka pas shumë njerëz të cilët
2 kanë banu dhe kanë mujt me njoft njerëzit, e po ashtu kanë
3 mujt me njoh edhe strukturat ushtarake dhe lëvizjen tutje për
4 në Malishevë edhe për të shkuar në drejtim të Dukagjinit,
5 domethënë kemi qenë shumë më të kujdesshëm.

6 PY. A mbani mend që të ketë pasur ndonjë rast në verën e
7 vitit 1998, që ta kenë ndaluar një doktor të shkonte në një
8 pjesë të zonës së Nerodimës? Nuk është lejuar një doktor të
9 shkojë në një pjesë të zonës së Nerodimës. Ju kujtohet?
10 PË. Jo, nuk po më kujtohet.

11 Z. PACE: [Përkthim] Me lejen tuaj, të nderuar Gjykatës,
12 në bazë të rregullës 143(2)(b) dhe (c), dëshiroj t'i tregoj
13 një dokument dëshmitarit.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

15 Z. PACE: [Përkthim] Është i njëjti dokument që kemi në
16 ekran, është dokumenti i datës 9 mars, 2005. Në këtë rast do
17 lutesha të shkonit në faqen 33, rreshti 22, dhe faqja 35,
18 rreshti 8. Ndërsa në shqip, është faqja 2, rreshti 22, faqja
19 3, rreshti 12.

20 PY. Edhe një herë, Dëshmitar, është dëshmia e vitit 2005. Do
21 t'ju lexoj disa pyetje dhe përgjigje dhe pastaj do t'ju bëj
22 një pyetje ose dy pyetje në lidhje me to. Është një pjesë e
23 përgjigjes:

24 "Ka pasur raste të tilla edhe me personel të mjekëve që e
25 kemi vonuar në korrik të shkojnë për të intervenuar në

1 plagosjet që kishin ushtarët në luftimet që kishin ndodhur në
2 Rahovec dhe në vende të tjera.

3 "PY. Po pse i keni vonuar këta doktorë? Për çfarë arsye?

4 "PË. Këta doktorë na thanë -- po të na kishin thënë këta
5 doktorë që ishin doktorë, ne do të duhej të bënim verifikimet
6 dhe se çfarë synimesh kishin ata që po shkonin në këtë vend.
7 Pra, duke i mbajtur atje për një ose dy orë, Shtabi i
8 Përgjithshëm na kritikoi, sepse ne i kishim vonuar, por ne nuk
9 i dinim kush ishin këta persona. Ne thjesht i ndaluan, nuk i
10 lejuam të hynin në territor lufte. Po vetëm kur këmbëngulën
11 shumë, e rimenduam."

12 Kjo që keni thënë ju në vitin 2005, në dëshminë tuaj, a
13 është e saktë?

14 PË. Ëh, po e saktë është sepse realisht ne kemi mujt edhe me
15 shkaktu dëme në verifikimin e personave që kanë lëvizur në atë
16 kohë, nuk ka pas dokumente identifikimi dhe normalisht ne kemi
17 dyshuar, deri sa është dikush që e ka njohur si mjek dhe na ka
18 thënë se është dhe duhet sa më shpejtë të dërgohet në spitalin
19 mjekësor që në atë kohë s'e kam ditë ku është, për intervenim
20 kirurgjik, sepse kemi pasur ushtarë të plagosur.

21 PY. Ju këtu keni thënë që:

22 "Shtabi i Përgjithshëm ju ka qortuar, ju ka kritikuar, ju
23 ka tërhequr vërejtje", keni thënë ju fjalë për fjalë në fakt.

24 Kush nga Shtabi i Përgjithshëm ju ka tërhequr vërejtje
25 për këtë?

1 PË. Po në atë kohë unë kam mendu se anëtari i Shtabit të
2 Përgjithshëm është edhe Fatmir Limaj. Realisht, kur -- në një
3 vërejtje na ka dhënë Fatmir Limaj, unë kam supozu se është
4 Shtabi i Përgjithshëm. Edhe vetë Fatmiri ka -- është thirr në
5 atë kohë se Shtabi i Përgjithshëm ka ba vërejtje se është
6 vonu, është vonu mjeku. Domethënë, nga përshtypja, jo nga ajo
7 që e kam ditë, sepse e sqarova edhe dje, që unë nuk i kam
8 njoft anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm në muajin qershor. Në
9 korrik e kam njoft -- në fund të qershorit, në korrik e kam
10 njoft zëdhënësin e UÇK-së, dhe pas korrikut, diku nga fundi i
11 korrikut kanë fillu me u njoft pak a shumë anëtarët e Shtabit
12 të Përgjithshëm.

13 PY. Që ta sqarojmë, në përgjigjen tuaj ju keni thënë që ky
14 rast me këtë mjekët, ka ndodhur në korrik. A bëhet fjalë për
15 vitin 1998?

16 PË. Po, në vitin 1998.

17 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga ekrani.

18 Dhe, të nderuar Gjykatës, do të doja të kalonim
19 shkurtimisht në seancë private, për të mbrojtur palë të treta.
20 Nuk mendoj se do më nevojiten më shumë se dy apo tre minuta në
21 seancë private.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të kalojmë në
23 seancë private.

24 Dëshmitar, është e nevojshme të kalojmë në seancë private
25 për një çast, sepse do të përmenden disa dëshmitarë që janë të

1 mbrojtur. Dhe duhet të vijojmë t'i mbrojmë. Do të bëhet vetëm
2 për shumë pak kohë kjo gjë, do jetë shumë shkurt.

3 DËSHMITARI: Faleminderit.

4 [Seancë private]

5 [Seancë private teksti i fshirë]

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10 [Seancë e hapur]

11 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

13 Vazhdoni.

14 Z. PACE: [Përkthim]

15 PY. Dëshmitar, a ju kujtohet në vitin 1998 ose në 1999 të

16 jeni takuar me një grup personash që pretendonin se kishin

17 ardhur nga Prizreni në Llapushnik?

18 PË. Nuk po më kujtohet tash.

19 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, me lejen tuaj,

20 dëshiroj t'i tregoj një dëshmi të mëhershme Dëshmitarit, në

21 bazë të Rregullës 143(2)(b) dhe (c).

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

23 Z. PACE: [Përkthim] Ju lutem vendosni në ekran materialin

24 me numër IT-03-66 P106 -- 60-TR-ET [Sipas përkthimit] dhe do

25 të lexoj nga faqja 18 dhe në shqip me të njëjtën ERN, por

1 përfundon me AT. Në shqip faqja 20, rreshti 21, dhe kalon më
2 poshtë në faqen 22, rreshti 5.

3 PY. Edhe një herë, Dëshmitar, unë do t'ju lexoj disa nga
4 pyetjet e përgjigjet e deklaratës së vitit 2003. Pasi të
5 përfundoj leximin, do shohim edhe dëshminë e vitit 2005, dhe
6 pastaj do t'ju bëj unë disa pyetje. Po lexoj nga deklarata e
7 vitit 2003, që të jemi të qartë.

8 "Pyetje" --

9 Z. PACE: [Përkthim] Më falni, po përpiqem të gjej
10 referencën e saktë. Duhet të jetë faqja 19, rreshti 18. Po,
11 kjo.

12 PY. "PY. Më 25 dhe 26 korrik ka pasur një ofensivë të madhe
13 në Llapushnik dhe forcat serbe morën kontrollin e këtij vendi,
14 i gjithë vendi ishte bosh dhe atë ditë u liruan disa të
15 burgosur.

16 A është e vërtetë që ju u ndeshët me një grup të madh të
17 burgosurish që ishin liruar në Krojmir dhe që ishin çuar atje
18 me një traktor?

19 "PË. Po, i kam parë.

20 "PY. A mund ta përshkruani?

21 "PË. Me sa më kujtohet, sepse kam takuar edhe -- kanë
22 qenë momentet e tërheqjes së popullatës civile dhe ka qenë një
23 pështjellim shumë i madh. T'ju them të drejtën, kur e kam
24 takuar atë traktor, përndryshe unë kam mendu që kanë qenë
25 popullatë civile, dhe më ka ba përshtypje pse gjithë ishin

1 meshkuj. E kam ndal traktorin. I kam pyt 'Prej nga ju -- '. Më
2 kanë thënë që jemi nga Llapushniku. Nga burgu i Llapushnikut,
3 kështu kanë shpreh. Dhe unë në atë moment, do të thotë, jam
4 frenu. S'kam ditë as si të veproj. Ju kam thënë të presin, dhe
5 jam kthyer me ju dhanë me kuptu se po shkoj të marr informacione
6 se si të veprohet me ta. Faktikisht jam mundu me marr lidhje
7 në telefon.

8 Fati im i mirë -- fati im i mirë ishte që kisha dy të
9 ardhur nga Kleçka.

10 "PY. Në Krojmir?

11 "PË. Në Krojmir. Persona nga Llapushniku, që kishin
12 ardhur. Nga Kleçka kishin ardhur në Llapushnik, dhe flitej se
13 ata ishin të liruar. Unë nuk e di sa ka zgjatur për të marrë
14 informacionet por unë e di që u ktheva dhe iu thashë: 'Jeni të
15 lirë të shkoni', dhe një vërejtje ua kam tërheq, se është
16 ofensivë, dhe në qoftë se shkonin në drejtim të Lipjanit,
17 faktikisht do të binin në duart e forcave serbe."

18 Dëshmitar, tani do shikojmë edhe një pjesë të dëshmisë së
19 vitit 2005.

20 Z. PACE: [Përkthim] Materiali mban numrin IT-03-66 T4002,
21 T4087 i Paredaktuar, korrigjim përkthimi, faqja 72, rreshti 2,
22 deri në faqen 73, rreshti 1. Në shqip mban numrin IT03-66 9
23 mars, 2005-TR-AT, Pjesa 3 e Paredaktuar, faqja 3, rreshti 16
24 deri në faqen 4, rreshti 19.

25 PY. Dëshmitar, sikurse ju thashë, kjo është dëshmia e vitit

1 2005 që keni dhënë në çështjen Limaj:

2 "PË. Traktori që kam ndalë më 23 a 24 korrik unë e kam
3 ndalur sepse ata ishin burra. Ishin civilë, dhe pretendonin të
4 shkonin ndonjëherë në drejtim të fshatrat të Rrafshit. Dhe për
5 këtë edhe e kam ndalur, dhe normalisht unë nuk kam mundur të
6 vendos si të veprojmë me traktorët.

7 "PY. Dhe ju u përpoqët që të vendoset kontakte me
8 Kleçkën. A është kjo e saktë?

9 "PË. Po, jam përpjekur të vendos kontakte me Kleçkën që
10 të shihja se çfarë të bëja. Çfarë të bëja me këtë traktor me
11 civilët.

12 "PY. Dhe më vonë ju zhvilluat një bisedë me Fatmir Limajn
13 lidhur me traktorin nga Llapushniku, a është kjo e saktë?

14 "PË. Unë kam zhvilluar më shumë bisedë rreth këtyre
15 çështjeve për shkak se më dukej se kam bërë një veprim jo të
16 drejtë kur i kam lejuar traktorët -- ", dhe nuk ka përfunduar
17 fjalja.

18 "PY. Zotëri, nëse ju përqendrohemi te Fatmir Limaj, ju
19 zhvilluat një bisedë me Fatmir Limajn. A është kjo e saktë?

20 "PË. Po, jo vetëm një bisedë, por shumë biseda.

21 "PY. Ju i thatë atij për traktorin, dhe ai ju tha juve se
22 ju kishit bërë atë të duhej të bënit. A është kjo e saktë?

23 "PË. Po, unë e kam biseduar për traktorët, të cilët i kam
24 lejuar të shkojnë në atë drejtim, dhe gjithmonë kam pasur
25 bindjen se kam vepruar jo drejtë. Dhe për këtë çështje unë kam

1 biseduar jo vetëm me Fatmir Limaj, por me shumë të tjerë,
2 sidomos edhe me Jakup Krasniqin, sepse mos kam vepruar, a mos
3 i kam çuar drejt vdekjes apo drejt vrasjeve që kanë mundur të
4 ndodhin nga forcat pushtuese serbe për këta traktorë.”

5 Tani, Dëshmitar, ajo që unë ju lexova nga dëshmia e vitit
6 2003, dhe nga dëshmia e vitit 2005, lidhur me këta personat në
7 traktorë, a është e saktë?

8 PË. Po, jo shifet që është e saktë, sepse vërtetë atëherë kam
9 pasur brengë kur e kemi leju të shkojnë traktorët në drejtim
10 të Rrafshit. Ka qenë një shqetësim sepse ka ndodh para kësaj
11 date, para kësaj -- këtij viti kanë ndodhur masakra të tjera
12 të civilëve dhe rrezikshmëria e lëshimit të civilëve, në
13 veçanti e meshkujve të moshës madhore, në drejtim të forcave
14 serbe ka qenë me rrezikshmëri të lartë dhe unë gjithmonë e kam
15 pas brengën se mund të jenë rrezikuar nga ajo që i kam lejuar
16 të shkojnë në drejtim të Rrafshit.

17 PY. A është e vërtetë që një ose më shumë persona në traktor
18 ju kanë thënë që po vijmë nga burgu i Llapushnikut, siç dhe e
19 keni thënë ju vetë?

20 PË. Eh, kjo nuk po më kujtohet, sepse në vitin 2005, kur kam
21 shtrur këtë çështje, kam thënë se nuk e kam parë deklaratën për
22 të bërë përmirësime, se unë kam folur me fjalët e dy -- të
23 tjerëve dhe unë nuk e di saktë se si janë -- se si është
24 gjendja e tyre, por e di që kanë qenë traktorë, jo vetëm ai
25 traktor, por kanë qenë traktorë më i veçantë sepse kanë qenë

1 të gjithë mashkuj të moshës madhore. Ndërsa ka pasur edhe
2 traktorë të tjerë të cilët janë lëshuar në drejtim të
3 Rrafshit, të cilët jemi mundu me i ndalë, për shkak të
4 rrezikshmërisë së lartë. Dhe, do të -- kjo është ajo që e kam
5 thënë edhe në vitin 2005.

6 PY. Që të jemi të qartë, Dëshmitar, në vitin 2003 ke thënë që
7 ata kanë thënë, janë shprehur dhe kanë thënë që "Po vijmë nga
8 burgu i Llapushnikut". A ju kujtohet ta keni thënë këtë në
9 vitin 2003, që ata kanë thënë shprehimisht: "Ne po vijmë nga
10 burgu i Llapushnikut"? Të kujtohet?

11 PË. Kjo nuk po më kujtohet tash, por unë po e shoh e vitit
12 2005, në të cilën jam shprehur se ka pas shumë traktorë dhe
13 kështu edhe është e vërteta.

14 PY. A është e vërtetë, siç keni thënë në vitin 2005, se e
15 keni biseduar këtë çështje me persona në traktorë, me Fatmir
16 Limajn, dhe veçanërisht -- me shumë të tjerë, dhe veçanërisht
17 me Jakup Krasniqin. Kështu?

18 PË. Po, është e vërtetë se unë kam bisedu me shumë njerëz,
19 sepse më ka brengosur gjithmonë kjo veprim i imi, dhe kam
20 bisedu edhe me Fatmir Limajn, sepse u pyeta drejtpërdrejtë në
21 atë kohë për a kam bisedu me Fatmir Limajn. Kam bisedu edhe me
22 shumë të tjerë, e kam biseduar edhe me Jakup Krasniqin kur
23 Jakup Krasniqi ka dalë si zëdhënës i Ushtrisë Çlirimtare të
24 Kosovës, se kam vepruar drejtë apo jo.

25 PY. Të jemi të qartë, se nuk folëm për vitin. Kur thuhet

Dëshmitari: Shukri Buja (Vijon) (Seancë private)
Pyetje nga z. Pace (Vazhdim)

Faqe 27

1 korrik, a është korriku i vitit 2998?

2 PË. Po, i vitit 1998.

3 Z. PACE: [Përkthim] Mund t'i heqim dokumentet nga ekrani,
4 edhe i nderuar Gjykatës, është nevoja të kalojmë sërish në
5 seancë private për të mbrojtur disa perona. Do më nevojiten
6 disa minuta në seancë private.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të kalojmë në
8 seancë private.

9 [Seancë private]

10 [Seancë private teksti i fshirë]

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Shukri Buja (Vijon) (Seancë private)
Pyetje nga z. Pace (Vazhdim)

Faqe 28

- 1 [Seancë private teksti i fshirë]
- 2
- 3
- 4
- 5
- 6
- 7
- 8
- 9
- 10
- 11
- 12
- 13
- 14
- 15
- 16
- 17
- 18
- 19
- 20
- 21
- 22
- 23
- 24
- 25

Dëshmitari: Shukri Buja (Vijon) (Seancë private)
Pyetje nga z. Pace (Vazhdim)

Faqe 29

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4 [Seancë e hapur]

5 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

7 Bëjmë pushim deri në orën 10.10. Faleminderit.

8 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

9 --- Seanca ndërpritet në orën 10.00

10 --- Seanca rifillon në orën 10.10

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,

12 silleni dëshmitarin në sallë.

13 Z. Pace, edhe sa kohë ju duhet?

14 Z. PACE: [Përkthim] Do përfundoj deri në orën 11.00.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

16 [Dëshmitari vijon dëshminë]

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Pace, mund

18 të vazhdoni me pyetjet.

19 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit.

20 PY. Dëshmitar, a ju kujtohet të jeni takuar me një ose më

21 shumë përfaqësues të KVM-së në periudhën rreth shkurtit të

22 vitit 1999?

23 PË. Jo, s'më kujtohet.

24 PY. A ju kujtohet të jeni takuar me ndonjë ndërkombëtar rreth

25 kësaj periudhë, domethënë rreth shkurtit të '99-s?

1 PË. Nuk është t'u m'u kujtu.

2 PY. A ju kujtohet të keni diskutuar ndonjëherë lidhur me të
3 ndaluarit ose të burgosurit që mbaheshin nga UÇK-ja me ndokënd
4 jashtë UÇK-së, pra që nuk ishte pjesë e UÇK-së?

5 PË. Jo, s'po më kujtohet.

6 Z. PACE: [Përkthim] Dëshiroj që të kërkoj që të paraqitet
7 në ekran prova P00861. Tani kalojmë te faqja që përfundon me
8 60777.

9 PY. Dëshmitar, sikurse mund ta shikon nga ekrani, bëhet fjalë
10 për një dokument që e kemi vetëm në anglisht. Është një raport
11 nga Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë, OSBE.
12 Dhe sikurse mund ta shikoni është një dokument i cili ka të
13 bëjë me shkurtin e '99-s, sikurse mund ta lexoni në fillim
14 fare.

15 Z. PACE: [Përkthim] Do kërkoja tani të kalojmë në faqen
16 që e thashë dhe më herët që është 60779.

17 PY. Do të lexoj nga paragrafi i dytë nga kjo faqe. Ju lutem
18 dëgjojeni përkthimin dhe pastaj do ju bëj një pyetje.

19 "Personi ndërlidhës i UÇK-së me komandantin e Uroshe --
20 Rasepacit [Sipas përkthimit], dhe drejtorin në terren të të
21 Drejtave të Njeriut të Misionit Verifikues të Misionit
22 Verifikues në Kosovë ka vizituar komandantin e zonës së UÇK-
23 së, Shukri Bujën, në takimet e përjavshme. Dy çështjet e
24 diskutuara ishin në përgjithësi situata e sigurisë që u parqit
25 nga personeli i OSBE-së dhe vizitat tek të burgosurit e luftës

1 që mbaheshin nga UÇK-ja. Shukri Buja deklaroi se ai besonte që
2 stafi i OSBE-së mund të përdorej nga autoritetet serbe si peng
3 ose mund të ndalohej në qoftë se forcat ushtarake do të hynin
4 në Kosovë. Shukri më tej deklaroi që UÇK-ja do i jepte
5 personit të OSBE-së personin e kontaktit me Mbrojtje në qoftë
6 se situata e kërkonte. Shukri Buja [më tej] deklaroi që nuk e
7 shihte nevojën për personel të jashtëm për të kontrolluar të
8 burgosurit e UÇK-së. Ai deklaroi se mbajtja e shqiptarëve dhe
9 familjeve të tyre nuk ishte -- domethënë mbajtja e
10 shqiptarëve, familjet e tyre mund të vinin dhe mund t'i
11 vizitonin ata dhe mund të vizitonin në burgosurit në çdo kohë
12 që atyre dëshironin ta bënë këtë gjë. Ekipi për verifikimin
13 për Misionin për Verifikimin e Kosovës, po ashtu u përpoq që
14 t'i binte -- ta bindte atë sa i takon komandantëve të tjerë që
15 të lejonin vizitat për të burgosurit dhe në qoftë se do
16 kërkohet një gjë e tillë."

17 A ju kujtohet ta keni thënë këtë gjë, Dëshmitar?

18 PË. Nuk po më kujtohet, po ka mundësi ta kem thënë.

19 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin.

20 PY. Zona e përgjegjësisë e Brigadës 162, a mbulonte dhe
21 Bobin?

22 PË. Po ishte territori i Kaçanikut që Bobi është pjesë e
23 komunës së Kaçanikut.

24 PY. A ju kujtohet se çfarë ndërtese ose çfarë ndërtesash apo
25 strukturash ka përdorur UÇK-ja në Bob?

- 1 PË. Jo, nuk e di sepse s'kam qenë në Bob në periudhat e
2 luftës.
- 3 PY. A keni njohuri lidhur me një kantinë apo me kuzhinë të
4 UÇK-së që gjendej në afërsi të Bobit ose në Bob?
- 5 PË. Nuk po më kujtohet, po ushtria ka pas kuzhina, por a ka
6 pas në Bob apo jo, nuk e di.
- 7 PY. Zona e përgjegjësisë e Brigadës 162, a ka mbuluar dhe
8 Biçeçin?
- 9 PË. Edhe një herë se s'e dëgjova.
- 10 PY. Biçeçi a ishte nën zonën e përgjegjësisë së Brigadës 162?
- 11 PË. Po, e thashë fshatrat të cilat kanë qenë të komunës së
12 Kaçanikut, kanë qenë zonë e përgjegjësisë së Brigadës 162. Një
13 pjesë e kanë pas nën kontroll të Ushtrisë Çlirimtare të
14 Kosovës po pjesa më e madhe ka qenë në kuadër të kontrollit të
15 forcave serbe.
- 16 PY. Mesa ju kujtohet juve, Biçeçi, a ka qenë pjesë e zonave
17 të cilat ishin nën kontrollin e UÇK-së?
- 18 PË. Nuk e di saktë, sepse periudha e '99-s ka qenë periudhë e
19 lëvizjes shumë të madhe të forcave tona, të tërheqjes apo e
20 ecjes përpara dhe nuk e di saktë.
- 21 PY. A ju kujtohet në qoftë se rreth marsit të '99-s Biçeçi ka
22 qenë nën kontrollin e UÇK-së?
- 23 PË. Në kohën kur unë kam depërtuar nëpër territorin ku e ka
24 kontrollu Brigada 162, më kujtohet, do të thotë, ato fshatra,
25 fshatra jo me emra. Po e di që një natë e kanë kaluar, siç e

1 thashë dje, nëse s'gaboj, në kullën që është qujt Kulla e
2 Rambujesë. Nëse nuk gaboj ka qenë një fshat në naltësi
3 mbidetare bukur të lartë, dhe aty kam kalu një natë.

4 PY. Po Kukaj, a ishte pjesë e zonës së përgjegjësisë së
5 Brigadës 162?

6 PË. Po, ka qenë pjesë e brigadës.

7 PY. Prokurori Varoshi?

8 PË. Varoshi është fshat në komunën e Ferizajt, nëse nuk
9 gaboj.

10 PY. Po kjo zonë, domethënë, Varoshi, ishte pjesë s Brigadës
11 162? Binte nën përgjegjësinë e Brigadës 162, apo të ndonjë
12 zone tjetër, njësie tjetër?

13 PË. Jo, Varoshi si pjesë e përgjegjësisë ka qenë e sigurisht,
14 meqë është fshati i komunës së Ferizajt, ka qenë pjesë e
15 përgjegjësisë së Brigadës 161, e cila ka mbulu territorin e
16 Ferizajt, po gjithmonë duhet të kemi parasysh ne nuk --
17 Varoshi është fshat, nëse s'gaboj, i ngjitur me Ferizaj dhe në
18 atë periudhën e luftës ne s'kemi pas qasje në Varosh. Do të
19 thotë nuk e kemi kontrolluar as Varoshin as Ferizajn deri në
20 përfundim të luftës.

21 PY. Për ta sqaruar, a thatë që Varoshi binte nën zonën e
22 përgjegjësisë së Brigadës 161, apo jo?

23 PË. Po, në zonën e përgjegjësisë së Brigadës 161.

24 PY. Mendoj se dje ju përmendët një njësi të UÇK-së që e
25 kishte bazën në Ferizaj. A mund të na kujtoni se cila, cili

1 njësit, ose cilat njësite të UÇK-së e kanë pas bazën në

2 Ferizaj në vitin 1999?

3 PË. Në Ferizaj nuk ka pas bazë të njësitit, por ka operuar në
4 fund të luftës njësitit special. Do të thotë është fjala për
5 qershorin e '99-s e në kohën kur kanë filluar tërheqjen e
6 forcave forcat serbe.

7 Z. PACE: [Përkthim] Kërkoj që të paraqitet në ekran
8 dokumenti 036622-036837. Aty të shohim faqen 036805. Versioni
9 në shqip është ai që mban numrin 0777039-077258 [Sipas
10 përkthimit] dhe në versionin në shqip do shohim faqen 077225.
11 Do i kërkoja Sekretares që të zmadhojë fotografinë dhe
12 shënimin poshtë fotografisë në të majtë të të dyja faqeve.

13 PY. Dëshmitar, ndërkohë që do kalojmë te kjo faqe, sikurse
14 mund ta keni kuptuar, bëhet fjalë për një fletë të librit të
15 Hajrush Kurtajt që ju keni qenë bashkërecensues.

16 Z. PACE: [Përkthim] Do të zmadhojmë një fotografi në fund
17 në cep në të majtë të faqes në versionin në shqip dhe në
18 anglisht.

19 PË. Dëshmitar, në fotografinë që keni përpara në ekran
20 sikurse mund ta shikoni, është një shënim poshtë fotografisë.
21 Në fotografi thuhet si më poshtë:

22 "Komanda e Brigadës 162, Agim Bajrami, në konsultim
23 pune."

24 A e njihni këtë vend që pasqyrohet në fotografinë që keni
25 përpara, Dëshmitar?

1 PË. Jo.

2 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta hiqni dokumentin nga ekrani.

3 Ju kërkoj ndjesë sepse do kërkoj që të paraqisni të njëjtin

4 dokument, por një faqe tjetër të tij. Këtë herë në versionin

5 në anglisht do kërkoja që të paraqisnit faqen 036740, ndërsa

6 në shqip do shohim faqen 077160. Ju lutem zmadhoni imazhet në

7 fund të faqe në shqip dhe në anglisht.

8 PY. Është një fletë e të njëjtit libër që pamë edhe më

9 përpara nga Hajrush Kurtajt, Dëshmitar. Shohim që këto dy

10 fletët që paraqiten në ekran tani, të dyja ato janë në

11 serbisht, ndërkohë që shënimi në fund të faqes në të majtë

12 është në shqip. Ndërkohë që shënimi në fund të faqes në të

13 djathtë është në anglisht. Në shënim thuhet si më poshtë:

14 "Lista e policisë lokale serbe në Kaçanik protokolluar me

15 29.12.1998."

16 A e njihni këtë dokument, Dëshmitar?

17 PË. Jo, nuk e kam parë [E padëgjueshme].

18 Z. PACE: [Përkthim] Tani do të kalojmë në një version më

19 të qartë, version më të qartë të të njëjtit dokument. Kështu

20 që për këtë arsye do i kërkoja Sekretares që të paraqesë në

21 ekran dokumentin P01018 së bashku me P01018-ET, që është

22 versioni në anglisht.

23 PY. Dëshmitar, sikurse e thashë, ky është një dokument i një

24 cilësie më të mirë të dokumentit që e pamë edhe pak më përpara

25 në librin e Hajrush Kurtajt. Ka numrin 41/48, ndërkohë që data

1 është 29.12.1998. Ndërkohë në këtë -- titulli i dokumentit
2 është "Lista e personave të regjistruar për sigurinë lokale të
3 komunës së Kaçanikut".

4 A keni dëgjuar ndonjë për sigurinë lokale të komunës së
5 Kaçanikut, Dëshmitar?

6 PË. Kam dëgjuar por në pjesën e pasluftës ma shumë.

7 PY. Çfarë keni dëgjuar pas luftës?

8 PË. Që ka pas njerëz të cilët janë rekrutuar nga forcat serbe
9 në Kaçanik dhe rrethinë.

10 PY. Për të qenë të qartë, kjo nuk është diçka që e keni
11 dëgjuar gjatë luftës ju, apo jo, Dëshmitar?

12 PË. Gjatë luftës ka pas fjalë, po pas luftës janë
13 konkretizuar ma shumë dhe ky dokument që këtu po paraqitet
14 është një dokument i forcave serbe, forcave të Serbisë, i cili
15 po i jep me emra, mbiemra, po vërtetësinë e këtij dokumenti
16 nuk mund ta them, sepse nuk e di.

17 Z. PACE: [Përkthim] Tani dua që të kthehem përsëri tek
18 libri që po shikonim pak më herët, që është dokumenti me numër
19 036622-036837 anglisht, dhe do të shohim faqet 036703 deri në
20 faqen pasuese. Dhe në shqip faqen 0777039-077258 [Sipas
21 përkthimit] më pas do të shikojmë faqen tjetër 07712.

22 PY. Do të lexoj nga fundi i faqes në anglisht. Përsëri për
23 t'ju orientuar, Dëshmitar, bëhet fjalë për një faqe tjetër të
24 librit.

25 Z. PACE: [Përkthim] Për sa i takon versionit në shqip,

1 numri ERN është i gabuar. Nuk është dokumenti i saktë. Edhe
2 një herë për t'ju dhënë numrin e saktë, do i kërkoja
3 Sekretares të paraqesë dokumentin 077039-077258. Faqja që dua
4 paraqitet në shqip është 077123.
5 PY. Atëherë, ja u thashë dhe më herët, Dëshmitar, që kjo
6 është faqe një tjetër e librit të Hajrush Kurtajt. Do lexoj
7 një pjesë të fund të faqes në anglisht, dhe do e lexoj faqen
8 dhe pastaj do ju bëj një pyetje. Për kontekst dua t'ju them që
9 këtu bëhet faje për luftën e Kotlinës me 24 mars 1999. Dhe
10 thuhet që:

11 "Ja vlen që të thuhet që shumë lokalë shqiptarë - vendas
12 shqiptarë kanë qenë pjesë e kësaj lufte si edhe shumë persona
13 të cilët kanë qenë të përfshirë në listën e mbrojtjes së
14 Kaçanikut me numër 41, të '98-s me numër -- me datë
15 12/29/1998. Ata janë drejtuar nga persona të ndryshëm nga
16 komuna e Kaçanikut", dhe përmenden disa emra ndër të cilët
17 Sejfulla Mulaku, Izak Luta, Bashkim Loku (Kotlinë).

18 Dhe pasi janë renditur këta njerëz, dhe mund të shikoni
19 gjithashtu edhe emrat e tjerë si Shaip Reka [Sipas
20 përkthimit], Qamil Reka [Sipas përkthimit], Bektesh Dardishta
21 [Sipas përkthimit], Isa Dardishta [Sipas përkthimit], e të
22 tjerë. Më tej thuhet që:

23 "Këta të gjorë me apo pa vetëdije ishin vënë në shërbim
24 të okupatorit në dëm të popullit shqiptar."

25 Pra, siç thashë, domethënë këto janë fjalë dhe emra të

1 cilat janë vënë në një libër, për të cilin ju keni qenë
2 bashkërecensues. A mund të na thoni ndonjë shpjegim se pse
3 janë bërë akuza të tilla ndaj këtyre ndaj këtyre personave,
4 dhe përse janë përmendur këta persona të tillë lidhur me këtë
5 ngjarje? Mund të na jepni ndonjë shpjegim, Dëshmitar?

6 PË. Nuk e di saktë, por Hajrush Kurtaj sigurisht është thirr
7 nga këto dokumente serbe të cilat unë nuk e di vërtetësinë e
8 këtyre dokumenteve edhe ka dhënë komentet e tij. Unë s'mund të
9 komentoj komentet e autorit se besoj që ai mund ta sqarojë
10 vetë pse ka bërë komente të tilla.

11 PY. Pyetja ime është kjo: Si bashkërecensues i këtij libri,
12 kur e keni lexuar këtë libër, a i keni thënë ndonjë gjë
13 autorit lidhur me këtë pjesë ku janë përmendur këta persona në
14 kontekstin që e përshkrova më lart?

15 PË. Së pari, unë dje e thashë nuk e kam lexuar librin, por
16 kam lexuar materialet të cilat kanë qenë për magjistrim të
17 tij, dhe në materialet që kanë qenë për Mbrojtjen e
18 magistraturës, këto materiale me sa më kujtohet nuk kanë
19 qenë. Në kohën e botimit të librit, autori ka kërkuar nga unë
20 që t'i bëj një nder ta qes si redaktor emrin tim, dhe unë jam
21 pajtuar. Dhe po ashtu më ka paralajmëruar se libri do të jetë
22 publik, do të bëjë një propagandë ma të fuqishme për disa
23 persona publikë, do të bëjë një propagandë më të fuqishme për
24 Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

25 Realisht më ka paralajmëru që do të jetë një libër ma

1 ndryshe nga ajo që, që ka dhënë në temën e magistraturës, ku
2 e ka bërë mbrojtjen e magistraturës. Dhe këto pjesë, do të
3 thotë, nuk i kam shqyrtuar, i nderuar.

4 PY. Dëshmitar, ne kemi informacion që personat që jua
5 përmenda, emrat që i lexova së bashku nga fshatrat nga vijnë
6 ata, janë ndërmjet personave të cilët janë ndaluar në vendet e
7 ndryshme përfshirë këtu Bobin, Ivajën ose të dyja vendet,
8 rreth marsit të vitit 1999. A keni ndonjë informacion lidhur
9 me këto incidente, Dëshmitar?

10 PË. Jo, nuk kam informacion.

11 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga ekrani.

12 PY. Dëshmitar, a e njeh Ejup Runjevën?

13 PË. Runjeva është fshat në komunën e Kaçanikut.

14 PY. A e njeh një person që quhet Ejup Runjeva, që quhet
15 ndryshe dhe komandanti Era, mbase?

16 PË. Po, e kam njoft Ejup Runjevën sepse ka qenë në kuadër të,
17 si epror në kuadër të Brigadës 162.

18 PY. Nëse ju kujtohet, ai ka qenë epror në Brigadën 162 gjatë
19 gjithë vitit 1999?

20 PË. Nëse nuk gaboju, po.

21 PY. Po Fadil Çakën, ose Fadil Cakën, a e njihni?

22 PË. Si emër po më kujtohet, por pak, nuk jam i sigurt,

23 PY. Po Nuhi Provoliu?

24 PË. Jo, s'po më kujtohet.

25 PY. E keni dëgjuar ndonjëherë këtë emër, ju ka rënë rasti ta

- 1 dëgjoni?
- 2 PË. Jo, s'po mund ta kujtoj.
- 3 PY. Po Bujar Tafilin?
- 4 PË. Jo, as Bujar Tafilin, jo.
- 5 PY. Rrustem Demën?
- 6 PË. Rrustem Demën, si emër, po.
- 7 PY. Me sa keni ju dijeni, ka qenë anëtar i UÇK-së?
- 8 PË. Nuk e di saktë, por si Rrustem Demën, në qoftë se është
- 9 fjala një Rrustem Demë që ka qenë ushtar i UÇK-së, po.
- 10 PY. Në cilin njësit, batalion, brigadë ka qenë ky Rrustem
- 11 Dema, me sa dini ju?
- 12 PË. Jo, këtë nuk mund ta di.
- 13 PY. Po Zeqir Axhamin, e njihni?
- 14 PË. Jo.
- 15 PY. Enver Axhamin?
- 16 PË. Nuk po më kujtohet, s'besoj që e njoh.
- 17 PY. Ilir Zharkun?
- 18 PË. Edhe një herë?
- 19 PY. Ilir Zharku, Ilir Zharku.
- 20 PË. Si mbiemër Zharku, po, por si Ilir nuk më kujtohet.
- 21 PY. Po Muhamet Zenelin?
- 22 PË. Jo, s'më kujtohet.
- 23 PY. Dëshmitar, në mars të 1999-s, ose pas marsit, keni
- 24 dëgjuar ju që të ketë pasur persona të ndaluar nga UÇK-ja në
- 25 Bob, Ivaj ose në të dyja vendet, rreth shkurtit ose marsit të

1 1999-s?

2 PË. Jo. Në atë kohë s'ka pas asnjë raport, as zyrtar as
3 jozyrtar për diçka të tillë.

4 PY. Po pas shkurtit ose marsit të 1999-s, të ka rënë rasti të
5 dëgjosh diçka në lidhje me këtë?

6 PË. Jo, s'kam dëgjuar.

7 PY. Dini gjë lidhur me gjykimin e Ejup Runjevës, që thatë se
8 e njihnit, Rrustem Demës, Enver Axhamit, Bujar Tafilit dhe
9 Nuhi Provolit, në Kosovë? Pra, gjykimi është bërë në Kosovë,
10 pas luftës, lidhur me pretendime se ishin kryer vepra penale
11 në vend përfshirë Bobin dhe Ivajën në shkurt dhe mars të 2003?

12 PË. Po, kam dëgjuar për procesin gjyqësor, dhe bindja ime ka
13 qenë se ata janë të pafajshëm sepse nuk kam pas njëherë
14 informacione, as raporte që komandanti i zonës ka bërë veprime
15 të tilla. Po këto emra që i potencove, mu më kujtohet vetëm
16 Ejup Runjeva.

17 PY. Dëshmitar, po thoni ju se përveç personit që diskutuam në
18 seancë private, ju nuk dini raste të tjera të heqjes së
19 lirisë, keqtrajttimeve apo krimeve të tjera të kryera nga
20 anëtarë të UÇK-së në 1998 apo në 1999? Këtë po thoni?

21 PË. I nderuar, unë së pari kam qenë një periudhë bukur të
22 gjatë jashtë Kosovës. Në një periudhë kam qenë në burg. Pas
23 burgut kam ikur në Zvicër dhe si nga 22 vjet kur i kam mbushur
24 deri në moshën 31 vjeçare nuk kam mujt me njoft njerëzit në
25 Kosovë, dhe realisht nuk kam mujt as të ndërmarr veprime për

1 njerëzit që nuk i kam njoft.

2 Po ashtu, gjatë komandimit të zonës time, zonën operative
3 të Nerodimës, të zonës së Ushtrisë Çlirimtare e Kosovës, unë
4 po të kisha ndonjë informacion sigurisht do të kisha tërheq
5 vëmendjen të mos bahen veprime të tilla. Por në fakt nuk kam
6 pas ndonjë informacion dhe nuk e besoj se ushtarët e Ushtria
7 Çlirimtare e Kosovës, në veçanti eprorët e zonës operative të
8 Nerodimës të kenë ndërmarrë ndonjë veprim të tillë.

9 Prandaj, edhe gjatë gjykimit që ka ndodhur për Ejup
10 Runjevën, unë kam dyshuar në vërtetësinë e atyre vendimeve.
11 PY. Dëshmitar, keni dëgjuar ju që ndonjë ushtar i UÇK-së në
12 pjesë të zonës operative të Nerodimës, të jetë hetuar nga UÇK-
13 ja vetë, për mënyrën se si kanë trajtuar një civil, apo
14 civilët?

15 PË. Jo, sepse s'kemi pas mekanizma për formë të tillë, sepse
16 bindja jonë ka qenë, edhe e imja, edhe veprimi im ka qenë, që
17 civilët të trajtohen në mënyrën më të mirë të mundshme. Duhet
18 ta keni parasysh se ne në atë kohë kemi bërë luftë të ashpër
19 në kuptimin e përfitimit të simpatisë brenda popullit tonë,
20 për të krijuar simpatinë edhe të faktorit ndërkombëtar. Dhe
21 çdo veprim i yni sipas bindjes time në atë kohë dhe të shumë
22 eprorëve të UÇK-së, ç'do veprim i yni në drejtim të civilëve,
23 në veçanti që mund të krijohet përshtypjet e veprimit kriminal
24 apo të, terrorist, na dëmtonte si Ushtri Çlirimtare e Kosovës.

25 Kjo ka qenë puna jonë më e madhe që të jemi të kujdesshëm

1 në këtë drejtim. Prandaj, po e them edhe hetimet që kanë mujt
2 të ndodhë për ndonjë ushtar kanë mund me ndodhë pas luftës,
3 por realisht unë kam pasur gjithmonë këtë bindje.

4 PY. Ju thatë, mund të ketë ndodhur hetimi pas luftës. Me sa
5 keni ju dijeni, pas luftës UÇK-ja apo anëtarë të caktuar të
6 UÇK-së, a kanë hetuar raste të keqtrajtimit të civilëve gjatë
7 luftës?

8 PË. Unë nuk besoj që kanë hetu, sepse s'kanë pas mekanizëm
9 për të hetuar.

10 PY. Ju pyeta për hetimet. Po tani do ju pyes për dënime. Keni
11 dëgjuar ju që ndonjë anëtar i UÇK-së në zonën e Nerodimës, në
12 gjithë zonën e Nerodimës, të jetë ndëshkuar nga UÇK-ja për
13 mënyrën se si ka trajtuar një civil?

14 PË. Ndonjë shkelje disiplinore mund të jetë trajtuar, por
15 shkelje të tjera ne nuk kemi pas as kompetencë si zonë
16 operative e luftës.

17 PY. Që të kuptohemi, ju keni pasur autoritet të merrnit masa
18 disiplinore ndaj një ushtari, por nuk keni pasur kompetencë
19 për të trajtuar ndonjë krim apo ndonjë masë, ose ndonjë
20 sjellje të pahijshme, po themi, përkundrejt civilëve, kështu?

21 PË. Jo, por realisht ne s'kemi pas mekanizëm, në zonë s'ka
22 pas gjykatë, s'ka pas hetuesi, s'ka pas forma të tilla të
23 veprimit të organeve të drejtësisë. Ne e kemi pas atë
24 rregulloren që e potencova ma herët, dhe në rast se ka pas
25 shkelje disiplinore, do të thotë, ne kemi mujt me marr masa

1 deri në atë shkallë sa ka qenë mundësia rregullative që e kemi
2 pas ne në rregullore, për me marrë masa si komandë e zonës.

3 PY. Një krim apo ndonjë sjellje e pahijshme përkundrejt një
4 civili, me sa keni dijeni, a quhej shkelje disiplinore?

5 PË. Në qoftë se ka ba ndonjë veprim të pahijshëm me civilë,
6 në kuptimin e shkeljeve disiplinore, ka mujt me u ndër marrë
7 veprimi nga komandanti i brigadës, apo nga zyra ligjore dhe
8 komandanti i zonës. Por është fjala për shkelje disiplinore të
9 cilat kanë qenë sjellje jo të hijshme të Ushtrisë Çlirimtare
10 të Kosovës.

11 PY. Keni dijeni ju për ndonjë masë nga ndonjë komandant
12 brigade, apo edhe nga ndonjë person tjetër, që ta ketë
13 ndëshkuar dikënd për mënyrën se si është sjellë me një civil.

14 PË. Nuk më kujtohet.

15 Z. PACE: [Përkthim] Dëshmitar [Sipas përkthimit] nuk kemi
16 më pyetje për këtë dëshmitar. Në këtë momente do të doja të
17 kërkoja pranimin e disa materialeve në bazë të rregullës
18 143(2)(c).

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është i gjatë
20 parashtrimi juaj?

21 Z. PACE: [Përkthim] Në qoftë se doni ju, unë mund t'jua
22 jap përmes një postës elektronike ose mund të bëjmë ndonjë
23 diskutim këtu juridik.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dorëzoheni me
25 shkrim sot. Mbrojtja le të paraqesë me shkrim kundërshtimet

1 deri të martën e javës tjetër, brenda orarit zyrtar. Edhe
2 Prokuroria mund të kundërpërgjigjet të mërkurën brenda orarit
3 zyrtar.

4 Z. PACE: [Përkthim] Në fakt ne propozojmë të mos veprojmë
5 kështu, sepse është e rëndësishme përpara se të fillojë
6 pyetjet Mbrojtja të kuptojë çfarë është pranuar dhe çfarë nuk
7 është pranuar. Dhe kjo është në përputhje dhe me një vendim të
8 mëhershëm që ka dhënë Trupi Gjykses në bazë të rregullës
9 143(2)(c) sepse do të pranohen materialet menjëherë pas
10 pyetjeve të Mbrojtjes dhe është momenti që duhet të fillojë
11 kundërpjetjet -- më falni, pyetjeve të Prokurorisë dhe është
12 momenti për të filluar kundërpjetjet Mbrojtja.

13 Për shembull, do t'ju kujtoj datën 11 shtator 2023, në
14 faqet 7706, 7714, ku Trupi Gjykses ka pranuar sipas rregullës
15 143(2) deklaratat e mëhershme të një dëshmitari përpara
16 fillimit të kundërpjetjeve.

17 Kjo është e rëndësishme që Mbrojtja të dijë se çfarë
18 materialesh do të përdoren që të mos jemi në një situatë kur
19 të na duhet ta thërrasim dhe një herë dëshmitarin pasi kanë
20 përfunduar pyetjet nga të gjitha palët. Kjo është në përputhje
21 me vendimet e mëparshme.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Por ne jemi
23 gati të fillojmë kundërpjetjet tani dhe ju do ta çoni emailin
24 më pas.

25 Z. PACE: [Përkthim] Po mund t'jua them që tani se çfarë

1 materialesh dua unë që të pranohen. Unë thashë, po e çoj me
2 email, sepse janë shumë numra dhe do na kursente kohë. Por ne
3 duam të pranohen materiale sipas rregullës 143(2)(c) që është
4 tërësia e deklaratave të 2003-shit për TPNJ, dëshmia e
5 dëshmitarit në 2005-n. Dhe nga deklaratat e tjera vetëm pjesët
6 që kemi ballafaquar me të gjatë pyetjeve tona. Për shembull,
7 janë disa pjesë të deklaratës së 2001-shit, të 2002-shit për
8 TPNJ-në, dhe seanca e 2011-s në lëndën Arben Krasniqi dhe të
9 tjerët.

10 Unë mund t'ua jap numrat, por janë shumë.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ne nuk mund
12 ta kalojmë gjithë ditën duke u marrë me këto materiale.

13 Z. PACE: [Përkthim] Nuk na nevojitet mbase numri, të
14 gjithë e dinë se çfarë janë këto. Është deklarata e 2003-shit,
15 2005-s, dhe materialet e tjera vetëm pjesët që kam ballafaquar
16 me dëshmitarin.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të keni ju
18 kundërshtime për këto materiale?

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Absolutisht që po.

20 Z. DIXON: [Përkthim] Edhe ne.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë, si
22 doni të veproni atëherë me kundërshtimin tuaj? Shkurt.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Unë gjithmonë shkurt flas.

24 Unë dua të vazhdoj me kundërpyetjet. Por nga ana tjetër
25 kemi dëgjuar që do të pranohen materiale, ose që kërkohen të

1 pranohen materiale që për ne janë të ndërlikuara dhe për të
2 cilat dua të bëj parashtrime. Por ju thashë, sigurisht që unë
3 dua të filloj sa më shpejt me kundërpyetjet tani.

4 Propozimi im është të vijojmë sipas propozimit tuaj. Nuk
5 e di çfarë mund të më thonë kolegët. Por do të jetë pak e
6 ndërlikuar sa u takon kundërshtimeve se kanë dalë gjëra të
7 reja nga Prokuroria, çka kërkon kundërshtime shtesë nga ana
8 jonë, por që nuk mund t'i bëjmë në prani të dëshmitarit.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund ta
10 marrim listën dhe mund t'ju japim numra provizorë dhe më pas
11 mund t'i përdorim gjatë kundërpyetjeve. Nuk duam që t'ju
12 rrëzojmë kërkesën, por duam që të gjejmë një mënyrë të
13 arsyeshme për të vijuar më tej.

14 Z. PACE: [Përkthim] Po nëse do të vijojmë kështu, ne do
15 të donim një lloj garancie nga ju, që Mbrojtja nuk do të
16 kërkojë më vonë të thërritet sërish dëshmitari për shkak të
17 diçkaje që thoni ju në vendimin tuaj. Se përfitimi kryesor i
18 kësaj dhe pse keni marrë vendim të tillë ju më parë është që
19 në momentin që merret një vendim, të gjithë e kanë të qartë se
20 si është situata, dhe në kundërpyetje nuk mund të bëjë pyetje
21 për aspektet që nuk janë pjesë e provave gjyqësore.

22 Nuk e di çfarë donte të thoshte Avokati i z. Thaçi për
23 diçka të re që kam dëgjuar, por materialet që kërkojmë ne të
24 pranohen tërësisht janë pikërisht ato që kemi kërkuar të
25 pranohen sipas rregullës 154 fillimisht. Mbrojtja ka dhënë

1 përgjigje në lidhje me këtë, dhe Trupi Gjykues ka thënë që
2 këto materiale janë të pranueshme sipas rregullës 154 me
3 përjashtim të disa faqeve.

4 Kështu që, sa i takon kuadrit dhe kundërshtimeve, ndonëse
5 ne po kërkojmë të pranohen sipas një rregulle tjetër, nuk ka
6 ndonjë dallim sa i takon vlerës provuese, autenticitetit, të
7 këtyre deklaratave. Dhe lidhur me deklaratat e tjera, kërkojmë
8 të pranohen vetëm pjesët që unë citova gjatë pyetjeve të mia
9 me dëshmitarin këtë javë.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Më lejoni sepse më duhet të
11 shpjegoj qëndrimin tim dhe kjo nuk mund të bëhet në praninë e
12 dëshmitarit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
14 duhet të dilni nga salla e gjyqit tani në shoqërinë e
15 Asistentes së sallës. Do kemi një parashtrim mes palëve dhe do
16 ju thërrasim ne kur të jetë momenti.

17 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

19 Nuk po ndihmon këtë situatë. E kuptoj unë çfarë po
20 përpiqet z. Pace. Por në rrethanat aktuale ne kjo situatë nuk
21 na ndihmon të na thuash që deklarata e 2003, 2005 janë të
22 rëndësishme apo janë kontradiktore. Ai thotë që këto janë
23 pranuar më përpara dhe ne i kemi dijeninë, por tani po
24 kërkojmë të pranohen dy deklarata që kanë pjesë që janë
25 thelbësisht kontradiktore dhe që Prokuroria nuk e ka nxjerrë

1 se cilat pjesë të deklaratave po përdorin si të vërteta.

2 Pra, qëllimi i tij është i pakuptimtë. Ose të na thonë,
3 ne zgjedhim këtë pjesë të deklaratës së 2003, këtë pjesë të
4 deklaratës së 2005, e kështu me radhë.

5 Kundërshtimet tona janë si në vijim. E para njëherë, e
6 kemi thënë -- kundërshtimet që kemi për përdorimin e rregullës
7 143. Pjesa e re që dëgjuam sot paradite që Trupi Gjykues ka
8 thënë fjala "deklaratë" sipas rregullës 143 nënkupton tërësinë
9 e deklaratës. Ata thonë që ne duam të pranoni dhe deklarata të
10 plota, por edhe pjesëza të deklaratave të tjera, ndonëse Trupi
11 Gjykues ka thënë "deklaratë" nënkupton deklaratën në tërësinë
12 e vet.

13 Deklaratë, sipas meje, duhet të jenë vetëm pjesët që i
14 janë shfaqur dëshmitarit, por ju keni dalë me vendim që ka
15 kuptim tjetër.

16 Referenca tani për vendimin e rregullës 154 është
17 pikërisht pse jemi në një situatë unike. Ka kontradikta në ato
18 që ka thënë dëshmitari. Ju keni urdhëruar redaktime të këtyre
19 pjesëve.

20 Nëse nuk do të ishin të pranueshme sipas rregullës 154,
21 tani po thonë, hajde të përdorim 143 që t'i pranojmë të
22 gjitha, ndonëse ju keni kërkuar për disa pjesë që të
23 redaktohen.

24 Qëndrimi ynë është që në kuadër të rregullës 154, duhet
25 të kishin nxjerrë informacione *live* për pjesët që ishin

1 kontradiktore. Të kishim bërë këtë, dhe më pas ta
2 diskreditonin ose ta fajësonin këtu në sallën e gjyqit. Por
3 nuk mund të thonë po i përdorim të dyja rregullat, pranojini
4 të gjitha dhe Mbrojtja e di për çfarë e kemi në fjalën.

5 Dhe në fund më duhet të them që kjo cenon të drejtat për
6 një proces ligjor të drejtë, të mos dimë ne se çfarë pjesësh
7 duan ata të përdorin.

8 Dhe gjithashtu duhet thënë se deklarata e 2005-s si nga
9 Trupi Gjykses i TPNJ-së si nga paneli, edhe Trupi Gjykses i
10 Limajt, se nuk kanë qenë të besueshme. Ky ka qenë përfundimi,
11 pra kjo cenon nenin 10(c) dhe 30 të Kodit të Etikës që të
12 kërkosh të pranohen pjesë të një deklarate të 2005 për
13 vërtetësinë e përmbajtjes kur vetë Trupi Gjykses ka dalë në
14 çështjen Limaj, ka dalë me një përfundim tjetër. Dhe këtë e
15 bëjmë dhe thonë që këto pjesë janë të vërteta.

16 Kjo është diçka që ne kemi nevojë ta sqarojmë.
17 Faleminderit.

18 Z. DIXON: [Përkthim] Më lejoni të shtoj diçka. Ne duam ta
19 shohim çfarë ka në këtë email, se Prokuroria duhet fillimisht
20 të përcaktojë cilat janë mospërputhjet, ku i kanë pikëpyetjet
21 për këtë dëshmitar, ku po gënjen dhe cilat pjesët e vërteta.

22 Fillimisht duhen evidentuar mospërputhjet që ose të
23 trajtojmë besueshmërinë, ose vërtetësinë e përmbajtjes së
24 këtij dëshmitari. Ata mund ta bëjnë -- dua të shoh këto emaile
25 që t'i përgjigjem.

1 Të na thonë çfarë provash kanë. Të dalin me qëndrimin e
2 tyre lidhur me këtë dëshmitar, që ne ta kemi të qartë.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
4 vazhdoni, z. Pace.

5 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatës.

6 Do të filloj së pari me pikën që ka të bëjë me qëndrimet
7 kontradiktore. Do të mbështetem për këtë gjë lidhur me këtë
8 element me parashtrimet e këtij Trupi Gjykues, që është
9 F02580, të datës 17 dhjetor [Sipas përkthimit], paragrafi 14
10 ku thuhet që:

11 "... pasaktësia e pretenduar nuk pengon pranimin në prova
12 të një materiali të caktuar ..."

13 Jo vetëm kaq, por në këtë kontekst gjithashtu edhe në
14 vendimin për sa i takon parashtrimin F02117, në lidhje me të
15 njëjtin dokument në paragrafin 15, parashikohet se:

16 "... një palë nuk ndalohet nga ofrimi i provave të
17 ndryshme nga një dëshmitar në qoftë se e bën të plotë dhe e
18 bën të qartë që nuk po përpiqet që të mbështetet në një ose më
19 shumë dëshmi sa i takon vërtetësisë së përmbajtjes apo
20 kredibilitetit të dëshmitarit në fjalë. Kjo do të sigurojë që
21 Trupi Gjykues do të ketë gjithë informacionin e nevojshëm
22 përpara tij për ta vlerësuar besueshmërinë e dëshmitarit dhe
23 mbështetshmërinë në dëshminë e tij."

24 Sa i takon pranimit të deklaratës tërësisht në raport me
25 deklaratën pjesërisht, dua gjithashtu që t'i referohem

1 vendimit tuaj që jepet në parashtrimin F02130, paragrafi 20,
2 ku parashikohet se:

3 "Deklarata e mëparshme që është jopërputhëse përmbush
4 kriteret e rregullës 138, 143(2)(c) dhe kjo është çështje
5 diskrecioni për të vendosur nga Trupi Gjykses në qoftë se
6 deklaratat e mëparshme duhet të pranohen apo jo në tërësinë e
7 tyre ose duhet të pranohen pjesërisht dhe për të udhëzuar
8 palët që e thërrasin dëshmitarin të lexojë vetëm ato pjesë të
9 caktuara në gjykim për qëllimet për të cilat ato janë të
10 interesuara."

11 Kështu që nga ky aspekt, i nderuar Gjykatës, unë nuk kam
12 kundërshtim që Mbrojtja në qoftë se preferon dhe në qoftë se e
13 konsideron të arsyeshme, të marrë parasysh si gjithë
14 deklaratat në tërësinë e tyre të këtij dëshmitari, në qoftë se
15 kjo i volit më tepër qëndrimet e tyre. Në mënyrë të ngjashme,
16 Avokati për z. Thaçi përmendi gjithashtu edhe te rregulli 154
17 dhe mendimin e marrë mbështetur në të që përjashton pjesë të
18 caktuara nga pranimi, të cilat janë pjesë të parashikuara në
19 këtë rregull. Ne ju referohemi atyre përkatësisht, dhe
20 megjithëse nuk është e nevojshme që të vazhdojmë me
21 përjashtime të tilla në këto rrethana të reja, ne nuk e
22 kundërshtojmë këtë faqe që të përjashtohen nga pranimi sipas
23 rregullës 143, dhe arsyeja e thjeshtë për këtë është se
24 sikurse e përmendi dhe vetë Avokati, ne kemi nxjerrë
25 informacion *viva voce* nga ky dëshmitar, ashtu siç na ka

1 udhëzuar Trupi Gjykues në përputhje me procedurën që
2 parashikohet në rregullën 154.

3 Lidhur me pretendimin për shkeljen e gjykimit të drejtë
4 dhe -- të drejtave për gjykim të drejtë për të akuzuarit, ne
5 parashtrojmë që ne nuk kemi asnjë detyrim sa i takon
6 mospërputhshmërive që pretendohen se ekzistojnë në dëshmitë e
7 këtij dëshmitari. Ne nuk kemi dëgjuar asgjë sa i takon bazës
8 ligjore për kërkesa të tilla. Ne kërkojmë që dokumente të
9 tilla të mund të pranohen por vetëm për qëllime të kufizuara.
10 Për këtë arsye, përmbajtjet duhet të vlerësohen në kuadrin e
11 besueshmërisë së dëshmitarit.

12 Ta vendosësh Prokurorinë në një pozicion të tillë që të
13 përzgjedhë ato pjesë të cilat janë thelbësore për qëndrimin e
14 vet, është diçka e cila nuk ka të bëjë fare me vërtetësinë e
15 asaj çfarë është thënë nga dëshmitari dhe është e parakohshme.

16 Lidhur me parashtrimet e z. Thaçi që kanë të bëjnë me
17 deklaratën si të pabesueshme, ne e konsiderojmë atë të
18 besueshme sepse ne këtë, kështu e lexojmë vendimin e bërë nga
19 OTP-ja.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Së pari më lejoni të them që
21 Avokati iu referua vendimit të mëparshëm që në qoftë se
22 deklarata e mëparshme jopërputhëse i përmbush kriteret e
23 rregullës 145, kjo është një pikë e cila është në dorë të
24 Trupit Gjykues për ta vlerësuar në diskrecionin e tyre.

25 Ju kërkoj ndjesë se e humba fillin. Atëherë, thuhet që ka

1 të bëjë me vërtetësinë e përmbajtjes së tij. Megjithatë, sa i
2 takon besueshmërisë:

3 "... një palë nuk ndalohet që të kërkojë pranimin e
4 deklaratave nga një dëshmitar në qoftë se e bën të qartë se
5 nuk kërkon që të mbështetet në këto deklarata për vërtetësinë
6 e përmbajtjes ose për besueshmërinë."

7 Neve po themi që ajo çfarë duhet të bëjë Prokuroria është
8 që së pari duhet që të identifikojë ato pjesë në të cilat
9 mbështetet dhe nga ana tjetër duhet që të diskretitojë
10 dëshmitarin. Kjo është pika e parë.

11 Pika e dytë është që në fakt kolegu na tha që nuk është
12 detyrë e Prokurorisë për të na thënë neve se ku do të
13 mbështeten. Por nga ana tjetër në ndërhyrjen time të mëparshme
14 unë përmenda kodin e sjelljes. Dhe nga ana tjetër, pyetja që
15 shtrohet është në qoftë se e kanë ata të qartë se cili është
16 pozicioni ose qëndrimi i tyre duke marrë parasysh këtu
17 parashtrimet e OTP-së, por duke marrë parasysh edhe
18 konstatimet e dhomave të mëparshme, duke u mbështetur
19 gjithashtu dhe në kodin profesional të etikës. Ndërkohë që
20 kolegu deri tani nuk ka thënë asgjë që Trupi Gjykues në
21 çështjen kundër Limajt ka gjetur ndonjë gabim ose konstatimet
22 e tij nuk kanë qenë të vërteta. Për këtë gjë do të dua që të
23 shprehet Prokurori.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kjo është
25 arsyeja se pse propozova alternativa të ndryshme për sa i

1 takon pranimet të këtyre dokumenteve. Do bëjmë një pushim tani
2 për gjysmë ore, se jam i sigurt që përkthyesit janë të
3 tejlodhur. Do bëjmë pushim për 30 minuta pastaj do të kthehemi
4 përsëri për ta diskutuar këtë çështje.

5 --- Pauza fillon në orën 11.02

6 --- Seanca rifillon në orën 11.39

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta
8 trajtojmë këtë çështje jo me praninë e dëshmitarit, për
9 mbrojtjen e tij, gjithashtu dhe për mbrojtjen e
10 procesverbalit.

11 Gjykatësi Mettraux ka një pyetje.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kam një pyetje për ju z.
13 Misetiç.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Pse t'u desh kaq shumë kohë?

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Durimi që kam, z. Misetiç.

16 Dua që të sqarohem lidhur me një aspekt të parashtrimit
17 tuaj. Mënyra se si e kuptova unë, mbase nuk ju kam kuptuar
18 drejt, se ju ose kritikoni ose kundërshtoni faktin që ZPS-ja
19 po kërkon që të pranohen vetëm disa pjesë të caktuara të disa
20 deklaratave, dhe jo të gjitha deklaratat. Dhe në qoftë se e
21 kam kuptuar siç duhet unë këtë parashtrim tuajin, dua t'ju
22 pyes se çfarë sugjerimi keni ju, si duhet ta trajtojmë ne këtë
23 temë. Pra, në qoftë se ne vendosim që të pranojmë, sugjerimi
24 juaj do ishte që të pranojmë të gjithë deklaratën në tërësinë
25 e vet apo ju jeni në favor ose parapëlqeni që të pranohen

1 vetëm ato pjesë që u diskutuan me dëshmitarin?

2 Ju lutem, na e sqaroni pak këtë.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit. Së pari më lejoni të
4 them duke ju thënë që nuk e keni kuptuar drejt parashtrimin
5 tim.

6 Unë e thashë dhe më herët që deklaratat që parashtrohen
7 nga -- për dëshmitarin mund të pranohen për vërtetësinë e
8 përmbajtjes së vet. Dhe kur them deklaratat e kam fjalën për
9 pjesët e deklaratës të cilat Prokuroria i ka diskutuar me
10 dëshmitarin. Dhe ne themi që e njëjta gjë duhet të aplikohet
11 dhe për deklaratat e 2003 dhe 2005, çfarë do të thotë që ato
12 pjesë të deklaratës që janë diskutuar me dëshmitarin mund të
13 kërkohen që të pranohen si prova për vërtetësinë e
14 përmbajtjes. Në përjashtim të rasteve kur ka një konstatim ose
15 një vendim që pjesë të caktuara të deklaratës janë të
16 pavërteta. Në këtë rast pyetja që shtrohet është që: A mund të
17 pranojë diçka si të vërtetë ZPS-ja kur një gjykatë tjetër ka
18 vendosur që kjo nuk është e vërtetë?

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani më sqaruar.

20 Z. DIXON: [Përkthim] Edhe ne mbështesim plotësisht
21 qasjen.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ne do të
24 vazhdojmë më tej ekzaktësisht në mënyrën që sugjerova
25 fillimisht. Lista i është dërguar palëve dhe pjesëmarrësve nga

1 ZPS-ja. Të gjitha materialet do të marrin një numër provizor
2 të provës. Sot kjo do të jetë situata, megjithatë nesër do të
3 jepet një numër i provave të përkohshme gjyqësore, që do jetë
4 shterues. Në mënyrë të tillë që palët ta kenë më të thjeshtë
5 që t'u referohen këtyre numrave.

6 Në qoftë se ka kundërshtime lidhur me pranimin e këtyre
7 dokumenteve, duhet që parashtrimet të bëhen me shkrim deri të
8 martën e javës që vjen, dhe në qoftë se do ketë
9 kundërpërgjigje nga ZPS-ja atëherë do të duhet që të jepen
10 përgjigje deri të enjten. Trupi Gjykses do të vendosë për
11 pranueshmërinë sa më shpejt të jetë e mundur. Kundërpyetjet do
12 të vazhdojnë tani.

13 Mund ta trajtoni rastin si të doni, megjithatë do
14 sugjeroja që metoda më e mirë do të ishte që të konsideroni që
15 secila prej tyre do pranohej. Pra, të merrni këtë si opsion
16 ndërkohë që do bënit pyetjet tuaja. Është këshillë që nuk ma
17 kërkuat, por gjithësi po jua jap nga vetja këtë gjë.

18 Për t'iu përgjigjur një pyetjeje që doli, është që kur të
19 përfundoni me pyetjet tuaja dhe pasi të kemi vendosur ne për
20 pranueshmërinë, në qoftë se vendosni që të thërritet dhe një
21 herë dëshmitari, nuk ka arsye se pse të mos bëhet kjo gjë, ose
22 të kundërshtohet kjo nga Gjykata.

23 Pra, shpresoj që kam qenë i qartë aq sa mundesha, në
24 varësi të rrethanave.

25 Pak arsyetim, nëse më lejoni.

1 Së pari, kushtet ose kriteret parashtrohen në rregullat
2 tona. E kam fjalën për kriteret për pranueshmërinë. Deklarata
3 mund të pranohet sipas vlerësimit tonë për të dy arsyet, për
4 besueshmërinë dhe për vërtetësinë.

5 Mbrojtja nuk pretendon dhe nuk ka tregues që cenohet
6 aftësia për kundërpjetje pa një tregues të tillë.

7 Por nga ana tjetër Trupi Gjykses pajtohet që Mbrojtja
8 duhet të jetë e qartë sa i takon qëndrimin të ZPS-së.

9 Megjithatë një vlerësim i tillë nuk është një vlerësim i cili
10 mund të bëhet ose duhet patjetër të bëhet në kohën e kërkimit
11 të pranimit të dokumenteve. Kështu që për rrjedhojë, vlerësimi
12 do të duhet të bëhet në vlerësimin e tërësisë së dëshmisë.

13 Së fundi, vlerësimi për besueshmërinë e dëshmitarit dhe
14 vërtetësisë së tij është një vlerësim që duhet të bëhet nga
15 Trupi Gjykses. Kështu që vlerësimi i palës për këtë çështje
16 nuk është detyrues për Trupin Gjykses, por është, thjesht
17 shërben si udhëzim për vlerësimin e Trupit Gjykses.

18 Trupi Gjykses, për shembull, sa i takon vërtetësisë së
19 një dëshmie që ZPS-ja e konsideron si të vërtetë, ose e
20 kundërta, është një vlerësim që bëhet nga Trupi Gjykses dhe
21 mbi këtë bazë Trupi Gjykses vlerëson që ZPS-ja nuk kërkohet që
22 të, në këtë fazë të japë njoftim për Trupi Gjykses ose për
23 Mbrojtjen lidhur me pjesën ose pjesët që dëshmitari në
24 deklaratën e vet ka ofruar si informacion për vërtetësinë ose
25 për përmbajtjen e tij, ose besueshmërinë ose për të dyja.

1 Trupi Gjykues gjithsesi vlerëson se Trupi Gjykues pret që
2 ZPS-ja ta bëjë këtë çështje, ta sqarojë këtë element apo këtë
3 temë sa më shpejt të jetë e mundur dhe gjithashtu është e
4 rëndësishme, pra, që të sqarohet çfarë pozicioni ka.

5 Besoj që ka ardhur koha që të vazhdojmë me kundërpyetjet
6 e dëshmitarit.

7 Atëherë do vazhdojmë me rendin e zakonshëm për marrjen në
8 pyetje të dëshmitarit?

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës.

10 Z. ROBERTS: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë i nderuar
11 Gjykatës, por dua të sqaroj diçka përpara se sa të vijë
12 dëshmitari. Thjesht që dua të jem i qartë plotësisht se çfarë
13 kërkon të pranohet Prokuroria. Në qoftë se ato thjesht po
14 japin një argument të mëtejshëm ose në qoftë se ju thjesht po
15 i përgjigjeni emailit që sapo u dërgua.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Synimi është
17 që t'i përgjigjeni postës elektronike, domethënë mesazhit që
18 është dërguar me postë elektronike përpara se të vendoset në
19 qoftë se do pranohen këto dokumenta apo jo.

20 Z. ROBERTS: [Përkthim] Pa asnjë argument?

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po. Pastaj do
22 keni mundësinë që të kundërpërgjigjeni -- të merrni
23 kundërpërgjigje ndaj kundërshtimit.

24 Z. ROBERTS: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit, do
25 respektojme përgjigjen normale.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Brenda
2 kufizimeve të përcaktuar. Domethënë, deri të enjten, siç e
3 thashë dhe më përpara, përpara përfundimit të ditës.

4 [Dëshmitari vijon dëshminë]

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
6 tani do fillojmë me pyetjet e ekipit të Thaçit. Z. Misetic
7 është ngritur në këmbë, ai do fillojë që t'ju bëjë pyetje,
8 Dëshmitar. Ju lutem, dëgjojeni me vëmendje.

9 Z. Misetic, e keni ju fjalën.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit z. Kryegjykatës.

11 Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic:

12 Z. MISETIC: [Përkthim]

13 PY. Mirëdita z. Buja.

14 PË. Mirëdita.

15 PY. Sikurse e dëgjuat nga kryegjykatësi unë jam Luka Misetic.

16 Jam Avokati i Hashim Thaçit dhe kam disa pyetje për ju.

17 Pyetja e parë është kjo, domethënë pyetjet e para në fakt
18 janë pyetje që kanë të bëjnë me historikun tuaj. Familja juaj
19 ka mbështetur LDK-në përpara vitit 1998, a është e vërtetë
20 kjo, Dëshmitar?

21 PË. Po.

22 PY. Ju keni qenë në burg, jeni dërguar në burg nga
23 autoritetet serbe dhe jeni liruar në 1994-n në mos gabohem,
24 apo jo, Dëshmitar?

25 PË. Po.

1 PY. Pasi u liruat keni mbështetur LDK-në, kështu, është e
2 saktë kjo?

3 PË. Po, e saktë është.

4 PY. Shkurtimisht keni qenë udhëheqësi i degës së rinisë së
5 LDK-së në Lipjan, është e vërtetë kjo?

6 PË. Po, udhëheqësi, kryetari i degës së rinisë së Lidhjes
7 Demokratike në Lipjan.

8 PY. Vëllai juaj ka qenë anëtar i kryesisë së LDK-së, apo jo,
9 Dëshmitar?

10 PË. Po, është e vërtetë.

11 PY. A mund të na thoni për procesverbal se kush ishte ky
12 vëllai?

13 PË. Vëllai im i madh, Ramë Buja.

14 PY. Faleminderit. Dëshmitar, do t'ju bëj disa pyetje lidhur
15 me organizatën e njohur ndryshe si LPK.

16 LPK-ja, ndryshe nga LDK-ja ishte një lëvizje klandestine,
17 apo jo?

18 PË. Po, është e vërtetë.

19 PY. Ajo si objektiv të saj in kishte "çlirimin e të gjithë
20 territorit të -- me popullsi shqiptare", a është e saktë kjo?

21 PË. Po, e saktë është.

22 PY. Më herët ajo quhej LPRK, apo jo?

23 PË. Po, aktiviteti im para burgosjes ka qenë në LPRK, që
24 është quajtur Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës.

25 PY. A keni qenë në ndonjë kohë njëkohësisht anëtar i LPRK-së

1 edhe -- LDK-së, Dëshmitar? Domethënë, në të njëjtën kohë a ka
2 ndodh ndonjëherë që të keni qenë edhe anëtar i LPRK-së edhe i
3 LDK-së?

4 PË. Po, sepse veprimi LDK-së ishte publik ndërsa veprimi i
5 LPK-së ka qenë klandestin, apo i msheftë.

6 PY. A jeni zgjedhur ndonjëherë si anëtar i kryesisë së LPRK-
7 së?

8 PË. Jam zgjedhur anëtar i këshillit të përgjithshëm të
9 LPK-së.

10 PY. A mund të na thoni kur ka ndodhur kjo?

11 PË. Mund të mos e kujtoj datën apo muajin, por ka ndodhur pas
12 arritjes sime në Zvicër.

13 PY. Dua që të shqyrtojmë objektivat që kishte LPK-ja dhe
14 LDK-ja.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Për këtë arsye do i kërkoja
16 Sekretares të paraqesë në ekran dokumentin DHT04471 deri në
17 DHT04480, në versionin anglisht dhe në shqip, duke filluar në
18 faqen 3 në anglisht dhe në faqen 3 në shqip.

19 PY. Si anëtar i këshillit të përgjithshëm të LPK-së, a keni
20 pasur dijeni me statusin e LPK-së?

21 PË. Po, në atë kohë jam kanë i njoftuar.

22 PY. Së pari do t'ju tregoj statusin e LPK-së në vitin 1991,
23 më mënyrë të tillë që të kuptojmë programin dhe objektivat e
24 kësaj organizate. Pra, në qoftë se do shikojmë paragrafin në
25 fund në versionin në anglisht, paragrafin e dytë në të

1 djathtë. Pra, në qoftë se do lexoni këtë paragraf, aty thuhet:

2 "Pas LDB-së, trojet shqiptare nën Jugosllavi u copëtuan
3 në tri republika (Serbi, Maqedoni, ... Mal të Zi) dhe krahinën
4 e Kosovës (gjysmë autonome dhe kjo në kuadër të Serbisë)."

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Nëse do të vazhdojmë me faqen
6 tjetër. Aty niset me një paragrafin ku thuhet, pra në të
7 djathtë në anglisht, të paktën.

8 PY. Atëherë, fillojmë nga fillimi i faqes, tek numri 1.

9 Thuhet që:

10 "LPRK-ja është organizatë demokratike nacionalçlirimtare
11 që ka për qëllim ..." --

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund të vazhdojmë në të djathtë të
13 faqes.

14 PË. Pra:

15 "... që ka për qëllim:"

16 Një:

17 "Zgjidhjen e çështjes kombëtare të popullit shqiptar të
18 robëruar nën Serbi, Maqedoni dhe Mal të Zi, në bazë të parimit
19 të së drejtës së vetëvendosjes, duke përfshirë dhe të drejtën
20 për shkëputje."

21 Pika e dytë është:

22 "Ndërtimi i shoqërisë së re të lirë dhe demokratike
23 shqiptare në përputhje me vullnetin e popullit."

24 Në paragrafin tjetër thuhet:

25 "Arritjen e këtyre qëllimeve, LPRK-ja e sheh nëpërmjet

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Shukri Buja (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 67

1 bashkimit të gjithë popullit të robëruar shqiptar dhe forcave
2 të saj të organizuara ...”

3 E shikoni këtë, Dëshmitar? Dhe a i keni njohur këto
4 qëllime të LPRK-së?

5 PY. Po.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Kalojmë tek faqja 5 në anglisht,
7 faqja 6 në shqip. Ju kërkoj ndjesë, se në fakt e kisha fjalën
8 për një dokument tjetër.

9 Nëse më lejoni, z. Kryegjykatës, dua që të kërkoj që të
10 regjistrohet si provë gjyqësore statuti i LPRK-së i 1991.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë
12 kundërshtim?

13 Z. PACE: [Përkthim] Jo nuk kemi kundërshtim.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
15 DHT04471 deri në DHT04480 në anglisht dhe në shqip pranohet si
16 provë.

17 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, të
18 nderuar Gjykatës. Dokumenti dhe përkthimi në anglisht do të
19 marrin numrin e provës 1D00202. Klasifikohet si publik.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

21 Znj. Sekretare, tani do ju kërkoja që të paraqisnit në
22 ekran dokumentin DHT04456 deri në DHT04470. Në versionin në
23 shqip dhe në anglisht. Të shohim faqen 5 në anglisht dhe faqen
24 6 në shqip.

25 PY. Paragrafi që fillon me: “Populli shqiptar duhet të

1 orientohet ...” Pra, thuhet këtu që:

2 “Populli shqiptar duhet të orientohet drejt çlirimit të
3 Kosovës dhe formimit të shtetit të pavarur, që do të përfshijë
4 të gjitha trojet nën okupim ku shqiptarët janë shumicë.”

5 A e kuptoni kështu statutin e LPK-së, Dëshmitar?

6 PË. Po, i nderuar.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Të kalojmë tani tek versioni në
8 anglisht në faqen 6 dhe versioni në shqip në faqen 7.

9 PY. Përsëri, këtu jepen objektivat e njëjta të cilat ne i
10 kemi parë dhe në versionin e mëparshëm të statutit. Që është
11 krijimi, ose ka për qëllim çlirimin dhe formimin e shtetit dhe
12 çlirimin nga Maqedonia, Serbia, është e saktë kjo, Dëshmitar?

13 PË. Po.

14 PY. Ndërkohë që pika e dytë është:

15 “Ndërtimi i shoqërisë së re, të lirë e demokratike në
16 përputhje me vullnetin e popullit.”

17 E saktë?

18 PË. Po.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Nëse do të kalojmë tek faqja 9 në
20 anglisht dhe faqja 10 në shqip, do shohim se --

21 PY. Këtu përsëri fillohet duke thënë që:

22 “LPK-ja është organizatë demokratike, çlirimtare, e
23 pjesës së robëruar të kombit shqiptar nën Serbi, Maqedoni dhe
24 Mal të Zi.”

25 “LPK-ja synon formimin e frontit të gjerë popullor, pa

1 dallim feje, krahine a ideje, me forcat që janë të gatshme për
2 çlirimin e vendit.”

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Të vazhdojmë tek faqja tjetër.

4 PY. Thuhet:

5 “Pas çlirimit, LPK-ja do të angazhohet për ndërtimin e
6 shoqërisë shqiptare të lirë dhe demokratike, në përputhje me
7 vullnetin e popullit.”

8 A e keni kuptuar kështu qëllimin dhe objektivat e LPK-së
9 sikurse edhe ato përshkruhen në statutin e LPK-së, Dëshmitar?
10 PË. Kështu ka qenë ideja dhe kështu ka qenë edhe programi dhe
11 statusi i LPRK-së.

12 PY. Në statut nuk ka asgjë lidhur me avancimin e marksizëm-
13 leninizmit, apo jo, Dëshmitar?

14 PË. Më falni, se s’e ndëgjova mirë pyetjen.

15 PY. Po thoja që në statut nuk ka asgjë me avancimin ose
16 çuarjen përpara të marksizëm-leninizmit, apo jo?

17 PË. Jo, kjo ka qenë lëvizje popullore, nuk ka qenë në pyetje
18 çështja e orientimit të saj të majtë apo të djathtë.

19 PY. Faleminderit.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, ju kërkoj që të
21 pranoni në prova gjyqësore statutin e 1993 të LPK-së.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
23 kundërshtime?

24 Z. PACE: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtime.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti

1 DHT04456 deri në DHT04470, versioni në shqip dhe në anglisht,
2 pranohen në prova gjyqësore.

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, të
4 nderuar Gjykatës. Thjesht për të sqaruar që ERN-ja për
5 versionin në shqip është DHT04455 deri në DHT04470.

6 Ky dokument dhe përkthimi i tij në anglisht do të marrin
7 numrin e provës P1D00203, dhe klasifikohet si publik.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Shumë faleminderit.

10 PY. Tani, Dëshmitar, këto objektiva, qëllime dhe për këtë
11 arsye unë ju lexova pjesë që kishin të bënin me unifikimin e
12 tokave shqiptare në Serbi, Maqedoni dhe Mal të Zi. Këto
13 objektiva ose këto qëllime, u materializuan ose u vunë në
14 lëvizje me krijimin e zonave të ndryshme, a është e saktë kjo?

15 PË. Po, e saktë është.

16 PY. Kosova ka qenë Zona 1?

17 PË. Po.

18 PY. Maqedonia Zona 2?

19 PË. Po.

20 PY. Mali i Zi, ka qenë Zona 3?

21 PË. Nëse nuk gaboj, po.

22 PY. Ka pasur ndonjë zonë të katërt?

23 PË. Sipas njohurive të mia, po. Ka qenë Bujanovc, Preshevë,
24 Medvegjë.

25 PY. Po zonë të pestë, a ka pasur?

1 PË. Nuk më kujtohet.

2 PY. Arsyerja pse quheshin fillimisht nënzona kur filloi
3 veprimtarinë UÇK-ja, ishte sepse si ombrellë Kosova ishte Zona
4 1. Edhe ky ishte qëllimi, pra ishte Zona 1 në përpjekjet tuaja
5 për të krijuar bashkimin e të gjitha trojeve shqiptare,
6 kështu?

7 PË. Po, fillimisht Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka pas
8 programin e saj për çlirimin e territorit të pushtuara të
9 Shqipërisë dhe realisht këto territore kanë qenë në Mal të Zi,
10 Maqedoni, në Kosovën lindore, Preshevë, Bujanovc, Medvegjë,
11 dhe Kosova si një zonë e veçantë.

12 PY. Po, dhe qëllimet nuk ndryshuan deri në momentin që u
13 ushtrua trysni nga ndërkombëtarët, dikund nga vjeshta e 1998,
14 që ju thanë, "braktisini qëllimet që keni për të marrë
15 territoret në Maqedoni, Mal të Zi dhe në Luginën e Preshevës",
16 kështu?

17 PË. Kështu së paku më kanë informuar, sepse unë nuk kam qenë
18 pjesë e delegacioneve në takime me ndërkombëtarë.

19 PY. Po. Por ju keni dhënë dëshmi më përpara lidhur me këtë
20 pikë. Dhe keni thënë që, për shembull, keni dhënë një
21 deklaratë në çështjen Milosevic.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Për palët bëhet fjalë për
23 materialin SITF00283935 [Sipas përkthimit] deri në 00223961,
24 në faqen 6.

25 PY. Keni thënë që:

1 "U la mënjanë synimi politik për shkak të reagimit
2 negativ që pati në arenën ndërkombëtare. Në fund të tetorit
3 1998 atëherë nënzonat u kthyen në zona dhe kishim urdhra që
4 secili duhet të vepronte në zonën e tyre."

5 Pra, e keni ditur që ka pasur trysni nga ndërkombëtarët
6 edhe për shkak të trysnisë nga ndërkombëtarët nënzonat u
7 kthyen në zona, saktë?

8 PË. Po, fakt është, e thashë edhe ma herët, kam qenë i
9 informuar për këtë trysni dhe takimet me ndërkombëtarët.

10 PY. Këto qëllime ishin disi të ndryshme nga qëllimet e LDK-
11 së? LDK-ja, në programin e vet nuk kishte unifikimin e të
12 gjitha trojeve shqiptare, Kosovës, Luginës së Preshevës,
13 Maqedonisë dhe Malit të Zi, apo jo?

14 PË. Po, kështu ishte në programin e LDK-së.

15 PY. Çfarë ka qenë në programin e LDK-së?

16 PË. Me programin e LDK-së ka qenë territor për të bërë shtet,
17 edhe ka qenë Kosova në kufijtë administrative, që në atë kohë
18 e kemi kuptuar Kosovën që ne si UÇK e quanim Zona numër 1.

19 PY. E kuptova, po. Dallimi tjetër mes LDK-së dhe LPK-së ka
20 qenë që kjo e fundit, pra LPK-ja nuk e përjashtonte mundësinë
21 e një konflikti të armatosur për qëllime, për qëllimet e veta,
22 për përmbushjen e qëllimeve të veta, kështu?

23 PË. Po, është e vërtetë.

24 PY. LPK-ja dhe UÇK-ja ishin dy organe të ndara, apo jo?

25 PË. Me sa e di unë, po.

1 PY. Ju keni thënë disa herë se keni dijeni për daljen publike
2 të Jakup Krasniqit në qershor të 1998. Unë dua t'ju tregoj një
3 deklaratë të z. Krasniqi në qershor të 1998.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] I lutem Sekretarisë të vendosë në
5 ekran materialin me numër P01255-ET, faqja 1, dhe në anglisht
6 edhe në shqip. Paragrafi i dytë në ekran.

7 PY. Z. Krasniqi ka thënë në qershor kështu:

8 "Sa i përket ideologjive, Ushtria Çlirimtare e Kosovës
9 njeh për ideologji vetëm shqiptarizmin ..."

10 Si fillim, si e kuptoni ju këtë "shqiptarizimin" si term?

11 Çfarë është kjo, "mbarë-shqiptarizimi", si term?

12 PË. Po, ideologjia sipas kësaj deklarate është se të gjithë
13 shqiptarët do të, pa dallim feje, krahine apo ideje, të jemi
14 bashkë për çlirimin e vendit. Në këtë kuptim është thanë
15 sigurisht se kjo është ideologjia, që ta çlirojmë vendin
16 pavarësisht bindjeve që kemi.

17 PY. Kur thoni "vendin", e keni fjalën vetëm për Kosovën apo
18 kur thoni "vendin tonë", këtu përfshini dhe trojet e tjera
19 shqiptare?

20 PË. Deri në atë kohë, ne kemi pas idenë e çlirimit të të
21 gjitha trojeve shqiptare.

22 PY. Më tej vijon, thotë:

23 "Lëvizja Popullore e Kosovës është ajo forcë politike që
24 ka merita të pakontestuara në krijimin e Ushtrisë Çlirimtare
25 të Kosovës, është bazamenti fillestar këmbëngulës dhe i

1 qëndrueshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Dhe përkundër
2 kësaj, nuk ka kundërshtuar që UÇK-ja të jetë jashtë çdo
3 ombrelle partiake. Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare
4 të Kosovës është i mendimit se në këtë fazë të luftës
5 pluralizmi politik është luks.”

6 Dhe vijon më tej.

7 Sipas jush, ose të paktën si e keni kuptuar ju, UÇK-ja
8 vepronte jashtë ombrellës së LPK-së, Të paktën në qershorin e
9 1998?

10 PË. Po ju njoftoj se si ka qenë në zonën time ku kam operuar
11 unë në 1998-1999. Unë, në kuadër të komandës së zonës kam pas
12 të gjitha ngjyrat politike. Kam pasur shefin e shtabit i cili
13 ka qenë Hysen Shahini, dhe ka ardh nga forcat që ushtroheshin
14 në Shqipëri, të FARK-ut siç quheshin në atë kohë, dhe është
15 emëruar shefi i shtabit. Kam pas nga partia UNIKOMB në atë
16 kohë, që është quajtur, shefin e personelit, z. Naim Ymeri.
17 Kam pasur shef në operativë njërin i cili pas luftës ka dal
18 edhe kandidat për kryetar i LDK-së. Kam pasur edhe nga
19 Legaliteti, apo mbrojtës të mbretërisë.

20 Pra, kam pas të gjitha ngjyrat, por të gjithë këta ishin
21 me idenë e çlirimit të vendit tim.

22 PY. A të kujtohet që të jetë dërguar ndonjë urdhër në zonën
23 tuaj nga LPK-ja?

24 PË. Nga LPK-ja s'ka pas urdhra.

25 PY. Në rregull. Flasim për periudhën kur keni qëndruar me

1 LPK-në në Zvicër në 1997. Ju më herët përmendët disa nga
2 anëtarët më kryesorë të LPK-së në Zvicër në 1997. Më lejoni
3 t'i them emrat dhe më thoni.

4 Fazlli Beliu? Nëse e kam saktë. Fazlli Veliu, më falni.

5 PË. Ka qenë kryetari i Lëvizjes Popullore të Kosovës.

6 PY. Bardhyl Mahmuti?

7 PË. Ka qenë në kuadër të kryesisë së lëvizjes.

8 PY. Emrush Xhemajli?

9 PË. Nëse nuk gaboj, ka qenë sekretar i lëvizjes.

10 PY. Adem Grabovci?

11 PË. Ka qenë kryetari i nëndegës në Zvicër i LPK-së.

12 PY. Më herët keni dhënë dëshmi se ju besonit se Hashim Thaçi
13 ka qenë anëtar, por nuk ka qenë ndonjë zyrtar i lartë brenda
14 partisë, saktë?

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Thoni cila
16 parti.

17 Z. MISETIC: [Përkthim]

18 PY. Për partinë LPK e kam fjalën. Ka qenë anëtar i thjeshtë,
19 por jo një zyrtar i lartë, kështu?

20 PË. Po, kështu ka qenë.

21 PY. Në gjykimin Limaj -- më falni, është deklarata e
22 dëshmitarit në çështjen Limaj. Një çast ... Pra, keni thënë që
23 në atë kohë në 1997, Hashim Thaçi ka qenë pak a shumë person i
24 panjohur, kështu?

25 PË. Po, në atë kohë nuk është njoft në strukturat e Lëvizjes

1 Popullore të Kosovës.

2 PY. Të flasim për një temë tjetër. Kjo ka lidhje me momentin
3 e mbërritjes tuaj në Kosovë.

4 Në deklaratën e 2003, ju keni thënë se keni qenë një nga
5 komponentët më vokalë për kthimin në Kosovë dhe për
6 zhvendosjen e LPK-së atje, pra në Kosovë, kështu?

7 PË. Po, unë kam qenë insistues që të veprohet brenda në
8 Kosovë dhe kam shtrur këtë çështje shumë shpesh në kuadër të
9 organit në të cilin ishte, do të thotë, të këshillit të
10 përgjithshëm të LPK-së.

11 PY. Domethënë, ju personalisht morët vendimin që do të
12 ktheheshit në Kosovë, saktë?

13 PË. Po, realisht unë isha i gatshëm të kthehena në çdo moment
14 në Kosovë.

15 PY. Masakra e Jasharit i afroi planet tuaja për kthimin në
16 Kosovë, kështu?

17 PË. Po, është e vërtetë.

18 PY. Në dëshminë që keni dhënë në çështjen Limaj, ju keni
19 thënë që:

20 "Vendimi për të shkuar në Kosovë ishte një vendim që e
21 mora vetë unë. Sa i takon udhëtimit, e organizuan persona të
22 tjerë të LPK-së udhëtimin."

23 Kështu?

24 PË. Po, është e vërtetë.

25 PY. Kur vendosët të ktheheshit, njoftuat dhe anëtarët e tjerë

1 të LPK-së në Zvicër, përfshirë Adem Grabovcin, Hashim Thaçin,
2 Agim Bajramin, dhe vëllain tuaj Agush Bujën, lidhur me këtë,
3 kështu?

4 PË. Po, është e vërtetë.

5 PY. Në gjykimin Limaj, keni dhënë dëshmi, dhe keni thënë, se:

6 "Kur vendosa të kthehesha në Kosovë, më informuan se po
7 ktheheshin dhe persona të tjerë në Kosovë. Edhe unë informova
8 shokun tim të ngushtë dhe bashkëpunëtorin tim Agim Bajrami. I
9 thashë se ne do të ktheheshim në Kosovë."

10 Kështu?

11 PË. Po, sepse në bisedë me Agim Bajramin edhe më herët, me
12 idenë time për t'u kthyer për të vazhduar aktivitetin politik
13 në Kosovë, ashtu siç e kisha dhënë edhe propozimin në
14 këshillin e përgjithshëm të LPK-së, Agim Bajrami më kishte
15 tërhequr vërejtjen si shoku imi i ngushtë, se në rast se
16 vendosi të kthehem në Kosovë, duhet ta njoftoj sepse
17 përndryshe do të irritohet me mua.

18 PY. Pasi e informuat ju mësuat që në Kosovë po ktheheshin
19 edhe persona të tjerë, kështu ka qenë?

20 PË. Po.

21 PY. Ju në atë kohë nuk kishit dijeni për ekzistencën e
22 Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, apo jo?

23 PË. Jo, në fakt vetëm propagandohej ashtu, por nuk kisha
24 lidhje.

25 PY. A është e vërtetë që ju nuk e keni ditur fare kush kanë

1 qenë anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm?

2 PË. Jo, nuk e kam dit në atë kohë.

3 PY. Po a dinit ku qëndronte Shtabi i Përgjithshëm, ku e
4 kishte vendndodhjen?

5 PË. Në fakt, s'e kam ditur.

6 PY. Pra, pasi hytë në Kosovë, në mars të 1998, ose në
7 momentin që ishit në Shqipëri rrugës për në Kosovë, a është e
8 vërtetë që ju nuk e keni ditur në këtë moment se kush kanë
9 qenë anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm, ose të Shtabit
10 Qendror, kur ishit në Shqipëri pra rrugës për në Kosovë?

11 PË. Jo, s'e kemi ditur. E kam sqaruar edhe në deklaratat e
12 djeshme, nëse s'gabo, se anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm
13 nuk i kemi njoft në atë periudhë.

14 PY. Ju shkuat në Shqipëri me Hashim Thaçin, mes personave të
15 tjerë, saktë?

16 PË. Po, është e vërtetë.

17 PY. Ju në atë kohë nuk dinit gjë që të ishte ndonjë anëtar i
18 Shtabit të Përgjithshëm apo Shtabit Qendror, apo jo?

19 PË. Jo, në atë kohë vetëm LPK-ja e ka pas sektorin e
20 ndërlihdjes.

21 PY. Po. Jo, pyetjen e kisha kështu: Me sa dinit ju, në atë
22 kohë Hashim Thaçi nuk ishte anëtar i Shtabit të Përgjithshëm
23 apo Shtabit Qendror, sipas asaj që dinit ju, kështu?

24 PË. Nuk e kam dit a është anëtar i Shtabit Qendror.

25 PY. Ju po ashtu keni thënë në gjykimin Limaj:

1 "PY. Po a e konsideronit Hashim Thaçin në atë kohë, pra
2 në mars të 1998, anëtar të UÇK-së?

3 Dhe ju jeni përgjigjur:

4 "Nuk e konsideronim anëtar të UÇK-së, por e konsideronim
5 anëtar të LPK-së, e cila ishte një organizatë që ndihmonte
6 UÇK-në nga pikëpamja politike dhe materiale ...", "financiare"
7 -- më falni.

8 Kështu?

9 PË. Po, në atë kohë Lëvizja Popullore e Kosovës ka pas
10 qëndrimin e përkrahjes në aspektin politik dhe material.

11 PY. Grupi që u kthye nga Zvicra, ka qenë një grup prej 15
12 personash, thatë ju, të cilët vendosën nga Zvicra të shkonin
13 në Kosovë në mars të 1998, kështu?

14 PË. Nga Zvicra rreth 15 persona, po, por nga Shqipëria për të
15 hyrë në Kosovë kemi qenë më shumë.

16 PY. Po, keni thënë për këtë që kishte dhe persona të tjerë që
17 kishin ardhur nga Gjermania, Suedia, shtete të tjera, dhe jeni
18 takuar të gjithë së bashku në Shqipëri, kështu?

19 PË. Po, është e vërtetë.

20 PY. Pra, grupi që po hynte në Kosovë ju thatë se ka qenë një
21 grup prej përafërsisht 30 personash, e kam kuptuar drejt?

22 PË. Po, drejt.

23 PY. Disa prej këtyre personave, ndër këta persona -- më
24 falni, ishte Ismet Jashari, kështu?

25 PË. Po.

1 PY. Fehmi Lladrovci?

2 PË. Po.

3 PY. Xhem Lladrovci?

4 PË. Xhevë Lladrovci.

5 PY. Xhevë. Sami Lushtaku?

6 PË. Po.

7 PY. Dhe një person tjetër që më vonë keni mësuar se ka qenë

8 Fatmir Limaj, kështu?

9 PË. Po, e vërtetë është.

10 PY. Kur mbërritët në Shqipëri, filluat të bisedonit lidhur me
11 drejtimit që do të ndiqnit, apo jo?

12 PË. Po, fillimisht kemi qenë në Tiranë, pastaj në kufi.

13 PY. Po. Do t'ju lexoj diçka që keni thënë gjatë dëshmisë suaj
14 në 2003 për ZPS-në. Pyetje:

15 "A morët ndonjë urdhër për detyrat që do të kishit pasi
16 të hynit në Kosovë?"

17 Përgjigjja juaj ka qenë si në vijim:

18 "Po. Kur ishim bashkë si grup, ne shkuam -- grupi u
19 formua në kufi. Hashim Thaçi, Fehmi Lladrovci dhe unë,
20 diskutuam si të hynim në Kosovë, ku të shkonim pasi të hynim
21 në Kosovë, kë të takonim, dhe çfarë detyrash të kryenim. Dhe
22 me sa kuptova unë, unë isha personi që u caktua të merrej me
23 shtypin dhe me çështjet e propagandës.

24 Pyetje:

25 "Kush ishte personi që ju shpërndau detyrat?"

1 Ju jeni përgjigjur:

2 "Nuk ka pasur ndonjë detyrë [Sipas përkthimit] të qartë
3 detyrash. Ne kemi biseduar, kemi shkëmby ide, dhe kemi
4 vendosur që ky do jetë grupi avangardë, grupi që do të
5 kryesojë pjesën tjetër të grupit drejt Kosovës."

6 Të duket e drejtë kjo? Ka qenë me përfaqësi mënyra se si
7 janë shpalosur ngjarjet në kufi?

8 PË. Po, realisht kështu kemi vendos. Kemi bisedu çka të bojm,
9 si të bojm, dhe në këtë formë edhe kemi vendos.

10 PY. Pra, siç e kuptoj unë, ju keni thënë që keni një grup
11 personash që keni bisedu me njëri-tjetrin se ku të shkonte
12 secili prej jush pasi të hynit në Kosovë, saktë?

13 PË. Po, e saktë është.

14 PY. Nuk ka pasur një person enkas përgjegjës për këtë punë,
15 kështu?

16 PË. Jo, në grupin prej 30 që kemi hyrë në Kosovë, ne jemi
17 llogaritur si ushtarë dhe vullnetarë. Dhe krejt kemi qenë të
18 barabartë. Jemi njoftuar një pjesë bukur ama edhe mes veti,
19 edhe kështu ka qenë.

20 PY. Në këto momente, me sa kuptojmë ne nga përgjigjja juaj,
21 nuk e keni konsideruar Hashim Thaçin komandant?

22 PË. Jo, se s'ka qenë komandant Hashim Thaçi.

23 PY. Gjithashtu, po në 2003, ju kanë bërë pyetjen vijuese:

24 "... a keni marrë ndonjë urdhër për detyrat që do të
25 kryenit pasi të hynit në Kosovë?"

1 Më falni, mos e merrni -- mos e merrni parasysh këtë
2 pyetje.

3 Keni thënë diçka të ngjashme në gjykimin Limaj, për
4 procesverbal. Keni thënë:

5 "... në atë kohë nuk kemi marrë urdhra prej askujt."

6 Kështu?

7 PË. Po.

8 Z. PACE: [Përkthim] Më lejoni në bazë të paragrafit 120,
9 të urdhrit për zhvillimin e procesit gjyqësor, kur i paraqitet
10 dëshmitarit diçka që ka thënë në një dëshmi të mëparshme, pala
11 nuk duhet të bëjë përmbledhje apo perifrazim të asaj që ka
12 thënë dëshmitari, por duhet të citojë atë që ka thënë
13 dëshmitari dhe të japë numrin përkatës të transkriptit apo të
14 deklaratës së mëparshme, për të gjitha palët.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Unë po përpiqem të kursej kohë,
16 sepse nëse filloj me citimet, janë jashtëzakonisht të gjata.
17 Megjithatë, nëse Prokurori dëshiron, unë mund të bëjë citimet
18 përkatëse.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdojmë.
20 Nuk pati asgjë të gabuar në mënyrën se si i bëtë pyetjen.

21 Z. PACE: [Përkthim] A ta sqaroj që unë po mbështetem në
22 urdhrin tuaj për zhvillimin e procesit gjyqësor?

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo.

24 Z. MISETIC: [Përkthim]

25 PY. Shohim diçka që ju e keni thënë në 2003, në 2005, e

1 vazhdimisht këtu gjatë këtyre ditëve që keni qenë në sallën e
2 gjyqit. A e keni konsideruar ju Fatmir Limaj si eprorin tuaj
3 të drejtpërdrejtë, sipas asaj që keni thënë?

4 PË. Unë e kam konsideruar në aspektin moral, e kam thanë dje,
5 si komandantin tim të parë për shkak se na ka përcjell disa
6 persona që kemi qenë pesë, deri në Malishevë, do të thotë,
7 prej Drenice në Malishevë. Në këtë aspekt, do të thotë, e kam
8 konsideru si komandantin tim të parë, por jo sepse ka pasur
9 ndonjë detyrë si komandant z. Limaj.

10 PY. Tani, kur mbërritët në Drenicë -- po e marrim sipas
11 radhës. Ju hytë si grup në Kosovë dhe të gjithë së bashku
12 shkuat në Drenicë, kështu?

13 PË. Po.

14 PY. Më pas, ju patët, domethënë, juve ju caktuan një zonë në
15 Kosovë ku do të shkonit, secili prej jush pati një zonë në
16 Kosovë, kështu?

17 PË. Po, kërkoja që të shkoj në atë pjesë ku e njihja unë, do
18 të thotë, në komunën ku kisha lindur, në komunën e Lipjanit
19 dhe të Shtimes.

20 PY. Po pse kërkoje të shkoje në vendin ku kishe lindur?

21 PË. Po gjatë bisedës në territorin e Drenicës, bisedave me
22 shokë që kemi bërë me ata që i njihnim mirë, dhe në prezencë
23 edhe të Agim Bajramit, edhe të Ismet Jasharit, edhe të Hashim
24 Thaçit, edhe të shokëve që ishin, që unë në atë kohë nuk i
25 njihja, por ishte edhe Fehmi Lladrovci që unë e njihja, në

1 bisedë me ta, do të thotë, kuptova se nuk ka ndonjë organizim
2 në këtë pjesë të territorit të Kosovës ku unë i njihja
3 njerëzit ku kisha, kisha lindur dhe i njihja dhe ish-të
4 burgosurit politikë edhe aktivistë të partive të tjera sepse
5 isha marrë me çështje politike për një periudhë të gjatë.

6 PY. Z. Limaj ka shkuar në Malishevë, kështu?

7 PË. Në territor të Malishevës.

8 PY. Edhe Malisheva ka qenë vendlindja e tij, apo jo?

9 PË. Ka qenë një fshat i Malishevës, nëse s'gaboj, Banjë i
10 Malishevës.

11 PY. Në rregull. Po Fehmi Lladrovci, ku shkoi?

12 PË. Fehmi Lladrovci ka qëndruar në Drenicë sepse ishte nga
13 fshatrat e Drenicës.

14 PY. Po Hashim Thaçi ku shkoi, dini gjë?

15 PË. Edhe Hashim Thaçi besoj që ka ndejt në Drenicë sepse ka
16 qenë nga territori i Drenicës.

17 PY. A është e vërtetë që të gjithë në grupin tuaj shkuan në
18 vendet prej nga vinin, në vendlindje të tyre?

19 PË. Sipas asaj që unë e kam ditur, do të thotë, shumica prej
20 tyre kanë shku nëpër vendet ku e kanë njoftun vendin dhe ku
21 kanë qenë të lindur. E di se ka shkuar edhe një epror që ne në
22 atë kohë e quanim Cete, ka shkuar në Llap. Nji tjetër ka
23 dëshiruar të deportojë, që ka qenë nga Gjilani, e ma vonë e
24 kemi qujt Gjilani, në Gjilan ku nga dhe ishte i lindur, por
25 secili jemi munduar të shkojmë në territoret ku e kemi njoftur

1 territorin dhe ku kemi lindur.

2 PY. Pra, nuk pati ndonjë strategji të përgatitur se ku do të
3 shpërndareshin personat. Në thelb secili vendosi të shkonte në
4 vendlindjen e tyre, sepse atë territor njihnin më mirë. A të
5 duket i drejtë ky parashtrim?

6 PË. Po, është i drejtë, sepse edhe unë kam shkuar në atë
7 formë, edhe Agim Bajrami ka shkuar në të njëjtën formë në
8 territorin ku e njihnte, në komunën e Kaçanikut.

9 PY. Edhe ju nuk kishit nevojë për ndonjë urdhër që të shkonit
10 në vendlindjet tuaja dhe të organizonit UÇK-në në territoret
11 tuaja, kështu?

12 PË. Nëse nuk gaboj, dje e thashë, po të na thonin në formën e
13 urdhrit, ne në atë kohë e kemi njoft njëri-tjetrin si të
14 barabartë dhe do të kishim marrë me shaka. Ne kemi vendos vetë
15 sepse kemi qenë vullnetarë, kemi hyrë në Kosovë me vullnetin
16 tonë, dhe kemi vendos se ku të shkojmë të organizohemi sa ma
17 mirë, aty ku e kemi njoft terrenin dhe njerëzit.

18 PY. Pra, lidhur me këtë pyetje --

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Edhe për hir të Prokurorit, do
20 kërkoj të shfaqet edhe deklarata përkatëse. Është materiali me
21 numër IT-03-66 P160-TR-ET, faqja 30, në fillim të rreshtit 16,
22 dhe shqipja fillon në faqen 29. Fillojmë nga rreshti 16 tek
23 anglishtja.

24 PY. Është bërë një pyetje aty:

25 "Në rregull. Dua të bëjmë një sqarim. Ky grup që më pas u

1 udhëhoq nga Fatmir Limaj, a ju caktuan ju të shkonit në një
2 territor të caktuar për të filluar organizimin? A është kjo e
3 saktë?"

4 Shkojmë në rreshtin 25, dhe ju keni thënë:

5 "Po, ka qenë një gjykim i pavarur, një vendim i pavarur."

6 Shkojmë në faqen tjetër.

7 "... Mendoj sepse askush nuk mund të na urdhëronte të
8 thoshte, 'shkoni aty e bëni këtë'. Sepse ashtu, e atillë ishte
9 situata, por më shumë për shembull menduam që Mullapolci është
10 mënyra më e mirë, kush është shtëpia më e sigurt për shkak të
11 arsyeve të sigurisë dhe ia thojë këtë fakt personit tjetër, ia
12 përcillje."

13 E patë edhe ju këtë?

14 PË. Po.

15 PY. A është në përputhje kjo me atë çfarë thatë dhe më herët
16 që askush nuk ju urdhëronte ju dot se ku të shkonit?

17 PË. Po ne kemi mujt me njoftu njëri-tjetrin, por me na
18 urdhëru, do të thotë, nuk ka në atë kohë çështja e
19 urdhëresave, por kemi njoftu njëri-tjetrin për vendimin se ku
20 do të shkojë.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Të kalojmë në faqen 32, duke
22 filluar nga rreshti 9 në anglisht edhe në faqen 31, në
23 rreshtin 1 në shqip.

24 PY. Pyetja është kjo:

25 "Këto përcaktime që ju sapo i përmendët, do të thotë, që

1 çdo person caktohej në një zonë të caktuar, këto përcaktime ju
2 janë dhënë atyre prej Hashim Thaçit në Drenicë?"

3 Përgjigjja që ju jepni është që:

4 "Faktikisht orientimet si urdhër nuk janë dhënë se nuk ka
5 pasur se organizata nuk ka qenë ekzistuese në atë kohë, nuk
6 kishte organizim. Dhe për këtë arsye ne duhet që të shkonim
7 atje dhe të fillonim gjërat."

8 E shikon? E shikon këtë pjesën, Dëshmitar?

9 PË. Po.

10 PY. A është e saktë që dëshmia juaj në 2003 është që nuk ka
11 pasur orientime ose urdhra të qarta nga Hashim Thaçi në
12 Drenicë?

13 PË. Po, kështu e kam sqaruar si duket. Dhe kjo është e
14 vërteta, që s'ka pas urdhra.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Të qëndrojmë te kjo faqe. Është
16 faqja 30 -- jo, i takon që është 31, kështu që do kërkoja që
17 të kthehemi pas një faqe në versionin në shqip, domethënë, 30,
18 në faqen 30 në anglisht dhe 28 në shqip.

19 PY. Dua që t'ju pyes edhe lidhur me diçka tjetër.

20 Ju pyeta më përpara që keni thënë në 2003, 2005, dhe këtu
21 përpara Trupit Gjykues që Fatmir Limaj ka qenë eprori juaj
22 kryesor i drejtpërdrejtë. Dhe keni thënë dhe herë të tjera,
23 keni thënë dhe nën betim që ju në atë kohë keni besuar që ai
24 ka qenë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm. A është e saktë kjo,
25 Dëshmitar?

1 PË. Po, unë kam supozuar që është anëtar i Shtabit të
2 Përgjithshëm.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani të shohim fillimin, në fillim
4 të faqes, të rreshtit 3, dhe rreshtit 18 në anglisht.

5 PY. Këtu thuhet:

6 "A të ka thënë Hashim Thaçi që Fatmir Limaj ishte personi
7 që do të ishte komandanti i këtij njësitei që do të shkonte në
8 zonë?"

9 Ju thoni:

10 "Jo, por ne e dinim që Fatmir Limaj ishte personi më
11 kompetent sepse ai e njihte terrenin më mirë se sa të tjerët.

12 "Fatmir Limaj u caktua që të koordinonte, bashkërendonte
13 gjërat me Shtabin e Përgjithshëm ndërkohë që detyra ime që të
14 bashkërendoja, koordinoja gjërat me Fatmirin."

15 A e shikon këtë pjesë?

16 PË. Po.

17 PY. Më pas vazhdon më tej:

18 "Pra, në goftë se do të duhej që të bëhej organizim
19 tjetër i njësiteve, unë duhej që t'i drejtoja, t'ia përcillja
20 Fatmirit, pastaj Fatmiri në Shtabin e Përgjithshëm. Dhe ata të
21 na i kthejnë pastaj se me çka do të veprojmë më tutje."

22 A është e saktë kjo, Dëshmitar?

23 PË. Jo, unë këtu edhe e kam kërkuar ndryshimet para se të
24 shkoja në gjykim, sepse kanë mund të ndodhin gabimet e mia,
25 nga ajo që është propaganduar në atë kohë. Realisht Fatmiri e

1 ka pas, apo s'e kam konkretizuar, detyrën që të më përcjell
2 deri në Drenicë. Do të thotë, kjo ka qenë sepse unë e kam pas
3 përshtypjen se njerëzit ma kompetentë mund të jenë në Drenicë.
4 PY. Tani po ju pyes që ju pajtoheni se kjo është ajo çfarë
5 keni thënë në 2003, dhe pastaj e keni korrigjuar këtë në 2005,
6 sikurse e thatë dhe tani. A është kështu, Dëshmitar?

7 PË. Po, si duket, po.

8 PY. Ajo çfarë keni thënë në 2005 është ekzaktësisht ajo që
9 thatë pak më herët, përveçse ju e keni përdorur Fatmir Limajn
10 për t'ju çu në Drenicë, kur mund të kontaktonit me Hashim
11 Thaçi për të kontaktuar me Shtabin e Përgjithshëm. A është
12 kështu?

13 PË. Po, kështu e kam thënë.

14 PY. Ju lutem, më ndihmoni ta kuptoj ndryshimin e dëshmisë
15 tuaj në 2005. Sepse, ju keni menduar në atë kohë që Fatmir
16 Limaj ka qenë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm që sapo na e
17 konfirmove. Dhe ju thatë që e keni mendu atë që të ishte
18 eprori juaj i drejtpërdrejtë, ose komandanti juaj kryesor. Dhe
19 keni thënë gjithashtu që nuk mendonit që Hashim Thaçi ishte
20 anëtar i Shtabit të Përgjithshëm, keni thënë gjithashtu që
21 kush kanë qenë anëtarët e tjerë të Shtabit të Përgjithshëm.

22 Kështu që pyetja që kam për ju është kjo: Pse në qoftë se
23 ti doje që të kontaktoje me Shtabin e Përgjithshëm, pse nuk
24 shkoje ti te Fatmir Limaj të cilin ti e mendoje në atë kohë që
25 ishte anëtar i Shtabit të Përgjithshëm?

1 PË. Po unë vetëm supozoja në atë kohë. Qysh kam supozu edhe
2 për Hashim Thaçin. Por unë kam pasur bindjen se territori i
3 cili ishte, i çliruar në një farë forme, ishte në Drenicë,
4 edhe aty do të jenë anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm. Edhe
5 ky ka qenë ai mendimi që unë të shkoj përmes Fatmirit në
6 Drenicë për të kontaktuar me Hashim Thaçin i cili do të mund
7 të me më kontaktu me Shtabin Qendror apo i Përgjithshëm, tash
8 s'po më kujtohet si e kemi quajtur në atë kohë. Kjo ka qenë ai
9 vizioni im për me taku Shtabin e Përgjithshëm

10 PY. Në rregull. Ta marrim hap pas hapi. Fatmir Limaj dhe ti
11 ishit relativisht afër njëri-tjetrit në terren në atë kohë,
12 apo jo, Dëshmitar?

13 PË. Unë kam lëvizur shumë në terren, ka mund të jem për një
14 periudhë në Kaçanik me Agim Bajramin, pastaj në Ferizaj ku nuk
15 kishte ende njësi guerile, apo nuk kishte person përgjegjës,
16 dhe në Mullapolc. Mullapolci me Kleçkën ka qenë një afërsi ma
17 të madhe se sa që ka qenë Kaçaniku apo fshatrat e Kaçanikut me
18 Mullapolcin. Ka qenë territor më i afërt.

19 PY. Megjithatë, mënyra se si e kuptoj unë dëshminë e 2005 dhe
20 ajo çfarë po thoni ju tani, është që ju ishit mjaftueshëm afër
21 Fatmir Limajt, sa që shkove te Fatmir Limaj në mënyrë të tillë
22 që ai t'ju përcillte ju për në Drenicë, a është e vërtetë kjo?

23 PË. Po, e vërtetë është.

24 PY. Kjo do të thotë që ju kishit mundësi që të shkonit të
25 kontaktonit Fatmir Limajn të parin, kështu?

1 PË. Po, Fatmir Limajn mujsha me e kontaktu ma lehtë.

2 PY. Ju besonit në atë kohë që Fatmir Limaj ishte anëtar i
3 Shtabit të Përgjithshëm, apo jo?

4 PË. Unë supozoja, do të thotë, që Fatmir Limaj ishte anëtar i
5 Shtabit të Përgjithshëm.

6 PY. Në rregull. Pra, ju supozonit që ai ishte anëtar i
7 Shtabit të Përgjithshëm. Pyetja që kam prapë për ju është kjo:
8 Duke marrë parasysh këtë supozim, pse nuk i keni thënë ju atij
9 çfarëdo lloj gjëje që ti do të doje t'jua përcillje Shtabit të
10 Përgjithshëm, pse s'ia ke thënë Fatmir Limaj këtë gjë?

11 PË. Realisht Fatmir Limaj unë nuk e kam njoft përpara. E kam
12 njoftur vetëm në periudhën e hyrjes në Kosovë, siç e thashë ma
13 herët. Dhe besimi në atë kohë ka qenë tepër me rëndësi se kujt
14 i beson. Dhe normalisht që unë kam kërkuar gjithmonë nga
15 Fatmiri që të shkoj te njeriu që kam besuar për të më takuar
16 me Shtabin e Përgjithshëm. Këtu ka qenë një periudhë, do të
17 thotë, e një veprimi bukur të rand të Ushtrisë Çlirimtare të
18 Kosovës, dhe kam kërkuar gjithmonë të kontaktoj me njerëzit që
19 i kam njoft përpara. Njerëzit që i kam njoft përpara kanë qenë
20 në Drenicë, ku ka qenë Hashim Thaçi, ka qenë Fehmi Lladrovci,
21 kanë qenë edhe njerëzit e tjerë që i kam njoft edhe në
22 veprimin politik dhe kam pas besim te ta.

23 PY. A është e saktë që tani po thoni që nuk i besonit Fatmir
24 Limajt?

25 PË. Nuk është çështja e besimit, por në kuptimin e besimit që

1 kemi pasur në atë kohë, ne kemi vepruar me besimin e plotë. Në
2 qoftë se e kemi njoft një njeri shumë mirë, atëherë kemi
3 vepruar me të shumë ma lirshëm dhe realisht Fatmiri vepronte
4 në Kleçkë, unë kërkoja nga Fatmiri që të më drejtojë në
5 Drenicë ku do të kisha mundësi me u taku me Shtabin e
6 Përgjithshëm.

7 PY. Tani, na e sqaroni pak këtë, a e besonit Fatmir Limajt
8 apo nuk i besonit Fatmir Limajt?

9 PË. I besoja për aq sa ishte e nevojshme me i besu, do të
10 thotë, në atë kohë. Nuk mund të besoja se ai mund më orientojë
11 si anëtar i Shtabit të Përgjithshëm.

12 PY. Megjithatë, i besonit mjaftueshëm atij për t'ju përcjellë
13 deri në Drenicë, kështu?

14 PË. Po, ky ishte besimi.

15 PY. Atje, sikurse na e thatë, ju nuk e dinit që Hashim Thaçi
16 ishte anëtar i Shtabit të Përgjithshëm? Pra, nëse e kuptoj
17 dëshminë tuaj tani, është që ju nuk ia keni përcjellë
18 informacionin Fatmir Limajt që besonte që ishte anëtar i
19 Shtabit të Përgjithshëm, por i besonit atij mjaftueshëm që
20 t'ju çonte në Drenicë për të folur me Hashim Thaçin që ju nuk
21 besonit se ishte anëtar i Shtabit të Përgjithshëm, por te i
22 cili besonit që mund t'ia jepnit informacionin që ky i fundit
23 t'ia jepte Shtabit të Përgjithshëm, kështu?

24 PË. Po, edhe në kontaktin e fundit që kemi pas me grupin që
25 kemi hyrë, realisht ne e kemi besuar se dikund është, janë

1 anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm. Por ne nuk kemi besuar në
2 atë kohë se është dikush nga ne anëtar i Shtabit të
3 Përgjithshëm, por kemi llogarit se jemi të gjithë ushtarë.
4 Supozimet e mia kanë qenë supozime individuale. Por ajo që kam
5 besuar unë, kam besuar se përmes Hashim Thaçit në Drenicë apo
6 Fehmi Lladrovci, i cili ka pas edhe një përvojë bukur të
7 gjatë ushtarake, mund të kontaktoj dhe të marr udhëzime nga
8 Shtabi i Përgjithshëm.

9 PY. Në 2003 thatë që jeni caktuar që të bashkërendonit
10 operacionet në Kaçanik, Ferizaj, Shtimje dhe Lipjan nga Fatmir
11 Limaj. A është e saktë kjo?

12 PË. Në fakt unë e kam quajtur bashkërendim, por s'ka qenë
13 ndonjë emërim i bashkërendimit. Unë punën që e kam bërë në atë
14 kohë duke përcjell edhe armatimin, edhe kontaktet me Agim
15 Bajramin, pastaj në mes ka qenë komandant Ferri, ma vonë, por
16 unë prej Agimit, përmes Ferrit, në Mullapolc, edhe deri në
17 Kleçkë, do të thotë, kam bashkërenduar veprimet me njësitet
18 guerile.

19 PY. Këto njësite pastaj ju i koordinonit ose i bashkërendonit
20 bashkë me Fatmir Limaj, kështu?

21 PË. Po bashkërendimin e bënim të gjithë komandantët e
22 njësiteve. Agim Bajrami me komandant Ferrin, komandant Ferri me
23 mua, apo Imri Ilazin me mua, dhe pastaj me Fatmir Limajn. Do
24 të thotë, kështu kemi shkuar duke u koordinuar si njësite të
25 veçanta të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

1 PY. Roli jua j si bashkërendues, si koordinator, që mbulonte
2 zonën e Kaçanikut, Ferizajt dhe Shtimes, ka zgjatur në
3 periudhën maj-qershor 1998, apo jo?

4 PË. Ka zgjatur në periudhën e qershorit, nuk di a ka qenë
5 edhe maji, por maj-qershor, sigurisht.

6 PY. Në prill dhe në maj, a është e saktë që në Krojmirë ju
7 keni qenë përgjegjës së bashku me Ramiz Qeriqin?

8 PË. Unë nuk kam qenë përgjegjës, sepse s'ka pas një titull të
9 tillë, por kemi qenë të dy, do të thotë, në një farë forme
10 komandim dualist.

11 PY. Tani do të kalojmë tek një pjesë tjetër e deklaratës së
12 dhënë prej jush në 2003.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Për këtë do i kërkoja Sekretares
14 të paraqesë në ekran dokumentin IT-03-66 P160-TR-ET, faqja 53,
15 duke filluar nga rreshti 18 në anglisht, edhe në faqen 54,
16 duke filluar nga rreshti 23 në shqip.

17 PY. Kjo është pyetja:

18 "Por gjithashtu në maj, qershor, korrik, të gjithë këto
19 muaj 'Çeliku' ka qenë në Kleçkë?"

20 "Po, po, ai ka qenë aty."

21 Atëherë për të qenë të qartë, Çeliku, kur thuhet Çeliku
22 këtu është fjala për Fatmir Limaj, apo jo?

23 PË. Po, kështu e kam njoftur, me pseudonim.

24 PY. Po, dhe pastaj vazhdon më tej:

25 "Prapë po mundohem që të sqaroj pak lidhur me rolin e

1 Kumanovës.”

2 Kush ishte Kumanova? Dëshmitar, kush ishte Kumanova?

3 PË. Ishte një bashkëluftëtar i joni, që kemi hyrë bashkë me
4 të. Dhe ai ka komanduar një njësit në atë kohë në fillet e
5 luftës çlirimtare, një njësit i cili u qujt njësit gueril.

6 PY. A e dini si quhej ai? Si e kishte emrin?

7 PË. Ishte Ismet Jashari. Ne e thirrnim Kumanova.

8 PY. Në rregull. Vazhdojmë me transkriptin. Thotë:

9 “Në rregull. Po mundohem të sqarohet roli i Kumanovës
10 tani.

11 “Ju thoni që ai ka qenë personi në pozitën më të lartë në
12 Kleçkë. A do të thotë kjo që ai u ka dhënë urdhra të tjerëve,
13 apo thjesht ka qenë drejtuesi i ushtarëve në Kleçkë?”

14 Ju thoni:

15 “Unë këtë nuk e di, sepse kontaktet ose takimet e mia
16 ishin me Çelikut. Por Kumanova ndodhte që të ishte aty i
17 pranishëm gjatë takimeve të mia me Çelikut, kështu që ishte
18 punë që mbështetej më shumë në konsulta se sa në urdhra.
19 Kështu që le të themi që unë jam konsultuar, kam konsultuar
20 ose kam diskutuar lidhur me furnizimet me armë, furnizimin me
21 armë.

22 “Vijën furnizuese me armë.

23 “Dhe më shumë kanë qenë konsulta, bëje këtë, ose mos e
24 bëj këtë. Do të thotë, e kemi shqyrtuar dhe çka mund ‘Çeliku’
25 me sqaru ka qenë faktikisht na ka kërku që të konsultohemi me

1 anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm.”

2 A e shikoni këtë, Dëshmitar?

3 PË. Po.

4 PY. Ajo çfarë keni thënë në 2003 është që lidhur me
5 furnizimin ime armë jeni konsultuar me Fatmir Limajn për këtë
6 çështje, dhe në qoftë se ai nuk e ka zgjidh këtë problem, ai i
7 drejtohet drejtpërdrejt Shtabit të Përgjithshëm, këtë keni
8 thënë?

9 PË. Po, por duhet të sqaroj se ne jemi konsultu në
10 vazhdimësi. Në atë periudhë nuk ka pas armatim të mjaftueshëm,
11 dhe në maj nëse s'gaboju, kanë pëlqit luftimet në grykën e
12 Llapushnikut. Ka pas mungesë të madhe të armëve, dhe ne kemi
13 bisedu që unë të nisem menjëherë për Gllloboqicë, në mënyrë që
14 të mund të siguroj armatime dhe të vij ta furnizoj grykën e
15 Llapushnikut. Jemi konsultu me Fatmir Limaj dhe unë kam mendu
16 gjithmonë që Fatmir Limaj do të konsultohet me Shtabin e
17 Përgjithshëm sepse kam supozuar në atë kohë se është anëtar i
18 Shtabin e Përgjithshëm.

19 PY. Të kalojmë tani në dëshminë që keni dhënë në çështjen
20 kundër Limajt.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Për Sekretarinë është dokumenti
22 IT-03-66 T3761 deri në T3827, dokument i paredaktuar, ndërkohë
23 do të fillojmë nga faqja 5. Pastaj kalojmë në versionin në
24 shqip që është IT-03-66 data 4 mars 2005-TR-AT, versioni i
25 paredaktuar, duke filluar nga faqja 6.

1 PY. Dëshmitar, ju sapo konfirmuat që çështja e furnizimit me
2 armë ishte diçka që ju mundoheshit t'i gjenit zgjidhje vetë.
3 Në qoftë se nuk e zgjidhnit dot vetë i drejtoheshit Fatmir
4 Limaj, i cili më pas i drejtohej Shtabit të Përgjithshëm.

5 Megjithatë, në çështjen Limaj, ju thoni -- pra, keni
6 dhënë një përgjigje të gjerë e të gjatë sa i takon mungesave
7 të armatimeve në atë kohë.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Të kalojmë pak më poshtë në
9 versionin në anglisht të dokumentit.

10 PY. Pra, kishte të bënte me bashkërendimin me Fatmir Limajn.
11 Ju thoni:

12 "Ishte prill, nuk e mbaj mend datën, përmes ndërmjetësit
13 vëllait tim, unë u mundova që të kontaktoja me Fatmir Limajn,
14 në mënyrë të tillë që të shkoja në Kleçkë për të kontaktuar
15 Shtabin e Përgjithshëm përmes Hashim Thaçit në Drenicë për t'i
16 treguar për çështjet koordinuese dhe mangësisë së armëve. Dhe
17 që e kishim të pamundur që të gjenim, apo të siguronim armë."

18 A e shikoni këtë pjesë, Dëshmitar? Në 2003 dhe tani po
19 ashtu, domethënë, dhe kjo pjesë e dëshmisë, ju thoni që
20 kontaktuat me Fatmirin në mënyrë të tillë, domethënë, keni
21 thënë diçka të ndryshme në 2003 dhe diçka të ndryshme në 2005.
22 Në 2003 keni thënë keni kontakt me Fatmir Limaj pastaj në
23 2005 keni thënë që keni dash të kontaktoni me Hashim Thaçin.

24 PË. Kjo ishte pyetje?

25 PY. Ajo çfarë po mundohem t'ju them është kjo, që hera e

1 vetme kur keni thënë që e keni kontaktuar me Hashim Thaçin sa
2 i takon çështjes së furnizimeve me armë, këtë e keni
3 përmendur, e keni cekuar në dëshminë në 2005, në çështjen
4 Limaj. Kështu, apo jo? Kjo është hera e vetme kur e keni
5 përmend Hashim Thaçin. Është e vërtetë kjo?

6 PË. Në fakt, Hashim Thaçin s'e kam taku unë në atë periudhë,
7 nëse nuk gaboj, ose më kujtohet, ka mundur të kontaktoj përmes
8 telefonit, por drejtpërdrejt në muajin prill-maj, nuk kam mujt
9 me e taku, edhe kam pas probleme edhe me takimin në prill edhe
10 me Fatmir Limajn, sepse kemi pas probleme të përcjelljes apo
11 të komunikimit territorial.

12 PY. Dëshmitar, z. Buja, do t'ju bëj këtë pyetje: A jeni
13 informuar ndonjëherë lidhur me përfundimet e Trupit Gjykses në
14 çështjen Limaj sa i takon dëshmisë së dhënë prej jush?

15 PË. Jo.

16 PY. Në rregull. Do t'ju tregoj juve një dokument dhe pastaj
17 do ju kërkoj që të komentoni.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares të
19 paraqesë në ekran dokumentin DHT00177 deri në DHT00492, në
20 anglisht dhe DHT04481, deri në DHT0483 në shqip.

21 Z. PACE: [Përkthim] Ndërkohë që paraqitet dokumenti, ne
22 kundërshtojmë sepse nuk mendojmë që kjo është mënyra se si
23 duhet të merret në pyetje dëshmitari, dhe nuk ka relevancë. Në
24 qoftë se Avokati dëshiron që të bëjë pyetje që kanë të bëjnë
25 me besueshmërinë, do ishte më mirë që të zgjidhte një pistë

1 tjetër.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet
3 kundërshtimi.

4 Vazhdoni, Misetiç.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Në rregull. Le të kalojmë tek
6 paragrafi 547, që është në faqen DHT00387 në versionin në PDF
7 faqja 211 në anglisht dhe DHT04696 versioni i faqes në PDF
8 është 216 për shqipen.

9 PY. Një çast sa të nxirret dhe dokumenti në shqip.

10 Në mes të paragrafit 547, z. Buja, thuhet që Dhoma:

11 "Nuk mund të nxjerrë përfundimin nëse dëshmia e Shukri
12 Bujës është e gabuar, e rreme, apo e ngatërruar. Ekziston dhe
13 mundësia që dëshmia e Shukri Bujës në lidhje me këtë pikë të
14 jetë ndikuar nga besnikëria e tij e dukshme ndaj UÇK-së në
15 përgjithësi, dhe Fatmir Limaj në veçanti."

16 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtoj, të nderuar Gjykatës. Të
17 paktën duhet t'i bëhet e qartë dëshmitarit se cili është
18 argumenti këtu.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem, mos më ndërprisni.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
21 vazhdoni, Misetiç. Rrëzohet kundërshtimi.

22 Z. MISETIC: [Përkthim]

23 PË. Është e saktë, apo jo, Dëshmitar, që kur keni dhënë
24 dëshmi në gjykimin kundër Limajt, ju keni ndjerë një lloj
25 ndjenje besnikërie ndaj Fatmir Limaj, apo jo?

1 PY. Unë ndjej besnikëri ndaj të gjithë atyre që kanë bërë
2 luftën çlirimtare, sepse kam qenë bashkëluftëtari i tyre dhe
3 është normal që ta ndjej një, ta kem një ndjenjë të tillë, dhe
4 po mundohem të sqaroj të gjithë rrjedhën ashtu siç, siç unë e
5 kujtoj.

6 PË. Në rregull. Do t'i kthehem prapë kësaj teme për një çast.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Megjithatë, tani për momentin do i
8 kërkoja Sekretares të paraqesë një tjetër pjesë të të njëjtit
9 dokument, që është paragrafi 580, ose ndryshe dokumenti
10 DHT00402 -- faqja në PDF është 226 në anglisht, dhe në shqip
11 është faqja në PDF 231. Ju lutem, gjeni paragrafin 580 në të
12 dyja versionet.

13 PY. Dëshmitar, në mes të këtij paragrafi, Trupi Gjykses aty
14 thotë që:

15 "Nga, pasi ka parë videokasetën e deklaratës së mëhershme
16 dhe nga dëshmia e Shukri Bujës, Dhoma bindet se deklarata e
17 mëparshme u dha lirisht. Gjithashtu, Dhoma nuk ndikohet prej
18 logjikës së arsyeve të dhëna nga Shukri Buja për ndryshimet e
19 dukshme në këtë dëshmi. Duke e vëzhguar me kujdes dëshmitarin
20 gjatë dëshmisë së tij, Dhoma mendon se ndryshimet prej
21 intervistës së tij të mëparshme ku ai e përcaktoi periudhën
22 përkatëse për strukturën e UÇK-së, të cilën e kishte shpjeguar
23 më parë, jashtë periudhës kohore që ka lidhje me aktakuzën,
24 mund të shpjegohen fare mirë prej ndjenjës së dukshme të
25 besnikërisë të cilën e demonstroi fizikisht dhe e zbuloi në

1 dëshminë e tij për UÇK-në në përgjithësi, dhe Fatmir Limajn në
2 veçanti.”

3 Pra, Dhoma ose Trupi Gjykses thotë në këtë pjesë që ka
4 vënë re një lidhje të caktuar me Fatmir Limajn gjatë Trupit
5 Gjykses. A mund të na e shpjegoni këtu çfarë është kjo lidhje
6 që ka ekzistuar midis ju dhe Trupit Gjykses [Sipas
7 përkthimit], a mund të keni një shpjegim për këtë?
8 PË. Unë nuk mund ta shpjegoj se si e ka menduar këtë lidhje,
9 por Fatmir Limaj gjithmonë e kam llogaritur bashkëluftëtar të
10 timin, edhe kam hyrë në Kosovë me të, kam bërë luftën bashkë
11 me të, kam vepruar pas luftës bashkë me të. Kemi qenë një
12 organizim të përbashkët politik dhe është normale që kam pas
13 ndjenja të një bashkëluftëtari, të një shoku tim të ngushtë të
14 luftës.

15 PY. Faleminderit.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, kërkoj që kjo
17 faqe të pranohet si provë gjyqësore. Arsyet do t’i shpjegoj pa
18 praninë e dëshmitarit, megjithatë ka ardhë edhe koha e drekës.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

20 Z. PACE: [Përkthim] Në qoftë se na jepni faqen -- na
21 jepni fjalën, së pari jemi kundër kalimit tek faqja tjetër.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të dalë
23 dëshmitari njëherë.

24 Ka ardhur koha për të bërë pushimin e drekës. Kemi një
25 pushim prej një orë e gjysmë, do ktheheni përsëri këtu në orën

1 14.30. Ju lutem mos flisni me askënd lidhur me dëshminë
2 përpara Trupit Gjykues.

3 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Misetic,
5 çfarë keni për të thënë?

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

7 Z. Kryegjykatës, juve ju kërkohet që të pranoni të gjithë
8 deklaratën e 2005-s. Trupi Gjykues ka qenë Trupi Gjykues që e
9 ka parë në seancën gjyqësore këtë dëshmitar, dhe ne mendojmë
10 që ky paragraf është relevant sepse ka një element faktik se
11 përndryshe nuk e kishim kërkuar. Domethënë, është një argument
12 i cili është i rëndësishëm për neve se bëhet fjalë për
13 besnikërinë e këtij dëshmitari ndaj Fatmir Limajt.

14 Dhe përmban gjithashtu edhe konstatimet e Trupit Gjykues
15 që ka qenë pjesë e gjyqimit ndaj Limajt. Domethënë nuk është
16 se ka të bëjë me përfundime juridike, por ka të bëjë thjesht
17 me konstatime faktike të bëra nga Trupi Gjykues në atë proces
18 gjyqësor.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Pace.

20 Z. PACE: [Përkthim] Ne kundërshtojmë, sikurse kemi
21 kundërshtuar dhe më përpara, sa i takon pranimin të vendimeve
22 të aktgjykimeve të paneleve të tjera, ose të trupave të tjera
23 gjyqësore, sepse është detyrë e këtij Trupi Gjykues për të
24 vendosur për besueshmërinë. Ky është një trup tjetër gjyqësor
25 kështu që nuk ka vlerë të pranohet një pjesë e asaj çfarë u

1 lexua për Gjykatësin dhe ndërkohë sa i takon lidhjes që ka
2 dëshmitari me personin në fjalë, u bë pyetja përkatëse dhe ju
3 e morët përgjigjen e cila nuk është se e sqaroi më tepër
4 përmbajtjen e atij paragrafi.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të
6 caktojmë tani një numër provizor prove, pastaj do të marrim më
7 pas një vendim.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, faqja në
9 shqip e këtij dokumenti ka ERN DHT04712 dhe faqja përkuese në
10 anglisht ka numrin DHT00403, dhe do të marrë numrin provizor
11 të provës gjyqësore 1D00204. Aktualisht klasifikimi është
12 publik. Faleminderit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
14 pushim deri në orën 14.30.

15 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.03

16 --- Seanca fillon në orën 14.32

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
18 sillni dëshmitarin.

19 Z. DIXON: [Përkthim] Do lutesha të bëja një kërkesë, ju
20 lutem, lidhur me vendimin që u mor në seancën e mëparshme.

21 Gjatë pushimit pashë emailin që na dërgoi Prokuroria dhe,
22 në fakt, është vetëm një rresht që thotë kjo është lista e
23 materialeve që duam të pranohen.

24 Ne duam t'ju pyesim tani, si rregull, a mund të na japi
25 arsyet Prokuroria pse vlen rregulla për këto materiale, pse

1 është kjo dispozita e vlefshme sepse nuk duam të jemi në një
2 situatë që kur të paraqesim ne kundërshtimet, Prokuroria më në
3 fund, domethënë - më falni - mund të jenë pranuar materialet e
4 Prokurorisë kur ne të bëjmë kundërshtimet tona.

5 Pra, si fillim, të na japin arsyet, ne do t'u përgjigjemi
6 dhe, nëse është nevoja, ata le të kundërpërgjigjen.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ata kërkuan
8 pranimin e dokumenteve, ju e kundërshtoni. Ata do të
9 përgjigjen, çfarë, këtë thashë dhe unë.

10 Z. DIXON: [Përkthim] Po sipas rregullës 154 --

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, nuk është
12 154. Po flasim për tjetër rregull.

13 Z. DIXON: [Përkthim] Në këtë rast, kur po flasim për një
14 rregull 143 që e ka shumë të ngushtë kuadrin duhet të ketë një
15 arsyetim shumë të mirë që ne t'i përgjigjemi.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
17 Do ta shqyrtojmë.

18 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sillni
20 dëshmitarin, ju lutem.

21 [Dëshmitari vijon dëshminë]

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Buja, do
23 të vazhdojmë tani me pyetjet nga ana e Mbrojtjes së Thaçit.

24 Z. Misetic, fjala është për ju.

25 Z. MISETIC: [Përkthim]

1 PY. Mirëdita, z. Buja.

2 PË. Mirëdita.

3 PY. Dua të diskutojmë për disa aspekte. Së pari, Prokurori ju
4 bëri pyetje për një libër të Hajrush Kurtajt. Në këtë libër
5 kishte një poshtëshënim ku thuhej se një pjesë e librit ishte
6 e bazuar në një intervistë që i kishit dhënë ju autorit në
7 2007. Mendoni se në 2007 keni folur vërtetë me autorin e
8 librit?

9 PË. Kam pas kontakt, po si intervistë nuk po më kujtohet. Po,
10 sigurisht, që kam dhënë informacion.

11 PY. Po këtu thotë 2007. Pra, në libër supozohet, të paktën
12 sipas poshtëshënimit, që ju këtë intervistë autorit ia keni
13 dhënë disa vite pas gjykimit të Limajt, a është kështu?

14 PË. Sigurisht që është pas gjykimit të Limajt, po nuk e di
15 kohën.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Do të tregoj një dokument që ua
17 tregoi dhe Prokuroria dje, është prova me numrin P01813.

18 PY. A e mban mend që të njëjtin dokument ta tregoi Prokuroria
19 dje?

20 PË. Po, më duket që po.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Kalojmë në faqen tjetër.

22 PY. A e mban mend që thatë se këto korrigjimet me shkrim dore
23 i keni bërë ju?

24 PË. Edhe dje e thashë, kjo nuk ka mujt të qëndroj sepse 6
25 qershori nuk është data të cilën jam emëruar komandant i

1 nënzonës.

2 PY. Po, po. Po e thatë këtë dje. Po thatë po ashtu që
3 mendonit se këto shënime me shkrim dore tek ky teksti i
4 kishit bërë ju, i kishe bërë ti. Të kujtohet?

5 PË. Po. Po. Kështu po më duket. Edhe dje e thashë, po më
6 duket se është shkrim i imi.

7 PY. Data nuk është e qartë në dokument. A mund të na thoni
8 nëse shënime në këtë tekst janë bërë pas gjykimit të Limajt,
9 pra, pas gjykimit të Limajt i keni bërë këto shënime, ju
10 kujtohet?

11 PË. Nuk më kujtohet saktë.

12 PY. Faleminderit.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund ta hiqni dokumentin nga
14 ekrani.

15 PY. Do të tregoj një dokument tjetër që po ashtu jua tregoi
16 Prokurori dje.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Është dokumenti që mban numrin
18 P01508.

19 PY. Ju kujtohet që e patë dje këtë dokument?

20 PË. Po.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem të zmadhojmë tek shqipja
22 pjesën poshtë fotografisë së z. Buja që të shohim kush ka qenë
23 autori i kësaj interviste.

24 PY. Dëshmitar, a njihni ndonjë prej këtyre dy emrave që
25 shohim këtu?

1 PË. Edhe një herë të lutem?

2 PY. I shihni emrat që pretendohet se janë intervistuesit,
3 autorët e këtij artikulli, i shihni këto dy emrat që mendohet
4 se janë autorët e artikullit?

5 PË. Po e shoh emrin Çlirim Osmani dhe Shpresim Ahmeti.

6 PY. Po. I njihni këta persona?

7 PË. Jo, asnjërin.

8 PY. A ekzistojnë këta persona në Kosovë apo dhe jashtë
9 Kosovës?

10 PË. Realisht nuk i njoh.

11 PY. E kuptoj që nuk i njihni. Po a ka mundësi të ekzistojnë
12 persona me këta emra, sipas jush, ekzistojnë këta njerëz?

13 PË. Nuk e di. Nuk besoj.

14 PY. Thoni që nuk besoni. Pse nuk besoni?

15 PË. Po së pari nga vetë ky shkrim i gazetës, gjoja se po
16 paraqitem me pseudonim për të mshefur identitetin tim, ndërsa
17 nxirrem me fotografi. Kjo është alogjike. Sepse për të mshefur
18 identitetin tim në një intervistë nuk kam pas nevojë me
19 nxjerrë fotografi, sepse me fotografi nxirret më së miri
20 identiteti. Dhe kjo e tregon një alogjikë të vetë shkrimit.

21 Dhe këta persona, që janë autorë, unë nuk po i njoh dhe
22 nuk kam arritur dot asnjëherë t'i njoh me këto emra apo me
23 ndonjë pseudonim që e kanë.

24 PY. Faleminderit. Do ju bëj një pyetje tjetër. Ju keni thënë
25 se keni punuar si redaktor tek Zëri i Kosovës në 1997. A e kam

1 kuptuar unë drejtë që këtu dy emrat që shohim këtu nuk është
2 se i përkojnë ndonjë personi që t'i kenë pasur si pseudonime
3 apo emra të dytë?

4 PË. Kanë shkru shumë me pseudonime, po neve na kanë ardh
5 shkrimet në redaksi. Dhe redaksia vetëm i ka redaktuar dhe i
6 ka botuar. Dhe kam punuar në Zëri i Kosovës.

7 PY. Po këto dy emrat që po shohim këtu a ka të ngjarë që të
8 jenë përdorur si pseudonime nga vetë Zëri i Kosovës, nga
9 gazeta?

10 PË. Ka mundësi.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga
12 ekrani.

13 PY. Dëshmitar, dua t'ju bëjë disa pyetje për temën vijuese.
14 Kur shkove në Mollopolc, fillove të bisedoje me banorët e
15 zonës atje për të krijuar një njësit gueril, kështu?

16 PË. Kam biseduar me njerëz të veçantë, sepse me banorë aty ka
17 qenë rrezikshmëria shumë e lartë. Po kam biseduar me njerëzit
18 që kam besuar se mund t'i organizoj në njësitin gueril.

19 PY. Po. Dhe një prej këtyre personave a ka qenë Huset Saiti?

20 PË. Po.

21 PY. Huset Saiti punonte për Ministrinë e Mbrojtjes?

22 PË. Huset Saiti ka qenë i arrestum dhe ka qenë pjesë e
23 organizimit e Ministrisë së Mbrojtjes në qeverinë Bukoshi si
24 quhej në atë kohë.

25 PY. Pra, për të krijuar këtë njësi të UÇK-së, a e kam kuptuar

1 unë drejt që ju keni punuar mes Huset Saitin i cili punonte me
2 Ministrinë e Bukoshit?

3 PË. Po.

4 PY. Dje edhe sot ju thatë se Hysen Shahini u emëruar shef
5 shtabi në zonën e Nerodimës në nëntor a dhjetor të 1998. Dhe
6 ju thatë se më përpara, z. Shahini ka qenë pjesë e forcave të
7 organizuara nga qeveria Bukoshi, që i takon të jetë FARK-u,
8 kështu?

9 PË. Po, e vërtetë.

10 PY. Keni dijeni për një marrëveshje që është nënshkruar në
11 fillim të nëntorit mes UÇK-së dhe FARK-ut për të bashkuar
12 forcat, për shkrirjen e forcave?

13 PË. Kam dëgjuar, po nuk kam qenë pjesë e kësaj marrëveshjeje.
14 Veç kam dëgjuar.

15 PY. Në atë kohë e keni ditur ju që z. Shahini do të ishte
16 shefit i shtabit tuaj si rezultat i kësaj marrëveshjeje?

17 PË. Jo. Hysen Shahini ka ardh në zonën time si ushtar i
18 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i uniformum, me armatim. Dhe
19 pas një periudhe të shkurtë, kur kemi marrë informacion, kam
20 marr unë informacion se është një epror i përgatitur dhe i
21 shkolluar në ish-ushterinë jugosllave, atëherë kam vepruar në
22 drejtim të emërimit për shef shtabi.

23 PY. Do të bëj disa pyetje lidhur me pyetjet që ju ka bërë
24 Mbrojtja në çështjen Limaj. Kjo ka të bëjë me fazat e ndryshme
25 të zhvillimit të UÇK-së. A mund të themi se në mars të 1998

1 UÇK-ja mund të përshkruhet me pak fjalë si një njësit apo një
2 organizatë guerile që ishte ende e paformuar?

3 PË. Në mars të 1998, me të arritur në Drenicë, ne e kemi parë
4 vetë Drenicën se ka pas shumë pak ushtarë dhe veprimi ynë që
5 të shkojmë në territorin ku unë i kam njohur njerëzit dhe ku
6 kam lindur ka qenë që të formojë njësitin gueril me të cilin
7 do ta shpërndanim luftën në të gjithë Kosovën. Sepse në atë
8 kohë kam pas edhe unë idenë që lufta vetëm në Drenicë mund të
9 na rrezikojë. Për ta shpërndarë luftën, do të thotë, kemi
10 marrë këto veprime si njësite guerile të vogla.

11 PY. Atëherë a mund ta përshkruajmë këtë si një strategji për
12 të zhvilluar një shtrirje horizontale të njësiteve guerile në
13 gjithë Kosovën?

14 PË. Po, mund të quhet si strategji e tillë, sepse ne kemi
15 mendu që luftojmë përmes njësiteve guerile të vogla, do të
16 thotë, në të gjithë territorin e Kosovës.

17 PY. Në prill dhe maj filluat të organizonit grupe ose pika të
18 vogla vullnetare, kështu?

19 PË. Në prill dhe në maj ka ndryshuar krejt dimensionin i
20 luftës dhe ne dhe unë së paku dhe pjesa më e madhe e njerëzve
21 që kam njohur, nuk kanë qenë të përgatitur për një situatë të
22 tillë sepse filloi të kemi vërshim të njerëzve për t'u kyçur
23 në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. E në veçanti, pas mbylljes
24 së Grykës së Llapushnikut, filluan të dalin edhe njësite të
25 tjera të cilat ishin nga civilët të cilët kishin ardhë dhe

1 kishin marrë uniforma dhe u organizonin si njësite guerile.

2 Filloj një zgjerim i njësiteve guerile të cilat ne s'e
3 kishim parashikuar, e në veçanti unë, sepse unë kam besuar se
4 me njësite guerile, do të na shkojë një periudhë së paku
5 gjashtë mujore. Kjo situatë që u ndodhëm ishte e
6 paparashikume. Dhe ne, unë dhe të tjerët, të cilët i njihja
7 nuk dinim sesi që vepronim.

8 PY. Në rregull. Dhe kjo vijoi të vazhdonte. Dhe mund të themi
9 që në maj, qershor, këto grupet të vogla vullnetare tek sa
10 shtriheshin nëpër Kosovë filluan të bashkëpunonin me njëri-
11 tjetrin, kështu?

12 PË. Po. Ne jemi mundu me bashkëpunu me njëri-tjetrin sepse ka
13 qenë rrezikshmëria që të jemi me veprime të shkëputura edhe
14 pse nuk ia kemi arrit gjithmonë me bashkëvepru me njësitet
15 njëri me tjetrin.

16 PY. A është e vërtetë që ky bashkëpunim ka qenë një
17 bashkëpunim vullnetar mes njësive, pra, e thënë ndryshe,
18 njësitet edhe mund të mosbashkëpunonin në qoftë se nuk
19 dëshironin?

20 PË. Po në realitet në atë kohë në qoftë se kanë dëgju krisma
21 në Grykë të Caralevës e njësitit ka qenë në Grykë të
22 Llapushnikut, kur nuk ka pas luftime, ne i parë që na kanë
23 ardhë në ndihmë nga Llapushniku njësitit në Grykë të Caralevës
24 apo e kundërta.

25 Do të thotë, veprimi ka qenë në rast se janë ndëgju

1 krismat në një pjesë ku ka qenë bukur larg kanë shku njësitet
2 vullnetare guerile, do të thotë, në ndihmë të njësiveve tjera.
3 PY. Më pas filluat ofensivat serbe. A është e vërtetë që për
4 shkak të këtyre ofensivave ndryshuan planet e strategjitë dhe
5 u bënë përpjekje për të formuar një ushtri më konvencionale?
6 PË. Realisht deri në, sidomos muaji maj, qershor, ka qenë
7 bukur i vështirë sepse as nuk e kisha idenë unë as të tjerët
8 më të cilët bashkëpunoja sesi do të dukej në këtë gjendje
9 Ushtria Çlirimtare e Kosovës apo njësitet e saj. Ne nuk kishim
10 as përgatitjen profesionale të duhur, nuk kishim as materialet
11 e duhura për t'i furnizuar ata që vinin për t'u lajmëruar për
12 ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Dhe prisnim mos do
13 të kemi ndonjë udhëzim e, në fakt, ne nuk kishim asnjë udhëzim
14 sepse nuk e njifnim as nuk dinim se kush dhe kush janë Shtabi
15 i Përgjithshëm.

16 Kjo gjendje, do të thotë, ka shkuar deri në kohën diku ka
17 mesi i qershorit kur ka dalë zëdhënësi i Ushtrisë Çlirimtare
18 të Kosovës emri publik i z. Jakup Krasniqi.

19 PY. Në rregull. Po flas për ndryshimin e strategjisë për
20 ndryshimin nga njësive guerile në një shtrirje më horizontale
21 të një ushtrie më konvencionale, më tradicionale, kjo ka
22 ndodhur para apo pas sulmit serb në korrik?

23 PË. Po ne, në fakt, na u imponu forma e organizimit. Ne kemi
24 mendu që përmes njësive guerile të zhvillojmë luftë guerile
25 duke sulmuar dhe duke u tërhequr. Po në maj, qershor, me

1 daljen e shumë njësiteve guerile dhe me fillimin e ofensivës,
2 ne filluam të krijojmë vijë frontale. Dhe na u imponu edhe
3 forma e organizimit e cila ishte, siç po e quani edhe ju, ma
4 konvencionale.

5 PY. Kur ka ndodhur nga pikëpamja kohore, kur ka filluar
6 ndryshimi i strukturës. Kur filluan të formoheshin brigadat,
7 batalionet, kur?

8 PË. Kjo mvaret nga zona në zonë apo nga nënzona në nënzonë.
9 Dhe kemi filluar dhe me kopju njëri-tjetrin ma shumë. Në
10 pjesën time, do të thotë, fillimi i organizimit të njësiteve,
11 pa e quajt brigadë, po të skuadrave dhe të togjeve ka ndodhur
12 në Jezercë diku në fund të gushtit, në shtator, kur ka arritur
13 eprori Daut Ilazi, nëse s'gaboj dhe ka filluar këtë organizim
14 sipas ish-strukturës së ushtrisë jugosllave. E ndërsa në zonën
15 operative ku unë isha komandant i zonës ka filluar strukturimi
16 diku në fund të tetorit.

17 PY. Ju apo zona, nënzona juaj filluat strukturimin në fund të
18 tetorit sepse në mes të tetorit ishte arritur një armëpushim,
19 kështu që kjo ju dha ju mundësinë të organizoheshit, kohë që
20 të organizoheshit, kështu?

21 PË. Po. Pas luftimeve të ashpra që kanë ndodhur në Jezercë
22 dhe thyerjes së formacioneve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës
23 atje, një pjesë e eprorëve që kanë qenë të zonës -- të
24 Nënzonës Operative të Nerodimës kanë kaluar në Shqipëri, një
25 pjesë kanë qenë edhe të plagosur. Dhe kam shfrytëzuar dhe

1 shkuarjen time në Shqipëri në kontakt me shefin e shtabit
2 atëherë dhe një epror tjetër, Kadri Kastratin, për të
3 shqyrtuar sesi të organizohemi më mirë, si ta bëj strukturën e
4 zonës.

5 Dhe realisht me kthimin tim në tetor kemi filluar
6 organizimin e strukturave të zonës dhe të brigadave dhe kemi
7 shfrytëzuar armëpushimin që ka qenë në bazë të Marrëveshjes
8 Milosevic-Holbrooke.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Do nxjerrë në ekran një dokument
10 që mban numrin SITF00223935 deri në 00223961, në faqen 3 në
11 anglisht, po edhe shqipja është në faqen 3.

12 PY. Dëshmitar, kjo është deklarata që keni dhënë për TPNJ-në
13 në 2011 në çështjen e Milosevic. Më intereson ky paragrafi që
14 thotë: "Nuk kishim komunikime me radio ..."

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Është paragrafi i fundit.

16 DËSHMITARI: Më falni.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] "Në atë fazë nuk kishim komunikim
18 me radio". Ky paragraf.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po,
20 Dëshmitar. Po.

21 Po, z. Misetic, dëgjojeni dëshmitarin, ju lutem.

22 Po, po, Dëshmitar.

23 DËSHMITARI: Ose m'u përkthi gabim ose ju e thatë në 2011,
24 që në 2011 nuk kam dhënë deklaratë në rastin Milosevic.

25 Z. MISETIC: [Përkthim]

1 PY. Ju kërkojmë ndjesë, thashë 2001.

2 PË. Në 2001, po.

3 PY. Po. Shihni paragrafin në ekran, po flasim për këtë pjesë
4 të luftës ku kishit hyrë:

5 "Në atë fazë nuk kishim komunikim me radio kështu që
6 ndonjëherë dhe komandimi direkt ishte i vështirë. Kur ndodhte
7 që ndahej një njësi komunikimi me ta ishte i pamundur dhe në
8 fakt ajo pastaj vepronte në mënyrë të pavarur."

9 A është e vërtetë që s'keni pasur komunikime me radio në
10 prill, maj të 1998?

11 PË. Jo, jo, nuk kemi pas radiolidhje. Nuk kemi pas mjete të
12 komunikimit.

13 PY. Kur keni filluar të merrnit mjete të komunikimit? Kur
14 themi mjete të komunikimit e kemi fjalën për radio në fakt.

15 PË. Kjo ka ndodh në periudhën pas tetorit.

16 PY. Pra, nga prilli deri në tetor, si komunikoni ju me
17 njësitë?

18 PË. Po kryesisht kemi komunikuar me kontakte të
19 drejtpërdrejta. E thashë, kur kemi pas luftime kanë ardh te
20 njeri-tjetri. Ndërsa në rast se kemi pas shkëputje
21 territoriale atëherë kemi komunikuar përmes korrierëve që i kemi
22 quajtur në atë kohë të ushtrisë.

23 PY. Si komunikoni me atë subjekt që ju mendoni se ishte
24 Shtabi i Përgjithshëm?

25 PË. Në fakt unë korrierin e kam pas një periudhë në fillim

1 kur veç sa kemi filluar organizimin që të kontaktoj me
2 njësitin e Kleçkës dhe me njësitin në Kaçanik me Agim
3 Bajramin.

4 PY. Domethënë, për të komunikuar me Shtabin e Përgjithshëm
5 dërgonit korrierin në Kleçkë, e kuptova drejt?

6 PË. Jo, komunikimin mes njësiveve, unë kam komunikuar edhe me
7 Agim Bajramin që i cili ka qenë në Kaçanik me njësitin gueril
8 që ende s'kishte -- s'ishte përgatitur për të bërë veprime
9 luftarake. Dhe kam komunikuar të njëjtën kohë dhe me njësitin
10 në Kleçkë në fillim të organizimeve tona. Në Kleçkë ka filluar
11 më herët sesa që ka filluar në Mollopolc. Po në Kaçanik ka
12 filluar edhe më herët sesa në Kleçkë.

13 PY. Pra, me përjashtim të korrierit, a kishit ndonjë mjet
14 tjetër komunikimi me Shtabin e Përgjithshëm përveç korrierit
15 dhe takimeve që kishit pastaj përballë?

16 PË. Në fakt edhe po të kishim ndonjë mjet e s'kishim, ne nuk
17 e kemi dit as ku është selia e Shtabit të Përgjithshëm, as
18 kush janë Shtabi i Përgjithshëm në atë periudhë.

19 PY. Nga prilli i 1998 deri në qershor apo korrik të 1998, kur
20 ka ndodhur ofensiva e parë, nuk kishte ndonjë territor apo
21 ndonjë strukturë të përcaktuar qartësisht, apo jo, Dëshmitar,
22 e kam kuptuar siç duhet këtë?

23 PË. Edhe një herë se po më kërcet ndëgjuesja?

24 PY. Po thoja këtë, nga prilli deri në qershor apo në korrik
25 1998, kur u zhvilluar ofensiva e parë në atë zonë, domethënë,

1 në zonën që kishit ju nën përgjegjësi, nuk është se ka pasur
2 ndonjë territor qartësisht të përcaktuar, domethënë, nuk ka
3 pasur ndonjë territor nënzone të përcaktuar qartë apo ndonjë
4 strukturë të UÇK-së të formuar. A pajtoheni ju me këtë,
5 Dëshmitar?

6 PË. Po. Sepse realisht nuk ka pas ende nënzona deri në
7 korrik.

8 PY. Që prej qershorit, domethënë, deri në qershor të 1998 ju
9 nuk e dinit që Hashim Thaçi ishte anëtar i Shtabit të
10 Përgjithshëm, apo jo, Dëshmitar?

11 PË. Unë nuk e kam ditur se është anëtar i Shtabit të
12 Përgjithshëm.

13 PY. A është e saktë, Dëshmitar, që ofensiva serbe në korrik
14 ka shkaktuar vështirësi të rënda në përpjekje për të krijuar
15 një organizatë më të qenësishme, më kohezive?

16 PË. Po. Është më se e dukshme që na shkaktuar probleme tepër
17 të mëdha.

18 PY. Keni thënë në dëshminë tuaj që jeni caktuar si komandant
19 i nënzonës me 6 korrik 1998. A është e saktë se pavarësisht që
20 u caktuat si komandant ju keni pasur detyra apo përgjegjësi të
21 përcaktuara qartë, pavarësisht se u emëruat komandant, është e
22 saktë kjo, Dëshmitar?

23 PË. Po.

24 PY. Keni dëshmuar, për procesverbal këtë e keni thënë në IT,
25 në faqen 62, rreshtat 3 deri në 11 në anglisht. Ju thoni si më

1 poshtë që:

2 "Disa do thonë që unë kam qenë koordinator për këtë gjë.
3 Më vonë mua më është thënë që jam caktuar si komandant i
4 nënzonës. Nënzona ishte në zonën e Nerodimës ... ishte gjendje
5 kaosi sepse kishte mungesë mjetesh të komunikimit dhe askush
6 nuk e dinte se ku gjendesha unë."

7 A përshkruan kjo pjesa që sapo ju lexova situatën pas
8 emërimit tuaj si komandant të nënzonës, Dëshmitar?

9 PË. Po, është e vërtetë.

10 PY. Pas emërimit si komandant i nënzonës, juve nuk ju caktua
11 një territor i caktuar ose një listë e detyrave të sakta,
12 precize, të gjerave që ju mendohej që të ushtronit si
13 komandant i nënzonës, a është e saktë kjo?

14 PË. Po, e saktë është.

15 PY. Ju si shembuj dhe këtë e keni dhënë në vitin 2003 në
16 dokumentin e identifikuar si IT-03-66 P160-TR-ET, në faqen 69,
17 rreshtat 6 deri në 22:

18 "Dihej që Shtimja dhe Ferizaj do ishin nënzonën po nuk
19 ishte e qartë në qoftë se Lipjani do ishte nën këtë zonë apo
20 jo."

21 A është e saktë kjo, Dëshmitar?

22 PË. Po, e saktë është.

23 PY. Përgjatë gjatë gjithë kësaj kohe, domethënë, duke filluar
24 nga prilli e duke vazhduar më tej, a është e saktë të thuhet
25 që ju nuk kemi marrë asnjëherë një urdhër nga Hashim Thaçi?

1 PË. Jo, s'kam marr urdhra.

2 PY. A është e saktë që ju nuk e dinit që ai ishte i përfshirë
3 në pjesën ushtarake operacionale të UÇK-së?

4 PË. Jo, s'e kam ditë në atë kohë.

5 PY. Përmendët një udhëtim ose një vizitë në zonën tuaj,
6 domethënë, një vizitë nga disa anëtarë të Shtabit të
7 Përgjithshëm në zonën tuaj.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Për procesverbal, bëhet fjalë për
9 dokumentin IT-03-66 T4002 deri në T4087 Versioni I Paredaktuar
10 në gjykatë, në faqet 40 dhe më tej rreshti 1, deri në faqen
11 pasuese, rreshti 1.

12 PY. Ju thoni si më poshtë:

13 "U bë një vizitë nga Azem Syla, Sokol Bashota, Hashim
14 Thaçi".

15 A është e saktë kjo, Dëshmitar?

16 PË. Në cilën periudhë? Më fal.

17 PY. Diku nga korriku i 1998.

18 PË. Nuk e kujtoj saktë, po mund të jetë në korrik të 1998.

19 PY. Por kur u pyetët se kush ju ka përcjellë urdhra apo
20 udhëzime, në përgjigje ju thatë që:

21 "Në atë kohë unë e dija që anëtarët e Shtabit të
22 Përgjithshëm po merreshin me organizimin e kësaj forme lufte.
23 E njihja Azem Sylën, i cili më vonë u bë komandant i
24 përgjithshëm. E njihja gjithashtu edhe Sokol Bashotën i cili
25 po ashtu ishte pjesëtar i Shtabit të Përgjithshëm dhe që ishte

1 i përfshirë me organizimin. Dhe normalisht që kam marrë
2 udhëzime prej tyre.”

3 A është e saktë kjo, Dëshmitar?

4 PË. Po. Azem Sylën të gjithë kanë fol se është komandant i
5 përgjithshëm dhe unë e kam respektuar ashtu siç është folur,
6 do të thotë, e kam respektuar si komandant i përgjithshëm në
7 atë kohë. Dhe udhëzimet e tij dhe në qoftë se nuk kanë qenë
8 udhëzime si komandant i përgjithshëm i kam marrë si udhëzimet
9 e komandantit të përgjithshëm.

10 PY. Ju nuk përmendët Hashim Thaçin në gjykimin e Limajt si
11 dikush nga i cili ju keni marrë urdhra apo udhëzime, a është e
12 saktë kjo, Dëshmitar?

13 PË. Po, e saktë është.

14 PY. Keni shkuar në Shqipëri në gusht të vitit 1998 dhe nuk
15 jeni kthyer në Kosovë deri në tetor të 1998, a është e saktë
16 kjo?

17 PË. Po, e saktë është.

18 PY. Pra, ju nuk keni pasur njohuri lidhur me atë se çfarë ka
19 ndodhur në zonën e Nerodimës në periudhën nga gushti deri në
20 tetor të 1998, a është e saktë kjo?

21 PË. Po, e saktë është.

22 PY. Kur u kthyet, sikurse e diskutuat, UÇK-ja ishte
23 organizuar më mirë dhe fillojë që të krijojë një lloj
24 strukture e saj, a është e saktë kjo?

25 PË. Po, e saktë është.

1 PY. Gjatë nëntorit, dhjetorit dhe janarit struktura vijoi që
2 të përmirësohet, apo jo?

3 PË. Po, ka fillu me u përmirësu bukur shumë.

4 PY. Në rregull.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani do t'ju tregoj një artikull
6 gazete. Për procesverbal është dokumenti DHT04804 deri në
7 DHT80406 në anglisht dhe në shqip.

8 PY. Dëshmitar, ky është një artikull i cili është botuar në
9 përditshmen *The Independent* dhe është një artikull i cili
10 është shkruar më datë 6 shkurt 1999, një natë përpara
11 Konferencës së Rambujesë. E kupton këtë, dëshmitar?

12 PË. Po.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares të kalojmë
14 tek faqja 3 e të dyja dokumenteve, domethënë, në shqip dhe në
15 anglisht.

16 PY. Në fillim të faqes 3, në artikull thuhet:

17 "Ekipi shqiptar përfshin Ibrahim Rugovën, liderin politik
18 të shqiptarëve etnikë si dhe Azem Sylën i cili thuhet të jetë
19 komandanti kryesor i UÇK-së dhe Jakup Krasniqin, një zëdhënës
20 dhe ish mbështetës i rrugës jo të dhunshme për pavarësitë z.
21 Rugova, i cili ka kaluar mbështetjen e tij tek krahu ushtarak
22 i lëvizjes."

23 A e pranoni ju që njërihej botërisht në nivel ndërkombëtar
24 që jo më vonë se 6 shkurt 1999 që Azem Syla ishte komandant
25 kryesor i UÇK-së?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Shukri Buja (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 122

1 PË. Po kështu e njihnim Azem Sylën si komandant të
2 përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

3 PY. Pra, ju e dinit më 6 shkurt se Azem Sylja ishte komandanti
4 i përgjithshëm, komandanti kryesor i UÇK-së, a është e saktë
5 kjo?

6 PË. E saktë është se kështu thuhej që komandanti i
7 përgjithshëm është Azem Sylja?

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, kërkoj që ky
9 dokument të pranohet në provë gjyqësore.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtime?

11 Z. PACE: [Përkthim] Jo, nuk kundërshtojmë.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk jam i
13 sigurtë në qoftë se e kam mbajtur siç duhet numrin e
14 dokumentit, z. Misetic, megjithatë shënimin e kam mbajtur si
15 më poshtë. DHT04804 deri në DHT04806.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Është numri i saktë.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të pranohet
18 si provë.

19 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti i cituar së
20 bashku me përkthimin në shqip do të pranohet në provë dhe do
21 të marrë numrin 1D00205. Klasifikohet si publik për momentin.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

23 PY. Azem Sylja nuk vijoi që të ishte komandanti i përgjithshëm
24 i UÇK-së deri në fund të luftës, apo jo, Dëshmitar?

25 PË. Jo, s'ka qenë deri në fund të luftës.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Të paraqesim në ekran një tjetër
2 dokument që është prova 1D00033-ET, konkretisht të paraqitet
3 faqja SPOE00226354.

4 PY. Dëshmitar, këto janë shënimet e një takimi të
5 komandantëve të zonës më 13 shkurt 1999. Së pari do ju tregoj
6 dokumentin dhe do ju pyes në qoftë se keni qenë i pranishëm
7 apo jo.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Për këtë do i kërkoja Sekretares
9 që të kalojmë tek dokumenti tek faqja SPOE00226358.

10 PY. Në fillim të faqes, janë disa fjalë që thuhet që i
11 takojnë dikujt me ermin Shukri dhe pastaj jepen ca fjalë që
12 mendohet që t'i takojnë dikujt me emrin Remi. A supozoj drejt
13 unë që ju keni qenë i pranishëm në këtë takim së bashku me
14 komandantët e zonave?

15 PË. Po, kam qenë i pranishëm.

16 PY. Në rregull.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Më qoftë se do të shkojmë përsëri
18 tek faqja që pamë më përpara SPOE00226354. Këtu duken sikur
19 janë shkruar fjalë që i atribuohen ose pretendohet që t'i
20 perkasin një përfaqësuesi të qeverisë shqiptare, pra:

21 "... ka interpretime ka dhe fjalë të cilat janë shumë
22 shqetësuese për ne."

23 Pra, çfarë mendoni ju, domethënë, cilat janë këto fjalë
24 shqetësuese që mund të ketë pasur qeveria shqiptare se mund të
25 kishte një grusht shteti në atë kohë, si i interpretoni ju

1 këto në qoftë se lexoni pjesën përkatëse, Dëshmitar?

2 PË. Po në atë kohë, do të thotë, ishte shqetësimi se mund ta
3 dëmtonin, dëmtonim delegacionin i cili ishte në Rambuje dhe
4 përfaqësonte Kosovën. Dhe një pjesë e atij delegacioni dhe
5 udhëheqja e saj ishte nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe çdo
6 veprim i yni, do të thotë, do të mund ta dëmtonte delegacionin
7 në Rambuje.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Të shohim faqen SPOE00226356 në
9 shqip dhe në anglisht

10 PY. Rendi i ditës për takimin është identifikuar në tre pika
11 kryesore, domethënë, tre janë çështjet kryesore. Pika e parë
12 ka të bëjë me:

13 "Qëndrimet rreth kërkesave të komandantëve të zonave për
14 emërimin e komandantit të ri të UÇK-së."

15 A ju kujtohet edhe juve e njëjta gjë që pjesë e rendit të
16 ditës së këtij takimi ishte që të caktohej një komandant i ri
17 i përgjithshëm i UÇK-së, Dëshmitar?

18 PË. Po, më kujtohet.

19 PY. Të kalojmë tek procesverbali i takimit dhe do të përpiqem
20 që t'ju rifreskoj kujtesën lidhur me atë çfarë ka ndodhur në
21 atë takim.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Për këtë do i kërkoja Sekretares
23 që të kalojmë në faqen 29 të dokumentit në PDF. Faqja tjetër.

24 PY. Atëherë fillon me Ramushi, besoj që bëhet fjalë për
25 Ramush Haradinajn, apo jo?

1 PË. Po.

2 PY. Këtu thuhet, kjo duket sikur është një përgjigje e asaj
3 çfarë thotë personi nga Shqipëria që:

4 "Jemi ushtri dhe nuk na interesojnë shqetësimet e
5 qeverive të huaja dhe sigurisë, qofshin ato edhe nga shteti
6 amë.

7 "Këto janë manipulime dhe lojëra.

8 "Le ta dijë edhe UDB-ja që ne jemi edhe më të fortë.

9 "Delegacioni ynë në Rambuje duhet ta dijë që ka besimin
10 tonë.

11 "UDB-ja ka qenë e kënaqur me mënyrën sesi janë zhvilluar,
12 si janë shpalosur zhvillimet deri tani.

13 "... për mua komandant është Sylejman Selimi."

14 A ju kujtohet që Ramush Haradinaj ta ketë thënë këtë në
15 këtë takim?

16 PË. Kështu diçka ka qenë diskutimi i tij, po vërtetësinë e
17 plotë edhe s'mund ta them, po në kuptimin e diskutimit të tij
18 ka qenë në përkrahje të Sylejman Selimit për të qenë komandant
19 i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Të kalojmë tek faqja tjetër.

21 PY. Pastaj vijon përgjigja që jepni ju:

22 "Nuk e di se çfarë forme kanë këto kërkesa dhe së pari
23 dua që të informohem përpara sesa të vazhdojë dhe që të marrë
24 vendim se ç'a duhet të bëhet më tej."

25 A është e vërtetë që Ramush Haradinaj ishte pro Sylejman

1 Selimit që të ishte komandant për të zëvendësuar, të bëhej
2 komandant për zëvendësimin e Azem Sylës, ndërkohë që pozicioni
3 juaj ishte pak më i kujdesshëm, domethënë, donit të ishit më
4 shumë i informuar përpara sesa të merrej ky vendim, a ishte
5 kështu, Dëshmitar?

6 PË. Po, kështu ishte. Sepse unë nuk kisha marrë pjesë në
7 mbledhjet e mëparshme me komandantë të zonave. Ishte koha kur
8 ishte -- ka qenë masakra e Reçakut. Dhe jam marrë me problemet
9 që kanë qenë të masakrës së civilëve në Reçak. Dhe kjo ishte
10 një informacion që ishte i aty për atyshëm dhe unë kërkoja
11 sqarime se pse po veprohet në këtë formë dhe pse janë këto
12 nguti për të emëruar dikën komandant të përgjithshëm. Dhe
13 normalisht i kam shtrur, do të thotë, dhe më vonë edhe çështje
14 tjera.

15 PY. Po. Remi pastaj u përgjigjet asaj çfarë thoni ju dhe
16 thotë që:

17 "Është mirë që të mos dezinformohemi për kërkesat tona.

18 "SHP-ja nuk konteston, nuk konteston i tëri.

19 "Unë nuk besoj që ka ndonjë anëtar i Shtabit të

20 Përgjithshëm të UÇK-së që ka përdorur presion.

21 "Dhe për mua ... ai është komandanti i zgjedhur."

22 Sa i takon Azem Sylës, a jeni ju në dijeni që disa prej
23 komandantëve të zonave po shprehnin pakënaqësi edhe lidhur me
24 zëvendëskomandantë të tillë si, për shembull, Sokol Bashotën
25 ose Jakup Krasniqin?

1 PË. Në fakt, aty është shtrur çështja e ndërrimit të
2 komandantit të përgjithshëm. Është kërku informacioni se a
3 është komandanti i përgjithshëm Azem Syla sepse komandantët e
4 zonave nuk ishin në dijeni, sipas pjesëmarrësve aty dhe kanë
5 kërku që të emërohet z. Sylejman Selimi komandant i
6 përgjithshëm. Do të thotë, kjo ka qenë gjithë ajo që është
7 diskutu aty.

8 PY. Sikurse jua tregova, dihej, ishte njohuri e ditur në
9 nivel ndërkombëtar që Azem Syla ishte komandant i
10 përgjithshëm, pra, komandant kryesor i UÇK-së një javë përpara
11 këtij takimi? Ju na konfirmuat që ju e dinit ashtu edhe
12 komandantët e tjerë të zonës e dinin që Azem Syla ishte
13 komandanti i përgjithshëm.

14 Do ta bëj dhe një herë pyetjen. A jeni i njohur me faktin
15 se Sokol Bashota në shkurt ka dhënë dorëheqjen nga ky pozicion
16 si zëvendëskomandant?

17 PË. jo, këtë njohuri s'e kam pas.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares të
19 paraqesë në ekran -- jo, domethënë, të mbajmë këtë dokumentin
20 që kemi dhe pastaj do shkojmë tek dokumenti tjetër për një
21 çast. Të kalojmë tek faqja tjetër. Të kalojmë dhe te një faqe
22 më tej.

23 PY. Përsëri thuhet që Ramushi ka thënë si më poshtë:

24 "Veprimi është i rëndësishëm dhe vendimtar në mënyrë të
25 tillë që të vendoset në vend drejtësia dhe që të ndërpritet në

1 padrejtësitë.

2 "Veprimi ynë është i qartë.

3 "Duhet ndërhyrë në mënyrë të tillë që të mos ketë
4 diskutime dhe ndërhyrje.

5 "Ne nuk jemi të interesuar që të mbjellim përçarje në
6 Rambuje."

7 A ju kujtohet që Ramushi ju ka ndërprerë juve kur keni
8 qenë duke folur duke thënë pak a shumë këtë tekst që u lexova?
9 PË. Po e ka ndërpresë diskutimin tim dhe ka dalë jashtë
10 ndërtesës. Dhe, nëse nuk gaboju, ka shtënë me armë.

11 PY. Ka shti me armë brenda ndërtesës apo jashtë?

12 PË. Jo, jashtë ndërtesës.

13 PY. Në rregull.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani kalojmë tek dokumenti tjetër
15 me numër identifikimi SITF00009426 deri në 00009430, në faqen
16 4.

17 PY. T'ju bëj këto pyetje një herë, Dëshmitar. A jeni në
18 dijeni që në janar dhe shkurt të 1999, Sokol Bashota ka qenë
19 zëvendëskomandant i Shtabit të Përgjithshëm?

20 PË. Jo, nuk kam pas dijeni për zëvendëskomandantin.

21 PY. Si e keni kuptuar ju rolin e Sokol Bashotës në UÇK?

22 PË. Realisht unë e kam pa bukur rrallë Sokol Bashotën. Po e
23 kam kuptuar që njeri që është anëtar i Shtabit të Përgjithshëm
24 po jo çfarë detyrash ka.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Të kalojmë sipër në faqe, tek

1 pyetja 31.

2 PY. Është deklarata e Sokol Bashotës, ku ai thotë që:

3 "Nuk më kujtohet kjo, sepse sikurse e thashë, kjo ka
4 ndodhur diku pas shkurtit, megjithëse nuk jam i sigurtë dhe
5 nuk kam qenë pjesë e Shtabit të Përgjithshëm në atë kohë.
6 Hashim Thaçi ishte pjesë e drejtorisë politike dhe në takimet e
7 shtabit ai do të përfaqësonte drejtorinë. Unë dhe Azem Syla në
8 shkurt të 1999 kemi dhënë dorëheqjen."

9 Pra, ju nuk e dinit faktin në përgjithësi që Sokol
10 Bashota ka dhënë dorëheqjen nga Shtabi i Përgjithshëm në vitin
11 1999, këtë po thoni?

12 PË. Në këtë kohë nuk e kam ditur për detyrat e tyre, as për
13 dorëheqjen, po e di që është emëru komandant Sylejman Selimi
14 dhe si duket kjo dhe provoku pastaj dorëheqjet e tyre.

15 PY. Megjithatë ky rast tregon se ju si komandant zone, ju të
16 gjithë, domethënë, komandantët e zonave keni pas kompetencën
17 që të caktoni komandantin e përgjithshëm të UÇK-së. A është e
18 saktë kjo?

19 PË. Po. Në shkurt është vërtetuar që kemi pas mundësi dhe e
20 kemi ndërru komandantin e përgjithshëm.

21 PY. Kam edhe pak pyetje të tjera të mbetura.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Megjithatë mund të heqim
23 dokumentin nga ekrani përpara se të vazhdoj me pyetjet e
24 tjera.

25 PY. Ju bënë disa pyetje për Operacionin Shigjeta dhe ju thatë

1 që ju menduat që kishit menduar që Fatmir Limaj ishte caktuar
2 komandanti për sa i takon Operacionit Shigjeta, a është e
3 saktë kjo?

4 PË. Po, e saktë. Unë nuk kam qenë anëtar i Shtabi i
5 Përgjithshëm. Po në një takim apo në një shkuarje në ndërtesën
6 ku kanë qenë disa anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm e kam
7 dëgjuar se Operacionin Shigjeta mund ta udhëheqë Fatmir Limaj.

8 PY. Po Agim Çeku a ka qenë i pranishëm në këtë takim?

9 PË. Nuk më kujtohet, po e di që Agim Çeku ka qenë në zonën
10 time.

11 PY. Do t'ju them diçka.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe, në fakt, këtë e kam marrë nga
13 transkripti për gjykimin në faqen 17, rreshtat 5 deri në 12.

14 PY. Përpara se të vazhdoj me citimin dua t'ju pyes: A jeni në
15 dijeni që Bislir Zyrapi ka ardhur dhe ka dhënë dëshmi në këtë
16 çështje?

17 PË. Po, e kam ndëgjuar.

18 PY. Në rregull. A jeni në dijeni që Bislir Zyrapi ka thënë që
19 ai ka qenë përgjegjës i përgjithshëm në komandë të
20 përgjithshme të Operacionit Shigjeta dhe se, le të themi,
21 Drejtimi Operacional 1 është komanduar nga Rrustem Berisha dhe
22 drejtimi Operacional 2 është komanduar nga Nexhmedin Ajeti. A e
23 dini këtë?

24 PË. Këtë nuk e di sepse unë nuk kam qenë anëtar i Shtabit të
25 Përgjithshëm dhe normalisht që Bislir Zyrapi si shef i shtabit

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Shukri Buja (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 131

1 i ka dit shumë më mirë këto çështje.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës mbase është
3 momenti i përshtatshëm për të bërë pushim?

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
5 pushim për dhjetë minuta, Dëshmitar. Do kthehemi përsëri pas
6 dhjetë minutash.

7 Mund të largoheni nga salla së bashku me Asistenten.

8 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

9 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Kryegjykatës, mendoj që
10 dhe gjysmë ore më duhet për të përfunduar me pyetjet.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

12 --- Seanca ndërpritet në orën 15.29

13 --- Seanca rifillon në orën 15.40

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sillni
15 dëshmitarin në sallë ju lutem.

16 [Dëshmitari vijon dëshminë]

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

18 Z. Misetiç, vazhdoni me pyetjet tuaja.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

20 PY. Përshëndetje sërish, z. Buja. Tani dua të flasim për një
21 temë tjetër. Dje Prokurori ju pyeti lidhur me vendndodhjen z.
22 Thaçi në zonën tuaj në prill ose maj të 1999. Dhe në një nga
23 përgjigjet tuaja ju thatë që atje ka qëndruar për një muaj dhe
24 mund të ketë ndenjur deri nga fundi i majit, fillimi i
25 qershorit. Të kujtohet?

1 PË. Po. Dje thashë që një pjesë e Shtabit të Përgjithshëm ka
2 qëndruar përreth një muaj, po ka pas anëtarë të Shtabit të
3 Përgjithshëm të cilët kanë qëndruar deri në përfundim të
4 luftës apo deri më 12 qershor.

5 PY. E dini ju që z. Thaçi largohet nga zona për të marrë
6 takime me ndërkombëtarët, për të kryer takime me
7 ndërkombëtarët?

8 PË. Po. Në atë kohë ka pas dhe telefonin satelitor me të
9 cilin ka komunikuar edhe me ndërkombëtarët.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Do lutesha që të vendosej në ekran
11 materiali që mban numrin 019775 deri në 019776. Në shqip është
12 materiali me DHT04030-AT.

13 PY. Dëshmitar, ju thatë që ju e dini që ai largohet nga zona
14 për të marrë takime me ndërkombëtarët. Ky është një artikull
15 ku thuhet se në maj z. Thaçi ka qenë në Paris për t'u takuar
16 me ministrin e jashtëm, pra, a përputhet kjo me atë që dinit
17 dhe ju sa i takon vendndodhjes së z. Thaçi, e thënë ndryshe,
18 që ai shpesh largohet nga zona për të marrë pjesë në takime me
19 ndërkombëtarët?

20 PË. Po, ka ndodhë të largohet për me u taku me
21 ndërkombëtarët.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Unë, kërkoj pranimin e këtij
23 dokumenti.

24 Z. PACE: [Përkthim] S'kemi kundërshtim.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Materiali

1 019775-019776, bashkë me shqipen pranohet.

2 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Për procesverbal, numri
3 i përkthimit në gjuhën shqipe e kanë numrin DHT04030 deri në
4 DHT04030. Ky dokument do të marrë numrin 1D00206. Dhe
5 klasifikimi është publik.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

8 Ju lutem vendosni në ekran tani materialin me numër
9 019779 deri në 019780, që në shqip në fakt ka numrin DHT04031-
10 AT.

11 PY. Dëshmitar, ky është një artikull i BBC-së, 31 maj dhe
12 sipas këtij artikulli më 30 maj z. Thaçi ka qenë në Londër për
13 t'u takuar me sekretarin e punëve të jashtme Robin Cook. Kam
14 të njëjtën pyetje si më herët: A përputhet kjo dhe me atë që
15 ju kujtohet ju për atë kohë, pra, që z. Thaçi largohej nga
16 zona për t'u takuar me ndërkombëtarët? Korrigjim, doja të
17 thoja 31 maj.

18 PË. Po, është larguar nga zona në fund të majit është larguar
19 për kontakte me ndërkombëtarët.

20 PY. Dua të bëj një korrigjim, më falni, artikulli është i 31
21 majit 1999 ndërsa takimi mendohet se është mbajtur në 30 maj.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, kërkoj
23 pranimin e këtij dokumenti.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
25 kundërshtime?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Shukri Buja (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 134

1 Z. PACE: [Përkthim] Jo.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Materiali me
3 numër 0197799-019780, bashkë me shqipen, pranohet.

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] ERN e shqipes është
5 DHT04031 deri në DHT04031. Dokumenti do të marrë numrin e
6 provës 1D00207. Dhe klasifikimi është publik.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] I kërkoj ndjesë Sekretares sepse
8 sapo më thanë që versioni që unë kërkoja të pranohet është
9 pjesë e provave gjyqësore dhe e ka numrin P00522, por thjesht
10 duhet bashkëngjitur përkthimi në gjuhën shqipe.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
12 Atëhere mund të bashkëngjisni thjesht shqipen.

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Në rregull. Do t'i
14 shtojmë shqipen materialit me numër P00522 edhe numrin që i
15 caktuam pak më herët, pra, numrin 1D00207 do ta mbajmë gati
16 për një dokument tjetër.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

18 I lutem Sekretarisë që tani të vendosë në ekran
19 materialin 19789 deri në 019790. Më falni, se nuk ju dhashë
20 numrin për shqipen, DHT04032-AT.

21 PY. Z. Buja, ky është një artikull ku thuhet që z. Thaçi ka
22 qenë në Bon më 1 qershor që të takohej me ministrin e punëve
23 të jashtme Joschka Fischer. E njëjta pyetje: A përputhet kjo
24 me kujtesën tuaj për faktin që z. Thaçi largohej nga zona për
25 t'u takuar me ndërkombëtarë?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Shukri Buja (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 135

1 PË. Po, ka qenë i larguar.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] i nderuar Kryegjykatës, kërkoj
3 pranimin e këtij dokumenti.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
5 kundërshtime?

6 Z. PACE: [Përkthim] S'kemi kundërshtime.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Materiali
8 0197890, bashkë me shqipen, pranohet.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti, bashkë me
10 shqipen, që ka ERN DHT04032 deri në DHT04032 do të marri
11 numrin 1D00207. Dhe klasifikimi është publik.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

13 I lutem Sekretares të vendosi në ekran tani materialin që
14 ka numrin 019809 deri në 019810. Shqipja ka numrin DHT04033-
15 AT.

16 PY. Dëshmitar, ky është një artikull i *Reuters* dhe sipas
17 këtij artikulli, më 3 qershor, z. Thaçi ka qenë në Këln në
18 Gjermani. Edhe tani ju pyes: A përputhet kjo me kujtesën tuaj
19 që z. Thaçi largohet nga zona për t'u takuar me
20 ndërkombëtarët?

21 PË. Po, sigurisht që është e saktë.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Kryegjykatës, kërkoj
23 pranimin e këtij dokumenti.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
25 kundërshtime?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Shukri Buja (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 136

1 Z. PACE: [Përkthim] Jo.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Materiali
3 019809 deri në 019810, bashkë me shqipen, pranohet.

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Shqipja me ERN
5 DHT04033, bashkë me anglishten, do të marrin numrin e provës
6 1D00208. Dhe klasifikimi është publik.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

8 PY. Dëshmitar, tani dua të përqendrohemi tek periudha e
9 fundit, afër fundit të konfliktit. Fillimisht, sipas jush, kur
10 përfunduan luftimet mes UÇK-së dhe forcave serbe dhe me NATO-
11 n?

12 PË. Më 10 qershor është nënshkruar marrëveshja mes NATO-s
13 edhe forcave serbe për tërheqjen e forcave serbe. Dhe ne një
14 pjesë në zonën time të përgjegjësisë në Kaçanik dhe në [E
15 pakuptueshme] kanë hyrë forcat e Ushtrisë Çlirimtare të
16 Kosovës që më 11 qershor, pastaj ka vazhduar më 12, 13 deri
17 diku 15 qershor derisa janë sistemuar të gjitha forcat e UÇK-
18 së.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem të vendoset në ekran
20 materiali SPOE00000749 deri në SPOE000790.

21 PY. Dëshmitar, për t'ju dhënë kontekst ky është një dokument
22 më saktë -- më falni një çast. Data është 12 qershor, po në
23 fakt unë dua të shohim faqen SPOE000000772, ju lutem.

24 MISETIC: [Përkthim] Shkojmë në paragrafin 88, ju lutem.
25 Fillimisht, ju lutem, shkojmë tek faqja 7 e materialit që të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Shukri Buja (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 137

1 shohim datën. Pra, data e dokumentit është 12 korrik 1999,
2 është raporti i sekretarit të përgjithshëm të Kombeve të
3 Bashkuara, pra, administratës të ndërmjetme të Kombeve të
4 Bashkuara në Kosovë.

5 Tani shkojmë te dokumenti SPOE00000772, ju lutem.

6 PY. Në këtë raport sekretari i përgjithshëm shkruan, në mes
7 të faqes, po jua lexoj:

8 "Kanë ndodhur rrëmbime pas përfundimit të konfliktit."

9 A përputhet kjo me atë që sapo thatë ju, Dëshmitar, pra,
10 kjo deklaratë e sekretarit të përgjithshëm kur thotë që ka
11 përfunduar konflikti që i takon -- paska përfunduar para 12
12 korrikut 1999, përputhet dhe me kujtesën tuaj?

13 PË. Jo, më 10 qershor thashë që ka -- është nënshkruar
14 marrëveshja mes forcave të NATO-s dhe KFOR-it, ndërsa me 11,
15 12 kanë filluar të lëshohen njësitet e Ushtrisë Çlirimtare të
16 Kosovës. Por përgjegjësinë për sigurinë e kanë pas forcat e
17 KFOR-it dhe UNMIK-ut të cilat po ashtu kanë hyrë në Kosovë. Do
18 të thotë dhe janë përcjellë, nëse nuk gaboj, më 12 qershor
19 janë takuar në Shtime me forcat e para të KFOR-it.

20 PY. Po ta bëj pyetjen ndryshe. Kur përfunduan luftimet kundër
21 forcave serbe?

22 PË. Luftimet kanë përfunduar, si luftime në aspektin frontal,
23 kanë përfunduar më 10 qershor. Ndërsa më 12 qershor, do të
24 thotë, ka qenë çështja e hyrjes së forcave të NATO-s dhe
25 fillimi i bashkëpunimit me forcat e NATO-s.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Shukri Buja (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 138

1 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Kryegjykatës, kërkoj
2 pranimin e këtij dokumenti.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të gjithë
4 dokumentin apo këtë faqe?

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Si të dëshironi ju, për mua
6 mjafton vetëm kjo faqe edhe ballina sepse na shërben për
7 datën. Faqja 7 edhe faqja konkrete në ekran.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
9 kundërshtime?

10 Z. PACE: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Materiali me
12 numër SPOE00000772 dhe faqja 7 e materialit me numër
13 SPOE00000749 deri në 00000790 pranohen.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Për procesverbal, ERN e
15 faqes 7 ka numër 0000755. Këto faqe do të marrin numrin e
16 provës 1D00209. Dhe klasifikimi është konfidencial.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

18 Z. MISETIC: [Përkthim]
19 PY. Dëshmitar, a pajtoheni me mua ju se jo më vonë se 20
20 qershori i 1999 forcat serbe ishin tërhequr nga Kosova, pra,
21 brenda 20 qershorit ishin tërhequr forcat serbe?

22 PË. Po, ka mundësi të jetë 20 qershori.

23 PY. A e kuptoj drejt unë, që ju si komandant zone për
24 Nerodimën keni qenë pjesë e procesit të demilitarizimit të
25 UÇK-së?

1 PË. Po, kam qenë pjesë e demilitarizimit.

2 PY. A pajtoheni me mua që për afërsisht rreth datës 21 qershor
3 1999 e deri në shtator, UÇK-ja po bënte demilitarizimin
4 gradual deri në militarizimin përfundimtar në shtator?

5 PË. Po. Pas një takimi që kemi mbajtur komandantët e zonave,
6 shefi i shtabit bashkë me komandantin e forcave të KFOR-it, z.
7 Jackson dhe eprorë tjerë të KFOR-it është bërë një njoftim që
8 ne të vazhdojmë demilitarizimin e Ushtrisë Çlirimtare të
9 Kosovës deri në shtator.

10 PY. Në këto momente, pra, pas 10 qershorit 1999, mesa keni ju
11 dijeni, a ka pasur ende sulme në fshatra apo qytete të Kosovës
12 prej ndokujt?

13 PË. Jo, nuk ka pasur sulme. Po ka pas probleme pasi kanë hy
14 popullata civile në Kosovë rreth sistemimit të tyre, po në
15 fakt nuk ka pasur sulme ushtarake.

16 PY. Ndonjë prej palëve ushtarake në këtë konflikt a ka
17 bllokuar vijën e furnizimeve pas 10 qershorit 1999?

18 PË. Nuk më kujtohet që ka pas bllokime.

19 PY. A kishte rrugë të mbyllura pas 10 qershorit 1999 për
20 shkak të luftimeve ushtarake?

21 PË. Nuk e di. Pas 10 s'besoj që ka pasur.

22 PY. Keni dijeni ju të ketë pasur përplasje të armatosura mes
23 UÇK-së dhe forcave serbe pas 10 qershorit 1999?

24 PË. Ne kemi pas takime me forcat e KFOR-it, Sektorit 5, me
25 forcat ushtarake amerikane. Pas 15 qershorit keni pas takime

1 të rregullta të komandës me komandën e KFOR-it.

2 PY. Mbase s'e kuptuat pyetjen. Po them, përplasje të
3 armatosura, konflikte të armatosura, luftime, e thënë ndryshe,
4 a ka pasur luftime mes UÇK-së dhe forcave serbe pas 10
5 qershorit, mesa dini ju?

6 PË. Jo, nuk më kujtohet që ka pas përplasje të tilla.

7 PY. Armatime të rënda si tanke apo automjete të tjera, a janë
8 përdorur në konflikt pas 10 qershorit 1999, me sa keni ju
9 dijeni?

10 PË. Jo, ato janë marrë nën kontrollin e KFOR-it.

11 PY. Keni dijeni që UÇK-ja apo forcat serbe të kenë shtënë me
12 armë të rënda, armatime të rënda pas 10 qershorit 1999?

13 PË. Nuk kujtoj që ka pas diçka të tillë.

14 PY. A keni dijeni të ketë pasur viktime civile pas 10
15 qershorit 1999 në një konflikt?

16 PË. Nuk kam dijeni sepse nuk ka qenë më kompetencë e jona pas
17 Rezolutës 1244 dhe hyrjes së forcave të KFOR-it dhe marrjes së
18 përgjegjësisë nga UNMIK-u.

19 PY. A janë detyruar më civilët të largohen nga zonat e
20 luftimeve pas 10 qershorit të 1999?

21 PË. Civilët nuk janë detyru. Ata që kanë dëshirë me lëvizë,
22 normal që kanë lëvizë.

23 PY. Keni dijeni për ndonjë rezolutë të Këshillit të Sigurisë
24 së OKB-së ku të jetë shprehur ndonjë shqetësim për konflikte
25 të armatosura në Kosovë pas 10 qershorit 1999?

1 PË. Jo, s'më kujtohen.

2 PY. Tani do flasim për një temë tjetër. Kjo ka të bëjë me
3 demilitarizimin. Demilitarizimi krijoi tensione brenda UÇK-së,
4 kështu?

5 PË. Po. Ka pas ushtarë të cilët nuk kanë pas dëshirë me u
6 demilitarizu Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

7 PY. Ju keni marrë pjesë në takimet me komandantët e zonave me
8 gjeneralin Mike Jackson?

9 PË. Po.

10 PY. A është e vërtetë që gjenerali Jackson po përpiqej që
11 t'ju bindte ju, si komandantë zonash, që të respektonit
12 kushtet e marrëveshjes për demilitarizim?

13 PË. Po, është e vërtetë.

14 PY. A është e vërtetë që një nga mënyrat për t'ju bindur ju
15 ishte premtimi se do të krijohej Trupi për Mbrojtjen e
16 Kosovës, Trupat për Mbrojtjen e Kosovës, kështu?

17 PË. Po, ishte premtimi. Dhe më vonë është bë dhe marrëveshja.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem vendosim në ekran
19 materialin DHT04101 deri në DHT04106 në ekran.

20 PY. Ky është një artikull i *New York Times* është i datës 22
21 qershor 1999 dhe thotë:

22 "NATO-ja mendon që t'i lejojë kosovarët të krijojnë një
23 ushtri të re."

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë në faqen 4 të artikullit,
25 ju lutem.

1 PY. Thuhet, këtu ku thotë:

2 "Gjeneral Çeku ...", pra, një diplomat i lartë ka
3 diskutuar për një koment të gjeneral Çekut.

4 "Gjeneral Çeku tha që duhet thjesht t'i jepnim disa --
5 t'i lironim nga disa role' ... 'Nuk mund t'i nxirrnim kështu
6 papritmas në rrugë."

7 Pra, përputhet kjo dhe me atë që ju kujtohet ju bisedat
8 që janë bërë aso kohe për demilitarizimin me diplomatët e
9 lartë?

10 PË. Po, kështu e kemi diskutuar në takime.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Kryegjykatës, kërkoj
12 pranimin e dokumentit si provë gjyqësore.

13 Z. PACE: [Përkthim] Jo.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Materiali
15 DHT04101-DHT04106 pranohet.

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Dokumenti
17 do të marri numrin e provës 1D00201. Dhe klasifikimi është
18 publik.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] I lutem Sekretares që tani të
20 vendosim në ekran materialin SPOE00000734 deri në SPOE00000736
21 në faqen SPOE00000734.

22 Z. PACE: [Përkthim] Ju lutem që të mos jetë publik ky
23 dokument edhe ta trajtojmë në seancë private.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk ka problem për mua, por
25 sidoqoftë sipas klasifikimit këtu është i paklasifikuar po nuk

1 e di.

2 Z. PACE: [Përkthim] Po është një dokument sipas rregullës
3 107. Mund ta përdorim me dëshmitarin por duhet ta bëjmë në
4 seancë private.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për të qenë
6 të sigurtë më mirë ta trajtojmë këtë gjë në seancë private.

7 [Seancë private]

8 [Seancë private teksti i fshirë]

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15 [Seancë e hapur]

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
17 jemi në seancë publike.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
19 vijoni, Misetiç.

20 Z. MISETIC: [Përkthim]

21 PY. Dëshmitar, a do të thotë kjo ose a pajtoheni me mua që si
22 përkufizim çdokush që ka qenë jashtë pikave të grumbullimit me
23 armë ose me uniformë të UÇK-së ka shkelur ose nuk ka
24 respektuar urdhrat e dhëna nga Agim Çeku dhe nga komandantët e
25 zonave?

1 PË. Po, realisht nuk i ka respektu as urdhrat e KFOR-it as të
2 komandantëve të zonave dhe shefit të shtabit Agim çekut.

3 PY. Faleminderit. Në fund, Dëshmitar, gjenerali Jackson është
4 takuar me juve dhe komandantë të tjerë të zonave disa herë në
5 mënyrë të tillë që t'ju inkurajonte juve që të përmbushnit
6 detyrimet që kishit marrë përsipër. A është e saktë kjo?

7 PË. Po.

8 PY. Tani dua t'ju tregoj një shembull të fundit dhe do e
9 mbyll me këtë shembull.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Dokumenti është SPOE00212586 deri
11 në 00212692. Është një libër i shkruar nga gjenerali Jackson.
12 Në veçanti dua që Sekretaria të paraqesë faqen SPOE00212680.

13 PY. A ju kujtohet në shtator që gjenerali Jackson ka mbledhur
14 një tjetër takim ndërkohë që po përfundonte procesi i
15 demilitarizimit dhe që në këtë takim u shfaq dhe gjenerali
16 Clark. A ju kujtohet kjo ngjarje ose a ju kujtohet ky takim,
17 Dëshmitar?

18 PË. Po.

19 PY. A ju kujtohet që gjenerali Jackson u takua me gjeneralin
20 Clark dhe ai donte që gjenerali Clark të jepte një fjalim
21 përpara jush, domethënë, përpara komandantëve të zonës për të
22 thënë pse ishte e rëndësishme që të përfundohej procesi i
23 demilitarizimi, ju kujtohet kjo?

24 PË. Po, më kujtohet.

25 PY. Do filloj të lexoj nga një pjesë e librit përderisa jemi

1 drejt fundit.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe një herë, dokumenti është

3 SPOE00 --

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është 212680.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Besoj që nuk është shfaqur akoma.

6 PY. Do t'jua lexoj unë:

7 "Unë fola me", domethënë, është gjenerali Jackson që

8 flet.

9 "Fola me gjeneralin Clark, Wesley Clark dhe i thashë atij
10 që kjo është një çështje e ndjeshme. Unë më në fund shkova në
11 shtrat në orën 06.30 dhe u ngrita në orën 10.00. Mbërritëm
12 atje në orën 14.00 dhe delegacioni i UÇK-së ishte aty 45
13 minuta më vonë. Ndërkohë Clark ishte aty. Po tregonte histori
14 për përvojat e tij në Vietnam dhe po fliste me komandantët e
15 zonave të UÇK-së. Pasi bëri një fjalim të qartë kundër serbëve
16 që do i kishte acaruar shumë diplomatët tanë po ta dëgjonin.
17 Ai po ashtu tha shumë qartë, foli shumë qartë sa i takon
18 dallimeve që ekzistonin midis dy palëve. Ne po ashtu zgjodhëm
19 çështjen e shenjave dalluese, distinktivëve dallues,
20 gjithashtu ramë dakord sa i takon edhe një përshkrimi të
21 formës që duhet të kishte Kosova. Më pas u fol gjithashtu edhe
22 me emrin e organizatës që duhej që të thërritej Garda e
23 Kosovës. Pastaj kishte heshtje.

24 "'Sepse dukej shumë ushtarake', ndërkohë që Çeku u
25 përgjigj dhe pastaj të gjithë filluan që të qeshnin."

1 A është kjo diçka që përputhet me atë çfarë keni në
2 mendje ju, çfarë ju kujtohet ju sa i takon kontributit të
3 gjeneralit Clark dhe asaj çfarë ka thënë gjenerali Clark në
4 këtë takim, pra që ka ardhur për t'ju bindur ju si komandantë
5 të zonave për të rënë dakord për hapat përfundimtarë për
6 procesin e demilitarizimit, a ka ndodhur kështu, Dëshmitar?
7 PË. Po, ka ndodhur. Dhe, në fakt, se ne kemi pas një respekt
8 të jashtëzakonshëm për gjenerali Clark, i cili dhe gjatë kohës
9 së luftë s ishte dhe udhëheqësi i forcave të NATO-s dhe në
10 intervenimin ajror të NATO-s. Dhe respekti që kishim për të
11 dhe si gjeneral amerikan edhe si gjeneral i NATO-s, e ka bërë
12 që gjenerali Jackson ta ftoj për të na bindur rreth procesit
13 të transformimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Trupa
14 Mbrojtëse të Kosovës.

15 PY. Faleminderit, Dëshmitar.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Kërkoj që këtë pjesë të librit ta
17 paraqesë për t'u pranuar si prova.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
19 kundërshtime?

20 Z. PACE: [Përkthim] Jo.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
22 SPOE00212586 deri në SPOE00212692 -- e keni fjalën vetëm për
23 këtë faqe apo e keni për të gjithë dokumentin?

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Vetëm këtë faqe.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë faqja

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Shukri Buja (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 157

1 SPOE00212680 pranohet.

2 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, të
3 nderuar Gjykatës. Kjo faqe e vetme merr numrin e provës
4 1D00214. Dhe aktualisht është i klasifikuar si konfidencial.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund të klasifikohet si publik.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
7 riklasifikohet si publik.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit.

9 Z. MISETIC: [Përkthim]

10 PY. Faleminderit, Dëshmitar, nuk kam pyetje tjera për ju.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Të nderuar anëtarë të Trupit
12 Gjykses, përfundova me pyetjet për këtë dëshmitar.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
14 përfunduar për sot. Do shihemi përsëri bashkë nesër në orën
15 9.00 të mëngjesit. Faleminderit që ishit me ne sot, pasdite
16 dhe mbrëmje të këndshme.

17 Faleminderit, gjithashtu dhe ju z. Hodaj për praninë
18 tuaj.

19 Mund të largoheni nga salla e gjyqit të shoqëruar nga
20 Asistentja.

21 DËSHMITARI: Faleminderit.

22 Z. HODAJ: [Përkthim] Faleminderit.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, kam një çështje
24 organizative. Më thonë që në fakt dokumenti 1D00209 aktualisht
25 ka klasifikim konfidencial, ndërkohë që duhet të ndryshohet

1 klasifikimi në publik.

2 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në qoftë se
4 nuk ka kundërshtim mund të bëhet ndryshimi i klasifikimit.

5 Z. PACE: [Përkthim] A mund të na kujtoni se për kë
6 dokument bëhet fjalë?

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Është raporti i Këshillit të
8 Sigurimit të OKB-së.

9 Z. PACE: [Përkthim] Në rregull.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Okej.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

12 Do e mbyllim sot këtu dhe takohemi përsëri nesër në orën
13 9.00 të mëngjesit.

14 --- Seanca mbyllet në orën 16.34

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25